


HEJZA

A black and white portrait of Mal Berisha, an older man with a grey beard and glasses, wearing a dark suit, white shirt, and patterned tie. He is looking directly at the camera with a slight smile. A small circular pin is visible on his left lapel.

Mal Berisha,
krijues e diplomat

**KUR DIPLOMACIA NDRIÇON
TË VËRTETAT E PANJOHURA**

Përmbajtja

Nga Avni HALIMI

FRAGMENTIMI I IDENTITETIT3

Neviana SHEHI/ Itali

LETËRSIA ARTIFICIALE!5

Ervina TOPTANI

DASHURIA NA ZHVESH NGA ILUZIONET6

Luljeta ISAKU

MITET E REJA APO PSEUDOMITET8

Intervistë me Mal Berishën, krijues e diplomat

KUR DIPLOMACIA NDRIÇON TË VËRTETAT E PANJOHURA 10

Nehas SOPAJ

ISMAIL KADARE (POEZIA)31

Ibrahim RUGOVA

PARADOKSI HERETIK38

Prof. Dr. Bajram KOSUMI

DRAMA E LUFTËS DHE DRAMA POETIKE42

Anxhela PASHAJ

SIMBOLIKA E GRUAS SHURDHMEMECE NË ROMANIN "AMERIKANI"
TË ODISE KOTES50

Shaip BEQIRI

PSALMËT OSE MË VETE E TË TJERËT52

Nga Mërgim BEKTESHI

POEZIA KUNDËR HARRESËS56

Xhahid BUSHATI

MËRGIMTARI MARTIN CAMAJ58

POEZI / YMER SHKRELI60

Tregim/ Gent MARKAJ

VRASËSIT62

Përshtati: Fitim Nuhui

ANA KARENINA: NJË KUJTIM QË ENDE DHEMB65

Leonard VEIZI

MONIKA BELLUÇI, IKONA E ELEGANCËS DHE ARTIT67

FRAGMENTIMI I IDENTITETIT

Në profilet e përhapura nëpër platforma, kulturat kombëtare përzihen, gjuhët huazojnë fjalë nga njëra-tjetra, zakonet marrin ngjyra të reja dhe, kështu, krijohen identitete hibride që nuk i përkasin askujt në mënyrë të plotë, por as nuk janë krejtësisht të huaja për askënd



Nga Avni HALIMI

Sot kur dominimi i ekraneve dhe mediave digjitale jo vetëm që po e diktojnë mënyrën e jetës sonë, por kemi arritur edhe në pikën ku ky dominim po ndikon drejtpërdrejt edhe në mënyrën se si po ndërtojmë identiteti njerëzor. Vetja jonë po na shfaqet e fragmentuar në profile dhe postime të ndryshme, duke humbur koherencën tradicionale dhe duke u kthyer në një identitet të shpërndarë online. Rrjetet sociale nuk janë më thjesht mjete komunikimi; ato kanë marrë rolin e skenave globale, ku çdo individ performon një version të vetes për një audiencë potencialisht të pafundme. Prandaj, me të drejtë mendimtarë bashkëkohorë ngrenë shqetësimin se pikërisht ky moment e ka zëvendësuar bashkësinë organike me performancën publike, konstatim ky që në kohën e Instagram-it, TikTok-ut dhe Facebook-ut duket të jetë materializuar plotësisht.

Në hapësirat e rrjeteve sociale dhe të kulturës digjitale, mënyra se si paraqesim vetveten nuk është më një pasqyrim spontan i asaj që jemi në të vërtetë, por një konstrukt i menduar me kujdes, pothuajse si një vepër arti. Ne zgjedhim fotografi të caktuara, filtrojmë imazhet, rishkruajmë mendimet, modifikojmë tonin dhe gjuhën, të gjitha me synimin për të lënë një përshtypje të caktuar tek të tjerët. Ky proces i përzgjedhjes nuk ka të bëjë aq shumë me pasqyrimin e plotë të realitetit tonë të brendshëm, sa me krijimin e një versioni të vetes që është i pranueshëm, i admirueshëm ose i dëshirueshëm për audiencën që na vëzhgon. Në këtë mënyrë, “vetja” kthehet në një projekt estetik: një montazh i ndërtuar prej fragmenteve të zgjedhura, ku çdo element është i kuruar për efekt vizual dhe emocional, dhe jo në një pasqyrim të çiltër e të papërpunuar të realitetit tonë të përditshëm.

Fragmentimi nuk është vetëm një pasojë teknologjike, por një ngjarje estetiko-filozofike e thellë, sepse imazhet nuk përfaqësojnë më realitetin, por po e zëvendësojnë atë. Kjo ndodh sa herë një fotografi e kuruar, një video e montuar apo një status i menduar mirë bëhen më “të vërteta” se përvoja e drejtpërdrejtë që pretendojnë të paraqesin. Vetja ndahet në dy figura të dallueshme: në përjetues dhe spektator i vetvetes. Ky proces, siç do ta përshkruante Klod Levi-Strosi, prish ekuilibrat simbolikë të kulturës, sepse shenjat dhe simbolet shpëputen nga rrënjët e tyre të natyrshme dhe fillojnë të qarkullojnë si objekte të pavarura, të konsumuara dhe të ripërdorura pa kontekst.

Por rrjetet sociale nuk janë vetëm arenë rreziku. Një nga mendimtarët më të njohur bashkëkohorë për analizën e shoqërisë postmoderne, francezi Zhyli Lipovecki, në veprën e vet “Epoka e zbrazëtisë”, thekson se individualizmi bashkëkohor është një shpatë me dy tehe: ai ofron një hapësirë të paprecedent për krijimtari personale, por edhe rrezikun e boshllëkut emocional. Në këtë kuptim, fragmentimi i identitetit mund të shihet si një ftesë për të eksploruar format e reja të vetë-shprehjes, për të ndërtuar lidhje ndërkulturore dhe për të sfiduar kufijtë tradicionalë të përkatësisë. Në profilet e përhapura nëpër platforma, kulturat kombëtare përzihen, gjuhët huazojnë fjalë nga njëra-tjetra, zakonet marrin ngjyra të reja dhe, kështu, krijohen identitete hibride që nuk i përkasin askujt në mënyrë të plotë, por as nuk janë krejtësisht të huaja për askënd.

Megjithatë, fragmentimi bart një rrezik të fshehtë: humbjen e rrënjëve dhe reduktimin e individit në një spektakël të vetvetes. Nëse “vetja” bëhet vetëm një projekt vizual i kuruar për të fituar pëlqime dhe ndjekës, atëherë trashëgimia kulturore, kujtesa dhe lidhjet organike me komunitetin fillojnë të treten. Pra, këtu kemi të bëjmë me ikje të vullnetshme nga identiteti, i cili do të mund të përkufizohej si një proces narrativ: një tregim që lidh të kaluarën me të tashmen dhe të ardhmen. Nëse ndërpritet ky tregim, identiteti humb koherencën e tij dhe kthehet në një koleksion imazhesh të pashoqëruara nga kuptimi.

Ky fenomen nuk kufizohet vetëm tek individi; ai prek kulturat në tërësi. Kur identitetet kombëtare shndërrohen në slogane marketingu apo në trende virale, ndodh një thjeshtëzim i rrezikshëm: traditat, përvojat historike dhe ndjenjat kolektive, që janë të ndërlikuara dhe shumëplanëshe, shtrydhen në pak fjalë të zhurmshme apo në një hashtag të modës. Për shembull, një element i

pasurisë kulturore mund të kthehet në logon e një kompanie turistike, duke u paraqitur si një produkt ekzotik për konsum të shpejtë, i shpëputur nga konteksti historik dhe shpirtëror i tij. Në rrjetet sociale, një këngë e lashtë popullore mund të bëhet virale vetëm për shkak të një videoje argëtuese, ndërsa kuptimet e saj të thella për dashurinë, dhimbjen apo qëndresën harrohen. Kësisoj kjo këngë bëhet virale jo për përmbajtjen por për imazhet “fantastike” nga klipi! Në këtë mënyrë, kultura rrezikon të kthehet në dekor, në një kostum që vishet dhe hiqet sipas trendëve të tregut apo algoritmeve të platformave digjitale. Rreziku më i madh është që njerëzit të humbasin lidhjen e gjallë me rrënjët e tyre, duke besuar se identiteti është vetëm një imazh i lehtë për konsum, jo një përvojë e përbashkët që kërkon reflektim, kujtesë dhe përkujdesje. Ky fenomen nuk e ndihmon kulturën të jetojë, por e zbraz nga brendësia, duke e shndërruar në një paketim të bukur por të zbrazët.

Fragmentimi digjital mund të bëjë që kulturat e vogla të ndihen të padukshme në oqeanin e përmbajtjes globale. Por njëkohësisht, po kjo teknologji u ofron atyre një mundësi unike për të zmadhuar zërin e tyre. Siç do të shprehej Gi Debori në “Shoqëria e spektaklit”, sfida nuk është të refuzohet spektakli, por të gjendet një mënyrë për ta kthyer atë në mjet emancipimi dhe jo në instrument të pasivizimit.

Përballë këtij realiteti, kultura nuk duhet të tërhiqet në nostalgji apo purizëm, por të adoptojë një vigjilencë të re estetike dhe etike. Të banojmë në këtë mozaik do të thotë të ndërgjegjësohemi se çdo imazh, status apo video që ndajmë është një pjesë e rrëfimit më të madh të vetes dhe të kulturës sonë. Fragmentimi i identitetit mund të shndërrohet në një formë krijimi, vetëm nëse ne zgjedhim ta lidhim çdo copëz me një kujtesë, një komunitet dhe një horizont të përbashkët kuptimesh. Në të kundërt, ai mbetet vetëm një seri pamjesh që konsumohen dhe harrohen, duke na lënë bosh në një univers gjithnjë e më të mbushur me imazhe, por gjithnjë e më të varfër në kuptim.

Sot, pra, në këtë epokë digjitale, sfida jonë nuk është të rikthejmë një autenticitet të pastër që ndoshta nuk ka ekzistuar kurrë, por të mësojmë të krijojmë koherencë nga copëzat e shpërndara të vetes. Kjo kërkon kujdes ndaj kujtesës kulturore, dialog të vazhdueshëm mes përvojave dhe një vetëdije të mprehtë për fuqinë e tregimeve që ndërtojmë çdo ditë. Vetëm atëherë fragmentimi nuk do të jetë shenjë e shthurjes, por mundësi për një identitet më të hapur, më të thellë dhe më të pasur.

LETËRSIA ARTIFICIALE!

Prodhimi artificial është i përkohshëm. Lind në mëngjes, por perëndon (dhe zhduket) në mbrëmje. Ndërkaq prodhimi i natyrshëm, që del nga shpirti, ka jetëgjatësinë e njerëzimit


Neviana SHEHI/ Itali

Dalja në skenë e CHAT GPT fatkeqësisht ka cenuar dukshëm rrjedhën e asaj që është e natyrshme. Tashmë jemi dëshmitarë se nga kjo teknologji nuk po kursehet as arti dhe shohim një shtim marramendës të veprave artistike, por që në esencë janë prodhim i një shpirti të vdekur, përkatësisht të një fasade që me shiun e parë bëhen të padukshme. Gjithnjë e më shumë po bëhet e dukshme kjo e keqe, e cila rrënjët e saj po i lëshon vrullshëm edhe në përpjekjet e shumë individëve për t'u bërë pjesë e letërsisë shqiptare. Sot kemi "poetë" që "shkruajnë" minimum nga 10 poezi në ditët, dy – tre kritika pa lexuar libra, por edhe romane në çdo dy muaj. Midis nesh, çuditërisht, bashkëjetojnë "individë" që po bëhen fenomen dhe të cilët në fakt janë abuzues që fare nuk skuqen nga injoranca, të cilën e ushqejnë me një produkt artificial, por që është i tejdukshëm dhe lehtë i kuptueshëm.

Prodhimi artificial është i përkohshëm. Lind në mëngjes, por perëndon (dhe zhduket) në mbrëmje. Ndërkaq prodhimi i natyrshëm, që del nga shpirti, ka jetëgjatësinë e njerëzimit. Pra, sa do të ketë jetë njerëzim, po aq do të jetojë vepra, e cila në esencë lind nga magjia e shpirtit, nga ajo frymë që i shërben të vërtetës dhe të bukurës.


Si asnjëherë më parë, sot kemi një vetëdijësim për ushqim bio, sepse pasojat nga ajo që është artificiale po bëhen të padurueshme dhe mbi të gjithë, të kobshme, të cilat shprehen përmes një game të madhe të sëmundjeve, për shumicë e të cilave nuk ka ilaç.

Nuk duhet të lejojmë që ta shkatërrojmë artin tonë, sepse e kemi ngritur me shumë mund e sakrificë dhe i cili është një nga shtyllat kryesore të identiteti tonë. Sado që diçka të duket e përsosur, po që brenda saj nuk e ka shpirtëroren, është e vdekur dhe nuk shërben për asgjë. Duhet të jetë e qartë: poezia, tregimi, kritika, drama...nuk janë çështje mode. Janë çështje të individëve të veçantë, të cilët zbulojnë një botë tjetër, që fshihet brenda



tyre. Bota e tyre, fatkeqësisht është e mbushur me dhimbje, por ata kanë një dritë magjike, të cilën, përmes veprave, ia dhurojnë popullit që i takojnë, por edhe mbarë njerëzimit. Vetëm ata të paqartën e bëjnë të qartë. Dhe, në kontekst të kësaj shtrohet pyetja: a kanë dhimbje agjentët artificial të inkorporuar brenda një kompjuteri për të kryer disa funksione, që përkufizohen si inteligjencë artificiale?

Kjo inteligjencë mund të shfrytëzohet për çështje të tjera, por jo edhe për të bërë "letërsi artificiale", të cilës i mungon fryma. Dhe kur nuk ka frymë, atëherë nuk ka as jetë. Duhet të jetë e qartë, ata që bëjnë letërsi janë shpirta të veçantë, veprat e të cilëve jetojnë edhe pas vdekjes së autorit. Atëherë cili është kuptimi i tendencës për të prodhuar vepra të vdekura?



DASHURIA NA ZHVESH NGA ILUZIONET

Dashuria nuk dëmton, por na bën të shohim plagët që ishin aty edhe para saj. Dhimbja që ndjejmë në të vërtetë është rritje. Është prova që shpirti është zgjuar

Ervina TOPTANI

Kam fatin të bëj biseda me studentë të tillë dhe kur thellësia e fjalës dhe mendimit të shprehur më prek shpirtin, kam dëshirë ta shijojnë dhe të tjerët. Bisedë me një studente që duhet të shkruante një ese mbi dashurinë, temën më komplekse të mundshme. Ia vlen me u ndalë pak, me shiju... me reflektu...

STUDENTJA: Zysh, me duket sikur s'do mundem të shkruaj asgjë. Kam një mijë pyetje në kokë, përgjigjet e të cilave zëvendësojnë njëra tjetrën. Sa i mençur duhet të jetë njeriu për të kuptuar ç'është

dashuria? Unë kam lexuar mjaft për të, e kam studiuar tek Platoni, tek Kierkegaard, e kam ndjerë tek poezia, por ende s'e kuptoj thelbin e qartë. Është ndjenjë, mendim, iluzion? Ju si e mendoni?

UNË: Ke shtruar një pyetje mjaft të thellë duke dashur të zbërthesh atë çka shumica e njerëzve e përjetojnë verbërisht. Mendoj se dashuria nuk është vetëm ndjenjë. Ajo është mungesë dhe prani njëkohësisht. Është etje për një të tërë që ne s'e kemi dhe shpesh as nuk e njohim.

STUDENTJA: Atëherë pse e ndjejmë kaq thellë, nëse është diçka që s'e kuptojmë?

UNË: Sepse dashuria është një kujtim i paqartë i diçkaje që shpirti e ka njohur përpara se të lindte. Platoni e quajti “anamnezë”, kujtesë e përjetshme e së bukurës. Dashuria e vërtetë nuk ka lidhje me të pasurit, por me të njohurit. Ta duash dikë nuk do të thotë “t’i përkasësh atij”, por “ai të të shohë ashtu si je, të të dojë pikërisht pse je ti dhe mos të të mbyllë brenda kufijve të pritshmërive të tij.

STUDENTJA: Pra dashuria kurrsesi nuk kërkon të zotërojë?

UNË: Dashuria që kërkon të zotërojë është frikë e maskuar. Dashuria e vërtetë është guxim për ta parë tjetrin si mister jo për ta zgjidhur si ekuacion, por për ta dashur e mbrojtur autenticitetin e tij. Nëse mendon se ke gjetur dashurinë te një njeri, atëherë ky nuk duhet të jetë fundi i kërkimit tek vetja, por mënyra më e bukur për të mos pushuar së kërkuari.

STUDENTJA: Por, nëse dashuria është kujtim i së bukurës që shpirti e njeh, pse ndonjëherë dhemb kaq shumë? Pse ndjejmë humbje, zhgënjim shpesh edhe boshllëk në emër të saj?

UNË: Sepse dashuria na zhvesh nga iluzionet dhe ky është gjithmonë një proces i dhimbshëm. Ne shpesh mendojmë se dashuria është përm-bushje, por më së pari ajo është pasqyrë. Na tregon çfarë duam, çfarë na mungon, çfarë jemi. Duhet të dish se dashuria nuk dëmton, por na bën të shohim plagët që ishin aty edhe para saj. Dhimbja që ndjejmë në të vërtetë është rritje. Është prova që shpirti është zgjuar.

STUDENTJA: A do të thotë kjo që ne dashurojmë vetëm për t’u njohur më mirë me veten?

UNË: Jo vetëm. Dashurojmë sepse nëpërmjet tjetrit e kuptojmë më mirë natyrën tonë të paplotë. Dashuria është një mënyrë për të kuptuar se sa shumë kemi nevojë për tjetrin, jo për të na shpëtuar, por për të na treguar se jemi të njohshëm, të dukshëm, të prekshëm në thelbin tonë. Dhe ndodh që kur dikush të do me sytë e vërtetë, për herë të parë do të ndjesh se nuk ke më nevojë për maskën që ke mbajtur për botën.

STUDENTJA: Po kur tjetri ikën? Kur ai që të njohu më mirë se të gjithë bëhet heshtje?

UNË: Atëherë dashuria vjen në formën më të lartë të saj, ajo që mbijeton pa zotërim. Pavarësisht dhimbjes, ti i uron atij njeriu vetëm lumturi. Dhe ky është kulmi i mirësisë, i të bukurës së pafundme që njeriu ka brenda vetes. Sa njerëz realisht



janë të aftë ta bëjnë këtë gjë? Sa njerëz njeh ti që burojnë mirësi edhe mes dhimbjes e trishtimit? Dashuria atëherë nuk është më nevojë por dhuratë. Dashuria nuk matet me kohën, as me reciprocitetin. Matet me hijeshinë dhe urtësinë që lë brenda teje edhe pasi gjithçka ka mbaruar. Mund të mos jetë diçka e përjetshme por mbetet e përjetshme në ndikimin që ka pasur mbi ty.

STUDENTJA: Atëherë, a mund ta quaj dashuri diçka që më mëson të jem më e duruar, më e thellë, më pak e frikësuar nga vetmia?

UNË: Po. Dhe më lejo të të them diçka që ndoshta nuk e ke dëgjuar më parë: dashuria më e pastër nuk është ajo që na bashkon me dikë tjetër, por ajo që na rikthen te vetvetja me më shumë butësi.

Kur prej dashurisë del versioni më i mirë i mundshëm i njeriut që ke brenda vetes, atëherë ke dashuruar vërtet. Bota sot ndaj endet në udhëkryqe falsiteti, dhune e vetmie të frikshme, sepse njerëzit nuk dinë më të dashurojnë vërtet e pothuaj askush nuk është në gjendje të njohë versionin më të mirë të njeriut që ka brenda vetes. Në fund të fundit jeta dhe dashuria ecin në të njëjtin paralel dhe janë e njëjta gjë.



QASJE

MITET E REJA APO PSEUDOMITET

Prania e mitit në erën e shkencifikimit radikal dhe përputhja e tij me mënyrën e ekzistimit modern, edhe në shekullin XX e XXI e shtron pyetjen se a mundet sërish të shkëlqejë me të vërtetën e tij, apo është fluid e lajthitës që gjallëron nga inercioni i së kaluarës?

Luljeta ISAKU

Miti nuk ka qenë dhe nuk është dukuri e kushtëzuar historike e kulturës së qytetërimeve, koha e të cilit ka kaluar, por forcë e dëshmuar vitale krijuese shpirtërore, e cila ka rol dhe ndikim në artikullimin e vlerave edhe në botën moderne. Prania e mitit në erën e shkencifikimit radikal dhe përputhja e tij me mënyrën e ekzistimit modern i cili mbështetet

në shkencë, teknikë dhe industrializim, edhe në shekullin XX e XXI e shtron pyetjen se a mundet sërish të shkëlqejë me të vërtetën e tij, apo është fluid e lajthitës që gjallëron nga inercioni i së kaluarës?

Shkenca me orientim pozitivist jo vetëm që nuk jep ndonjë përgjigje për kuptimin më të lartë jetësor, por e shpall jo legjitime dhe iluzore shtruarjen e kësaj çështje. Në anën tjetër dija për kupti-



min dhe kuptimësimin e jetës, e sidomos të asaj shpirtërore, mbetet çështja më primare për njeriun i cili as nuk mund të lirohet dhe as nuk mund të privohet nga kjo e drejtë. Në kohën jomitike kërkohen mite të reja, duke e vënë në dyshim forcën e racios, mundësinë e vetshkatërrimit të iluminizmit dhe besimin se shkenca pozitiviste mund ta luaj rolin kryesor në jetën shpirtërore. Për këto arsye kthimi nga rrëfimi mitik vjen si rezultat i mangësisë së energjisë shpirtërore. Andaj zhangoni i mitit modern u identifikua si fuqi vitale morale dhe mendje e mirëfilltë revolucionare, jashtë lëvizjeve religjioze. Në këtë kontekst mitet e reja ngrihen mbi filozofinë dhe nuk e mbajnë më petkun e tyre abstrakt. (Gjuriq. 1989)

Vlen të theksohet se krijimet letrare të angazhuara bashkëkohore të cilat në bazë të qëllimeve programatike revolucionare (Maksin Gorki "Nëna" 1906) u bënë mostër dhe normë për stilin e realizimit socialist, kishin qëndrim negativ ndaj miteve. Ato mbështeteshin në ngjarjet e drejtpërdrejta të luftës politike aktuale në shoqëri. Kjo letërsi fuqishëm ishte kundër luftës klasore, vullnetarizmit dhe antitraditës radikale. Burimin e gjente në idealet e krijimit të një kohe, jete dhe kulture të re, si një realitet i vetëm i mundshëm i lirisë. Për bazë merrte interesat e shtresave të

gjera si mundësi a priori, se vetëdija estetike dhe antologjia artistike mund të shkruhen vetëm përmes konceptit socialist të të menduarit. Kjo letërsi u shndërrua në klishe, përmes të cilave spontanisht zuri vend mitologjia e ashtuquajtur revolucionare. Dogmat dhe kultet, në kushtet e antagonizmave të shumta, merrnin konotacione eskatologjike. (Radulović.1985)

Realistët socialist kryesisht janë shmangur nga tema dhe lënda mitike. Kanë shqyrtuar pozitën e artit vetëm nga këndvështrimi shoqëror, duke nxitur dhe trilluar format artistike me përcaktim afirmativ dhe duke mohuar vlerat e kaluara si forma të vjetruara të vetëdijes. Për këtë arsye, miti, në krijimet e tyre është zvetënuar ose është pasqyruar si negacion i vetes dhe si mjet për ç'mistifikimin e paragjyqimeve. Duke predikuar moralin e ri dhe mendimin e filozofisë pragmatike mbi realitetin konkret, që ngrihej në nivel të kuazimitologjisë, realistët socialist mistifikuan njeriun e rëndomtë duke e ngritur shpeshherë në rrafsh mistike. Në emër të së vërtetës ideologjike, të pastërtisë ideore dhe vetëdijes kolektive, ata manipuluan e spekuluan me natyrën dhe shpirtin e njeriut. Ndër të metat e dukshme të kësaj letërsie është mënjanimi i mitit dhe futja e kauzimeve në forma të ndryshme artistike.

INTERVISTË ME MAL BERISHËN,
KRIJUES E DIPLOMAT

KUR DIPLOMACIA NDRIÇON TË VËRTETAT E PANJOHURA

(Një intervistë që nuk ofron vetëm fakte, por një pasqyrë të thellë të shpirtit dhe përkushtimit të një intelektualit që ka ndihmuar jo vetëm në diplomacinë kombëtare por edhe në ndriçimin e të vërtetave që nuk i ka njohur historia shqiptare)

Në horizontin e botës shqiptare, ku historia shpesh ndërthuret me kujtesën dhe ku kultura përpiqet të flasë mbi heshtjen e kohës, ekziston një vijë e padukshme që lidh jetët individuale me fatin kolektiv. Është ajo vijë që nuk shihet ndërsa ecim mbi të, por që bëhet e lexueshme vetëm kur ndalemi dhe kthehemi pas. Për shumicën e njerëzve, ajo mbetet një përvojë private; për disa të rrallë, shndërrohet në përgjegjësi publike dhe në marrëdhënie të vazhdueshme me historinë. Ka personalitete tek të cilët fati individual dhe domosdoshmëria historike nuk ecin paralelisht, por kryqëzohen vazhdimisht, duke krijuar tension, detyrim moral dhe vetëdije shërbimi. Në këto raste, jeta nuk është thjesht një rrëfim personal, por një hapësirë veprimi ku zgjedhja nuk matet vetëm me dëshirën, por me atë që kërkon koha.

Mal Berisha është një nga ata njerëz të rrallë të cilët përgjegjësia publike, vizioni kulturor dhe përkushtimi ndaj dijes nuk janë thjesht fjalë, por një mënyrë jetese. I lindur në një periudhë kur Shqipëria kërkonte të kuptonte vetveten dhe vendin e saj në botë, ai përfaqëson figurën e diplomatit që ka ditur të shtrijë ndikimin e tij në skenën ndërkombëtare me delikatesë, por edhe me vendosmëri, duke ndërtuar ura midis kombit të vet dhe universit më të gjerë botëror. Në veprimtarinë e tij diplomatike, kultura dhe his-



toria nuk shfaqen si elemente zbukuruese, por si mjete thelbësore për ta bërë të dëgjueshëm zërin e një kombi të vogël. Diplomacia, në këtë kuptim, nuk është vetëm teknikë negocimi, por ushtrim karakteri dhe përgjegjësie; një përpjekje për të gjetur gjuhën e duhur midis interesit kombëtar dhe ndjeshmërisë historike. Por, përtej protokolleve, postave dhe dokumenteve zyrtare, Mal Berisha është edhe studiues dhe shkrimtar. Ai ka zgjedhur të ndalet mbi figura dhe ngjarje që shpesh kanë

mbetur në periferi të vëmendjes publike, duke rivendosur në qendër pjesë të rëndësishme të historisë sonë kombëtare. Puna e tij mbi presidentin Woodrow Wilson dhe lidhjet e tij me Shqipërinë nuk është thjesht një akt akademik, por një formë e kujtesës aktive, një përpjekje për të shpëtuar të vërtetën nga harresa.

Në këtë intervistë për HEJZA, Berisha nuk flet vetëm si diplomat apo historian, por si njeri që ka jetuar mes dy botësh: asaj të dukshme, ku



veprimi matet me rezultate konkrete, dhe asaj të padukshme, ku reflektimi, dyshimi dhe vetëdija historike janë po aq përcaktuese. Çdo përgjigje e tij është një pasqyrë kujtese, një përpjekje për ta lexuar jetën si një trajektore ku fati, zgjedhja personale dhe pesha e historisë ndërthuren në mënyra të papritura. Lexuesi ftohet të hyjë në këtë bisedë jo si vëzhgues i largët, por si bashkudhëtar në udhëtimin e një njeriu që i ka shërbyer kombit, kulturës dhe dijes me pasion të rrallë, dhe që jetën e ka kuptuar si një vijë përplasje mes asaj që na jepet dhe asaj që zgjedhim. Pyetjet që shtrohen këtu nuk i drejtohen vetëm një individi, por çdo brezi që përballlet me kohën e vet: sa zgjedhim realisht dhe sa zgjedhemi nga historia, dhe a dimë ta luajmë rolin tonë me dinjitet?

Kjo intervistë nuk është vetëm një kronikë e jetës dhe veprimtarisë së Mal Berishës, por një udhëtim reflektues mbi kuptimin e veprimit publik, mbi marrëdhënien midis dijes dhe shërbimit, dhe mbi mënyrën se si një jetë intelektuale mund të shndërrohet në dritë orientuese për brezat që vijnë.

I. HYRJE: MBI FATIN DHE VIJËN QË PËRSHKON JETËN

HEJZA: Jeta e secilit prej nesh ka një linjë të brendshme, një fije të padukshme që herë duket si zbulesë, herë si barrë, herë si dhuratë e pamërituar. Por ka njerëz, si ju, te të cilët kjo fije duket si një tel i tërhequr midis historisë së një kombi dhe fatit personal, një tel i ngarkuar me përgjegjësi, kujtesë, dhe shpresë. Kur shikoni pas sot, si e shi-

hni atë vijë të brendshme që ka orientuar jetën tuaj, ishte fat, zgjedhje, domosdoshmëri historike apo një kombinim i të gjithave?

MAL BERISHA: Ju faleminderit me mirënjohje për ftesën dhe për hapësirën që më jepni në revistën tuaj. E konsideroj nder dhe privilegj. Më lejoni të theksoj se pyetja juaj ka një karakter thellësisht filozofik. Për këtë arsye, do të përpigem t'i përgjigjem me të njëjtin nivel reflektimi dhe rigoroziteti intelektual me të cilin më është parashtruar prej jush. Kur njeriu ndalet për të soditur kohën e shkuar, ai arrin të kuptojë se jeta nuk shpalolet sipas një vije të drejtë e të paracaktuar, por ndjek një rend të brendshëm, të përbërë nga përsosja e pandërprerë, kthesat, ndërprerjet, pengesat dhe rikthimet. Kjo vijë e "padukshme", që përshkon ecurinë tonë, nuk na bëhet menjëherë e njohur. Ajo zbulohet vetëm në retrospektivë, kur ngjarjet që dikur dukeshin të rastësishme marrin kuptim dhe domethënie brenda një tërësie më të gjerë kohore dhe hapësinore. Për mua, kjo vijë është shfaqur si një ndërthurje e pashkëputshme mes fatit, zgjedhjes dhe domosdoshmërisë historike. Fati më ka vënë përballë rrethanave që jo gjithmonë kanë qenë fryt i vullnetit tim, por që, sipas rendit të gjërave të kohës, më janë dhënë për t'u përballur me to. Zgjedhjet, nga ana tjetër, rrallëherë kanë qenë shprehje e një lirie absolute.

Më së shpeshti ato kanë qenë ushtrim i detyrës morale, përgjigje e arsyes ndaj asaj që kërkonte momenti, një 'po' ose 'jo' e thënë jo sipas dëshirës, por sipas asaj që duhej bërë. Siç thotë Mark Aurelius, "Njeriu nuk e zgjedh gjithmonë rolin që i jepet, por ai duhet ta luajë atë me dinjitet, maturi

dhe përkushtim.” Vetëm sot e kuptoj se fati, zgjedhja dhe historia nuk kanë vepruar veçmas, por janë gërshtetuar në një bosht të vetëm. Aty ku fati hapte një derë, zgjedhja vendoste nëse do ta kaloja atë prag dere. Aty ku koha impononte drejtimin, detyra ime ishte të ruaja integritetin moral dhe ndërgjegjen. Jeta, kështu, nuk është as rastësi e verbër, as projekt i ftohtë, por një ndërthurje e vazhdueshme mes asaj që na jepet dhe asaj që marrim përsipër.

HEJZA: A mendoni se kuptimi i jetës shfaqet vetëm kur kthehemi pas për ta parë, apo njeriu mund ta ndjejë vijën e fatit edhe ndërsa ecën mbi të?

MAL BERISHA: Mendoj se kuptimi i jetës nuk na jepet kurrë i plotë në një çast të vetëm. Ai shpallet në dy kohë: Në kohën ku jetojmë, pra në të tashmen dhe në kohën kur kthehemi pas për të reflektuar. Gjatë rrugës, njeriu më tepër ndien sesa kupton. Është një ndjesi e brendshme, pothuajse instinktive, që e orienton përpara dhe i jep njeriut bindjen se hapat nuk janë krejt të rastësishëm. Shpesh ecim mbi një trase të padukshme, të udhëhequr nga një thirrje e heshtur e brendshme. Ky është fati, jo si forcë e verbër, por si prirje që

formëson zgjedhjet tona edhe përmes pengesave. Kuptimi i plotë i kësaj vije, megjithatë, zbulohet vetëm me distancën e kohës: Kur ecim shohim vetëm hapin e radhës, por kur kthehemi pas shohim krejt shtegun e përshkuar. Siç thotë një sentencë e vjetër stoike, *“Natyra e tregon rrugën, por vetëm koha ia jep kuptimin.”* Në këtë dialog të heshtur mes së tashmes dhe së shkuarës, mes përjetimit dhe reflektimit, lind ajo që ne e quajmë kuptim të vetë jetës.

HEJZA: A ka pasur një moment kur keni ndier se jeta ju testoi me diçka që nuk ishte përmasë e një njeriu, por e një brezi të tërë?

MAL BERISHA: Nuk e kam parë kurrë veten si lider apo prijës. Kam qenë thjesht një individ që ka bërë pjesën e vet në rrethanat ku e vendosi koha. Megjithatë, ka pasur momente që nuk i përkisnin vetëm jetës sime personale, por peshës që mbarti një brez i tërë. U rrita në një kohë kur frika dhe heshtja ishin pjesë e përditshmërisë, dhe të mos pajtoheshe me to ishte më shumë se një zgjedhje individuale. Ajo do të ishte një provë morale e përbashkët. Më vonë, në shërbimin diplomatik, kjo përgjegjësi mori formën e përfaqësimit të shtetit





dhe kombit tim, dhe të dëshmisë historike. Në këtë kuptim, nuk kam bërë tjetër veçse kam bashkudhëtuar me historinë e vendit tim, si një zë në mes të shumë zërave. Janë disa sprova, që vërtet, nuk i zgjedh vetë njeriu. Ato i sjell koha dhe i ndan me brezin e vet.

Seneka thotë: "Nuk jemi ne ata që zgjedhim rolet, çështja është a dimë ta luajmë mirë rolin që na jepet." Unë besoj se rolin që më është dhënë për ta luajtur në të mirë të Shqipërisë, Kosovës dhe shqiptarisë e kam luajtur me ndershmëri dhe

dinjitet, deri në çastin kur e kam ndjerë se "regjisori" po më caktonte një "rol" që unë nuk duhej ta luaja. Në atë moment kam dalë menjëherë nga "roli".

HEJZA: Nëse do të duhej ta përshkruanit jetën tuaj me një metaforë gjeografike: lumë, mal, det, tokë - cila do të ishte ajo dhe pse?

MAL BERISHA: Emri im është Mal dhe kam lindur përballë një mali madhështor. Ndoshta nuk është rastësi që, kur flas në gjuhën e metaforës, e shoh veten të lidhur natyrshëm me peizazhin e

Malit të Shkëlzenit. Do ta përfytyroja jetën time si një shkëmb të vogël, i cili qëndron pranë një Valbone të Kaltër. Në këtë bashkëjetesë mes Malit dhe Lumit e gjej veten të qëndrueshëm në parime, por edhe i gatshëm të eci me kohën, pa e humbur kurrë fillësën prej nga vij.

II. DIPLOMACIA SI ART I TË PADUKSHMES

HEJZA: Diplomacia, në thelb, është një fushë ku rezultati shpesh ndodh larg syve të botës, në një hapësirë të heshtur ku fjalët kanë peshën e gurëve, por duhet të bien me lehtësinë e pendëve. Puna juaj shpesh ka qenë pikërisht në këtë zonë të ndritshme të hijeve, në atë diplomaci ku historia e madhe fillon me nuanca të vogla. A ka pasur një moment të vetëm, një takim, një fjali, ku e keni ndier se diplomacia nuk është profesion, por një gjendje shpirtërore?

MAL BERISHA: Po. Ka çaste kur diplomacia pushon së qeni profesion dhe shndërrohet në gjendje shpirtërore, kur një fjali e thënë me maturi mjafton për të ruajtur ekuilibrin. Siç shprehej Metterniku, *"Diplomacia është arti i të mundshmes"*. Pikërisht në këtë kufi të brishtë mes fjalës dhe heshtjes, ajo bëhet ushtrim vetëpërmbajtjeje dhe përgjegjësie morale, ku fjalët peshohen jo vetëm për kuptimin e tyre, por edhe për pasojat që mbartin. Në këtë hapësirë të heshtur mes asaj që thuhet dhe asaj që lihet të nënkuptohet, diplomacia lë pas zhurmën dhe shndërrohet në një përpjekje të qetë për të ndërtuar mirëkuptim pa zhurmë e pa bujë.

HEJZA: A ka një rregull të pashkruar të diplomacisë që e keni mësuar vetëm përmes përjetimit, e jo nga librat?

MAL BERISHA: Po. Rregulli më i rëndësishëm, i pashkruar, është ky: *"Asgjë nuk duhet t'i shpëtojë syrit dhe veshit të diplomatit shqiptar"*.

Në diplomaci, njerëzit nuk mbajnë mend gjithmonë se çfarë u the, por se si i bërë të ndjeheshin! Sepse marrëdhëniet ndërtohen po aq mbi respektin dhe ndjeshmërinë, sa edhe mbi faktet dhe argumentet. Ky është një mësim që nuk gjendet në libra. Ai fitohet përmes përjetimit dhe lidhet ngushtë me atë që tradita jonë e quan *"prajtje"* *"urtësi"*, në odën e burrave shqiptar. Ajo është aftësia dhe durimi për të dëgjuar me vëmendje, për t'i dhënë tjetrit hapësirë të shprehet dhe për t'iu përgjigjur me urtësi e zgjuars, jo me nxitim. Pikërisht aty, në këtë kulturë të dëgjimit dhe të masës në fjalë, formohet thelbi i diplomacisë së vërtetë shqiptare, sado popullore të duket ajo.

HEJZA: Shpesh thoni se diplomacia ndërtohet mbi tolerancën dhe durimin. Cila ka qenë situata më e ndërlikuar ku durimi juaj u vu në provë ekstreme?

MAL BERISHA: Një nga situatat më të ndërlikuara, ku durimi dhe matura u vunë seriozisht në provë, lidhet me një periudhë tensioni të lartë rajonal, kur ekzistonte shqetësimi real për cenimin e integritetit territorial të Shqipërisë në jug të vendit, në mars të vitit 1997. Në atë kontekst, angazhimi im diplomatik, si Kryekonsull i Shqipërisë në Stamboll, u përqendrua në komunikimin e vazhdueshëm, të drejtpërdrejtë dhe bindës me autoritetet më të larta politike dhe ushtarake të Turqisë së asaj kohe, përfshirë administratën e drejtuar nga Tansu Çiller dhe Necmettin Erbakan. Ishte një proces që kërkonte angazhim të jashtëzakonshëm dhe argumentim të fortë mbi rrezikun real që i kanosej Shqipërisë nën pretekstin e të ashtuquajturit *"Vorio Epir"*. Në këtë kuadër, në pozicionin e Kryekonsullit shqiptar në Stamboll, së bashku me ambasadorin shqiptar në Ankara, z. Skënder Shkupi, dhe përfaqësuesin e Kosovës në Stamboll, z. Enver Tali, i kërkuam takim dhe arritëm të takonim njërin nga bashkëpunëtorët më të afërt të Tansu Çillerit në atë kohë, zëvendëskryeministre dhe ministre e Jashtme e Turqisë. Rezultati i këtij angazhimi ishte deklarata zyrtare e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Turke për mbrojtjen e territorit të shtetit shqiptar në rast të një ndërhyrjeje nga ana e forcave greke në jug të vendit.

Ishte një moment lehtësimi për mbarë shqiptarët, por edhe një ndjenjë krenarie për atë që arritëm të realizonim në një kohë jashtëzakonisht të rrezikshme. Qëndrimi i shprehur publikisht nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Turke fill pas atij takimi, në mars të vitit 1997 kontribuoi ndjeshëm në ruajtjen e ekuilibrave dhe në shmangien e një përshkallëzimi të rrezikshëm rajonal. Po ashtu, kjo përbënte një arritje diplomatike në dukje të thjeshtë, por me rëndësi të madhe historike. Manovrat greke për marrjen e jugut të Shqipërisë, që në atë çast, u shuan. Ky ishte një nga ato çaste kur durimi diplomatik nuk është pasivitet, por formë e përgjegjshme veprimi. Jo heroizëm personal, por përpjekje e bashkëpunim në heshtje për të mbrojtur interesat jetike të vendit përmes mjeteve që vetëm diplomacia di t'i përdorë.

HEJZA: Kur përballeni me një bisedë të vështirë diplomatike, çfarë dëgjoni më shumë: fjalët që thuhet apo ato që nuk thuhet?

MAL BERISHA: Në diplomaci, kam mësuar të *"dëgjoj"* po aq atë që nuk thuhet sa edhe atë që



artikulohet. Heshtjen e kam ushtruar si virtut të urtësisë, deri në kufirin e qartë kur ajo pushon së shërbyeri dialogut dhe fillon të dëmtojë misionin që diplomati ka për detyrë të kryejë. Një shembull domethënës për mua ishte një takim diplomatik dhe akademik në Universitetin e Oksfordit, ku Ministri i Jashtëm grek i asaj kohe, Nikos Kotzias, artikuloi një sërë akuzash ndaj Shqipërisë. Në atë rrethanë, heshtja nuk do të kishte qenë maturi, por dorëzim, madje tradhëti. Kur ai pretendoi se komuniteti çam në Shqipëri përfaqësonte, sipas tij, një vazhdimësi brezash të bashkëpunëtorëve nazistë të larguar nga Greqia dhe të përfshirë në politikën shqiptare, e ndjeva të domosdoshme të reagoja qartë dhe pa ekuivok.

Përgjigjja ime ishte e drejtpërdrejtë: *Shqipëria nuk ka pasur kurrë parti naziste, ndërsa në Parlamentin Grek ekzistonte një formacion i njohur publikisht si "Agimi i Artë", me 17 deputetë, i cili përfaqësonte pikërisht një strukturë neonaziste.* Përballë këtyre fakteve, ministri grek u detyrua të tërhiqej nga akuzat e tij përpara audiencës. Ky ishte një nga ato momente kur diplomacia kërkon jo heshtje, por fjalën e matur dhe të saktë, të thënë në kohën dhe mënyrën e duhur.

HEJZA: A ka pasur një çast në karrierën tuaj kur vigjilenca diplomatike ka rezultuar vendimtare për të parandaluar një zhvillim të rrezikshëm?

MAL BERISHA: Po. Ishte mesi i dhjetorit të vitit 2011. Rusia po i dorëzonte Serbisë presidencën e radhës së BSEC-it, një organizatë e themeluar në verën e vitit 1992, me rol të rëndësishëm në bashkëpunimin rajonal. Takimi zhvillohej në Moskë,

në një klimë politike veçanërisht të ndjeshme për Ballkanin dhe sidomos për Kosovën. Pikërisht në ato ditë të takimit, mora një njoftim tepër konfidencial nga përfaqësuesi ynë në zyrën qendrore të BSEC-it në Stamboll, sipas të cilit një konvoj prej 18 kamionësh, i paraqitur si "ndihmë humanitare", por i mbushur me armatim për rebelët, ishte nisur me destinacion për tek serbët e Mitrovicës së Veriut. Kamionët mbanin logon "Humanitarian Aid granted by BSEC". Në dijeni të plotë për këtë veprim ishin vetëm tre shtete: Rusia, Greqia dhe Serbia, të cilat po vepronin në mënyrë të koordinuar brenda strukturave të organizatës, duke anashkaluar nëntë shtetet e tjera anëtare dhe duke shkelur protokollet e nënshkruara, në një situatë ku Hungaria dhe Serbia nuk ishin palë nënshkruese të tyre.

Në takim mora fjalën dhe e ngrita çështjen drejtpërdrejt, duke denoncuar shkeljen flagrante të rregullave të BSEC-it dhe përdorimin e organizatës si mbulesë për një veprim të njëanshëm, me pasojë potencialisht katastrofike për rajonin. Debati që pasoi ishte i hapur dhe i fortë, mes delegacionit shqiptar, të mbështetur nga delegacionet e Turqisë dhe Bullgarisë, përballë atyre rus, serb dhe grek. Si rezultat i kësaj ndërhyrjeje, autorizimi u tërhoq dhe karvani i ashtuquajtur "humanitar" nuk arriti kurrë në Mitrovicë. Zbulimi dhe ndalimi i këtij veprimi ishte jetik për Kosovën dhe për stabilitetin rajonal. Kjo mbetet një dëshmi konkrete se diplomacia, kur ushtrohet me përgjegjësi, vigjilencë dhe guxim, mund të parandalojë veprime të rrezikshme pa zhurmë, por me efekt të drejtpërdrejtë dhe vendimtar.



III. MISIONET KULTURORE DHE ZËRI I NJË KOMBI TË VOGËL

HEJZA: Vendet e vogla shpesh gabimisht perceptohen si zëra të DOBËT në korin e popujve. E megjithatë, kur një vend i vogël ka njerëz të mëdhenj, ai zë jo vetëm shquhet, por shpesh shndërrohet në rezonancë të ndërgjegjes botërore. Ju keni qenë shpesh ajo rezonancë. Cili është çelësi i përçimit të një kulture të vogël në një skenë të madhe? Si e keni përkthyer “shqiptarinë” në gjuhën e botës?

MAL BERISHA: Së pari, mendoj se përgatitja e thellë në planin historik, kulturor, gjuhësor dhe tradicional të një diplomati është një kërkesë *sine qua non*. Kur ky nivel njohjeje dhe formimi është i pranishëm, krijohet jo vetëm mundësia, por edhe garancia që përfaqësimi të jetë dinjitoz. Unë jam përpjekur ta përkthej shqiptarinë në gjuhën e botës përmes historisë sonë, kulturës dhe kontributit njerëzor, duke vënë në plan të parë vlerat që na lidhin me të tjerët si njerëz: qëndresën, mikpritjen, besën dhe respektin për tjetrin. Në këtë mënyrë, shqiptaria nuk është paraqitur si një

identitet që kërkon vëmendje, por si një kulturë që meriton respekt dhe dialog të barabartë në skenën e madhe botërore. Ky proces ka qenë rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Në Turqi, javët e kulturës shqiptare në Stamboll, prezantimi i artistëve shqiptarë përpara audience vendase, koncertet në Qendrën Kulturore Atatürk, si dhe ekspozitat e ndërsjella të arteve figurative, kanë përbërë thelbin e punës sime në fushën e diplomacisë kulturore. Po aq e rëndësishme ka qenë edhe vënia në dukje e kontributit shqiptar në historinë e Perandorisë Osmane. Fakti që vetë himni kombëtar turk është vepër e poetit shqiptar Mehmet Akif Ersoy, roli historik i familjes së Köprülive, figura e Mehmet Ali Pashës së Kavallës, themeluesit të Egjiptit modern, si dhe respekti tradicional që shqiptarët kanë gëzuar në atë hapësirë historike.

Megjithatë, kjo qasje nuk mjaftonte gjithmonë, për sa kohë identiteti shqiptar rrezikonte të tretjej nën një lexim të përgjithësuar osman, ku shqiptarët perceptoheshin thjesht si “qytetarë të Perandorisë”, pa dallimin e nevojshëm të individualitetit të tyre kombëtar gjatë asaj periudhe të

gjatë sundimi. Pikërisht këtu, detyra e diplomatit shqiptar ishte të ruante ekuilibrin mes vlerësimit të historisë së përbashkët dhe mbrojtjes së identitetit të veçantë kombëtar shqiptar. Në Londër, si element të diplomacisë kulturore përdora teorinë e Soft Power, një term i formuluar nga filozofi i shquar amerikan Joseph Nye. Aty ku mundësitë ishin edhe më të mëdha, javët e artit dhe kulturës shqiptare, të titulluara *Notes on Albania*, me pjesëmarrjen e artistëve më të mëdhenj shqiptarë si Ermonela Jaho, Inva Mula, Marialea Cingo (pianiste), Alda Dizdari (violiniste), Sir Noel Malcolm me librat e tij kushtuar shqiptarëve *Agjentët Perandorakë*, Arlinda Morava, Bashkim Ahmeti (piktor), Mirush Kabashi (aktor), si dhe lektorë e muzikantë të shquar, e bënë këtë përpjekje shumë më të larmishme, më të pasur dhe më të bukur.

HEJZA: Kur një komb i vogël flet, sipas jush, cili është elementi që e bën botën të ndalet e ta dëgjojë?

MAL BERISHA: Kur një komb i vogël flet me të vërtetën e tij morale, bota ndalet dhe e dëgjon. Nuk është madhësia e territorit apo fuqia ekonomike që e bën një zë të dëgjohej, por drejtësia e kauzës dhe sinjeriteti me të cilin ajo përcillet. Zbatimi i teorisë së *Soft Power* ka qenë një nga mjetet më efikase për njohjen dhe vlerësimin e traditës së mrekullueshme shqiptare përpara audiencave të caktuara. *Besa shqiptare dhe mbrojtja që shqiptarët u kanë dhënë hebrenjve gjatë historisë së tyre, veçanërisht gjatë Holokaustit, përbëjnë një rast të veçantë dhe unik në gjithë Evropën.*

Historia e shqiptarëve e dëshmon këtë qartësisht. Mjafton të kujtojmë vendosjen e bustit të Skënderbeut në Londër, i cili dëshmon qëndresën



e kombit tonë dhe u shndërrua në një simbol european të mbrojtjes së lirisë dhe të qytetërimit perëndimor. Po kështu, prezantimet dhe promovimet që unë kam realizuar në selinë e Ambasadës Amerikane në Londër, në Universitetin Harvard, në Akademinë Diplomatike të Vjenës, në Shkollën e Diplomacisë në Gjenevë, si dhe në shumë institucione të tjera akademike botërore, tregojnë se kur një komb flet me argument, kulturë dhe dinjitet, ai fiton respekt dhe vëmendje. Bota ndalet për të dëgjuar kur një komb i vogël nuk kërkon mëshirë, por barazi; nuk ngre zërin për t'u ankuar, por për të dëshmuar vlerat që ka dhënë dhe vazhdon t'i japë njerëzimit. Pikërisht në këtë përputhje mes historisë, moralit dhe kulturës, zëri i kombit tonë të vogël shndërrohet në një zë të madh.

HEJZA: A keni pasur momente kur keni ndier se botës i mungonte një fjalor për të kuptuar shpirtin shqiptar, dhe ju është dashur ta krijonit atë?

MAL BERISHA: Po. Një nga këto momente ka qenë gjatë një ligjërata që mbajta në *YIVO Institute of Jewish Research* në Manhattan, New York. Atje po shpjegoja *Besën* shqiptare, Kodin e Mikpritjes, Kanunin e Lekë Dukagjinit, si dhe mënyrën se si shqiptarët i shpëtuan hebrenjtë, duke marrë mbi vete rreziqe të jashtëzakonshme. Në një çast, një zonjë nga salla më pyeti: "Çfarë ju bëri ju, shqiptarëve, një popull i vogël dhe i vuajtur, që të na mbronit neve, kur pothuajse e gjithë Evropa na vrau, na persekutoi dhe na shfarosi?"

Në ato ditë kishte ndodhur një ngjarje tragjike në Boston. Një grua kishte rënë me makinë poshtë rrugës, në orët e para të mëngjesit. Ajo kishte shkuar të kërkonte ndihmë në shtëpinë e parë që kishte parë me dritë të ndezur. I zoti i shtëpisë, sapo e kishte parë në derë, kishte marrë armën dhe e kishte vlarë në pragun e shtëpisë së vet, duke e konsideruar si shkelëse e pasurisë së tij. Kur u shpjegoja se në



Shqipëri, nëse nuk i hap derën dhe nuk strehon dikë që të troket, qoftë edhe armikun tënd, kjo konsiderohet një nga aktet më të pa moralshme në botën shqiptare, salla mbeti e shtangur.

HEJZA: Nëse do të mund t'i jepnit botës vetëm një imazh, një tingull apo një histori që e përfaqëson më mirë botën shqiptare, cili do të ishte ai?

MAL BERISHA: Do t'i jepja botës historinë e një njeriu që ngrihet nga hiri i së djeshmes, pa urrejtje, por me dinjitet. Ky është, për mua, imazhi më i pastër i shpirtit shqiptar. Të goditesh rëndë, por të mos thyhesh kurrë; të mbijetosh pa humbur njerëzillekun dhe të ecësh përpara me kokën lart. Megjithatë, për të treguar lashtësinë e kombit tonë dhe kulturën epike shqiptare të rezistencës në rrjedhën e historisë, bëra një gjest jo fort të zakonshëm. Kur i paraqita letrat kredenciale për-

para Madhërisë së Saj, Mbretëreshës Elizabeth II, i dhurova asaj një imitacion të lahutës shqiptare, të punuar në argjend. Ky gjest më dha mundësinë të zhvilloja një bisedë shumë interesante mbi epikën dhe mbijetesën e popullit shqiptar, të përkthyer në vargjet dhe tingujt e lahutës. E lahuta shqiptare tanimë është pjesë e UNESCO-s. Të këtë ndikuar vallë?! Këtë nuk e di!

IV. PËRBALLJET ME HISTORINË DHE TRASHËGIMITË E SAJ

HEJZA: Keni hulumtuar, shkruar dhe dëshmuar mbi figura, ngjarje, momente të errëta dhe të ndritshme të historisë shqiptare. Por hulumtimi i historisë gjithnjë rrezikon ta plagosë shpirtin me të njëjtat plagë që kanë lënë gjeneratat e mëparshme. A ka pasur momente kur historia ju ka lënduar? Dhe si e shndërroni lëndimin në njohje, e njohjen në shërbim publik?

MAL BERISHA: Po, historia lëndon. Sidomos kur ajo shkruhet me të vërteta të cinguar nga armiqët. Unë e kam përdorur dhimbjen si nxitje për të kërkuar të vërtetën dhe për ta vënë atë në shërbim të shoqërisë, që të mos harrohet dhe të mos përsëritet kurrë më. Për këtë arsye jam mbështetur në shkrimet e autorëve anglo-amerikanë si Edith Pierpont Stickney, Charles Telford Erickson, Herman Bernstein, Melville Chater, George Scriven, Aubrey Herbert, Kontesha Elizabeth Herbert, Owen Pearson, Oakley Hill, Richard Knolles, Benjamin Disraeli, Edward Lear, Lord Byron, Edith Durham, Robert Elsie, Edward Brown, Henry Holland, Charles Cochorel, si dhe shumë të tjerë. Mes tyre veçoj Charles Telford Erickson dhe Sir Noel Malcolm, të cilëve u kam kushtuar libra dhe filma dokumentarë. Të gjithë këta, dhe dhjetëra autorë të tjerë anglo-amerikanë, janë dëshmitarë të vuajtjeve të shqiptarëve, zëra që e panë, e kuptuan dhe e thanë të vërtetën për ne, në një kohë kur të tjerët heshtën. Këta autorë i kam studiuar me vëmendje, i kam përkthyer e i kam bërë të përdorshëm për audiencën shqiptare dhe, shpesh, edhe për atë të huaj. Materialet gjenden në faqen time malberisha.com dhe në arkivin tim në INTERNET ARCHIVE.



HEJZA: Kur jeni përballur me dokumente të historisë së errët, a ju është dukur ndonjëherë sikur historia po ju shikon përmes tyre?

MAL BERISHA: Po. Shpesh më është dukur sikur nuk po lexoja unë historinë, por historia po më shikonte mua, duke kërkuar llogari, dëshmi dhe drejtësi. Dokumentet mbi Konferencën e fshehtë të Londrës dhe qëndrimin italian ndaj Shqipërisë në vitet 1915 dhe 1920, të gjetura në *Yale University Divinity Library* në Hartford, Connecticut, kanë qenë ndër dëshmitë më tronditëse për mua. Në ato çaste e kupton se studiuesi nuk është thjesht lexues i arkivave, por bartës i një përgjegjësie morale për ta nxjerrë të vërtetën nga heshtja dhe për t'ia kthyer atë ndërgjegjes së shoqërisë.

HEJZA: Gjatë kërkimeve tuaja historike, cili ka qenë zbulimi që ju ka tronditur më shumë në plan njerëzor?



MAL BERISHA: Po, ishte aq tronditës rrëfimi i botuar në gazetën *The Economist* të Londrës nga Charles Telford Erickson, ku një gazetar francez, që shoqëronte ushtrinë serbe, lavdëronte barbarizmat e saj në Kosovë në shtypin francez. Një ditë, në mes të dimrit, gjatë njërit prej këtyre aksioneve në Ferizaj, ajo ra në duart e shqiptarëve, të cilët, në vend që ta vrisnin, e mbrojtën, e nxorën nga fronti i luftës dhe e përcollën të sigurt drejt Francës. Në këto dokumente kuptova se historia jo vetëm dhu-non, por edhe provon ndërgjegjen njerëzore, dhe se shqiptarët, edhe në errësirë, zgjodhën njerëzo-ren.

HEJZA: A mendoni se kombet, ashtu si njerëzit, duhet t'i pranojnë plagët që të mund të shërohen?

MAL BERISHA: Po. Ashtu si njerëzit, edhe kombet shërohen vetëm kur pranojnë të vërtetën e plagëve të tyre. Mohimi nuk i shëron plagët; përkundrazi, i shndërron në gangrenë morale.

Vetëm pranimi i së vërtetës i kthen ato në urtësi dhe përvojë historike. Komu-nizmi ishte një nga ato momente dra-matike të shkatërrimit të brendshëm dhe të shpopullimit shpirtëror të kom-bit. Sot, fatkeqësisht, po përballemi me një formë tjetër të të njëjtit fat: shpopullimin fizik. Ndryshojnë meto-dat, por burimi mbetet i njëjtë, i njëjti mentalitet, i njëjti rezervuar njerëzish që dikur prodhoi izolim dhe shtypje sot prodhon largim, dëshpërim dhe shterim kombëtar.

Njëra ishte eksterminim përmes frikës dhe izolimit; tjetra është ekster-minim përmes varfërimit, humbjes së shpresës dhe largimit masiv. Të dyja janë plagë që kërkojnë të vërtetën si kusht të vetëm për shërim.

V. LETËRSIA SI STREHA E DIPLOMATËVE

HEJZA: Njerëzit e diplomacisë shpesh e kërkojnë strehën e tyre te letër-sia, te gjuha që nuk të tradhton, te vargu që të mban, te metafora që të çliron. Shkrimet tuaja, librat tuaj, janë pjesë e këtij universi të brendshëm intelektual që shpesh nuk shfaqet në skenën e pro-tokollit zyrtar. A është letërsia vendi ku diplomatët shkojnë për të shpëtuar vet-veten? Dhe ç'marrëdhënie intime keni ju me shkrimin?

MAL BERISHA: Letërsia është streha ku diplo-matët më në fund mund të heqin kostumin e pro-tokollit dhe të shfaqin shpirtin e lirë. Diplomacia të detyron të flasësh me maturi ndërsa letërsia të lejon të flasësh me të vërtetën që sheh që e ndjen dhe që e fantazon. Në shkrim, unë jo vetëm që gjej qetësinë time të brendshme, por edhe rikthej zëra që historia i ka "detyruar" që të heshtin. Është një mënyrë për të shpëtuar veten nga pesha e hesht-jeve të detyruara dhe, njëkohësisht, për të shpëtuar kujtesën kolektive nga harresa. Këtë e kam gjetur veçanërisht në letërsinë dokumentare, në kërki-min dhe zbulimin e të vërtetave për Shqipërinë në arkiva dhe institucione ndër më prestigjiozet në botë, përfshirë *British Library*, *State Department Archives*, *New York Public Library*, *Yale Divinity School Library*, *YIVO Institute of Jewish History*, *Arkivin e Shtetit Shqiptar*, *Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme*, si edhe *National Geographic*

Magazine. Aty, fjala nuk shërben për të fshehur, por për të zbuluar, jo për të zbuluar realitetin, por për ta thënë atë ashtu siç ka qenë. Në këtë kuptim, letërsia nuk është thjesht strehë për diplomatët, ajo është shprehja më e vlefshme e lirisë së tyre.

HEJZA: A shkruhet më shumë për të shpjeguar botën, apo për të shpëtuar një pjesë të vetes që nuk mund ta mbajmë brenda?

MAL BERISHA: Mendoj se shkruajmë për të dyja njëkohësisht. Duke u përpjekur të shpjegojmë të vërtetën përpara botës, shpëtojmë diçka nga vetja; dhe duke shpëtuar diçka nga vetja, i japim botës mundësinë të na kuptojë më mirë. Shkrimet e mia, edhe pse të ndërtuara me kujdes të madh gjuhësor dhe stilistik, nuk mund të kategorizohen si krijimtari letrare e dorës së parë në kuptimin klasik. Ato kanë më shumë natyrën e zbulimit, të nxjerrjes në dritë të vlerave më të bukura që mbart kombi ynë, shpesh të artikuluar përmes zërave të huaj anglo-saksonë, me besueshmëri të lartë shkencore, historike dhe dokumentare. Ky është vetëm një segment i ngushtë brenda një spektri shumë më të gjerë shkrimi, por një segment që e ndiej si detyrim moral: të ruaj, të përkthej dhe të përcjell një trashëgimi që rrezikon të humbasë, nëse nuk zbulohet, shkruhet dhe paraqitet me përpikëri dhe ndershmëri.

HEJZA: Librat tuaj përmbajnë edhe emocion, jo vetëm fakt. A keni hezituar ndonjëherë të shfaqni emocion në shkrim nga frika se mund të cenonte objektivitetin?

MAL BERISHA: Po, kam hezituar. Diplomacia më ka mësuar ta mbaj emocionin nën kontroll dhe ta filtroj fjalën përmes arsyes. Por historia nuk është thjesht dhe vetëm një renditje datash, ngjarjesh dhe dokumentesh. Ajo është, mbi të gjitha, përvojë njerëzore: vuajtje, dashuri, suksese, humbje dhe shpresë. Nëse ia heq emocionin historisë, ia ke hequr njeriun. Prandaj jam përpjekur gjithmonë të ruaj një ekuilibër të ndershëm duke bërë që faktet të flasin të parat, por zemra të mos heshtë. Ka pasur raste kur përballja me dokumentet dhe rrëfimet ka qenë tronditëse deri në ngashërim. Vdekja e djalit të Charles Telford Erickson në Elbasan, çmendja e bashkëshortes së tij nga dhimbja, internimi në Shpat të Elbasanit dhe më pas në Manastir janë episode që nuk mund të lexohen thjesht me syrin e historianit të ftohtë. Po aq tronditës është edhe amaneti i kolonel Aubrey Herbert në çastin e vdekjes, lënë



nënës së tij, Konteshës Elizabeth Herbert: “Unë po vdes, por ty po të lë amanet Shqipërinë”, fjalë që shkaktojnë emocion deri në lot.

Shkrimi paralajmërues i Herman Bernstein-it i vitit 1935, “Shqipëria, peng i Fuqive të Mëdha”, botuar në *The New York Times* pasi ai kishte lënë detyrën, të trondit për vërtetësinë e asaj që parashikon pushtimin italian dhe që u realizua vetëm katër vjet më pas, kur ai kishte ndërruar jetë pak kohë pas botimit të atij artikulli. Po aq prekës është edhe përkushtimi i Sir Noel Malcolm ndaj çështjes shqiptare dhe roli që luajti vepra e tij “Kosova një histori e shkurtër” në çlirimin e Kosovës, i cili ngjall emocion admirim të lartë ndaj tij. Në ato çaste e kam kuptuar se emocionin, kur nuk e zëvendëson faktin por e shoqëron atë, nuk e cenon objektivitetin por jeton me të, nuk është i dëmshëm. Përkundrazi, e thellon të vërtetën dhe e bën historinë të jetojë jo vetëm në mendje, por edhe në ndërgjegjen njerëzore.

HEJZA: Nëse nuk do të ishit diplomat, a do të ishit shkrimtar me kohë të plotë?

MAL BERISHA: Me shumë gjasë, Jo. Sepse për mua shkrimi nuk është profesion, por domos-



doshmëri e brendshme. Diplomacia më dha mundësinë të hulumtoja aty ku të tjerët e kishin të vështire ose të pamundur. Letërsia më jep gjuhën për t'i rrëfyer ato. Por pa përvojën e punës që kam pasur gjatë gjithë jetës sime, nuk do të kisha mundur të shkruaja ato që kam shkruar, sado pak që të jenë. Madje mendoj se krijimtaria e lirë, e shkëputur nga përvoja reale, e bën autorin klausrofob dhe njeri të rehatit. Krejt ndryshe është kur mbaron një aktivitet diplomatik, ke zhvilluar një bisedë me një diplomat, ke dëgjuar prej tij, për shembull, se Richard Knolles ka shkruar librin prej 1200 faqesh, *"The Generall Historie of the Turkes"* në vitin 1603, dhe fap të lind një nevojë e brendshme për ta gjetur atë vepër. Më pas harxhon muaj e vite duke hulumtuar, duke e shfletuar librin, duke seleksionuar pjesët që të duhen dhe duke e përkthyer e sjellë përpara lexuesit tënd një histori të madhe rreth Skënderbeut. Në fakt po të isha mbyllur i vetëm në guackën e krijesit, nuk do të kisha dëgjuar ndonjëherë për atë libër Ky libër, mbi të cilin kam punuar disa vjet do botohet së shpejti. Në një mënyrë ose në një tjetër, jam i bindur se do të kisha përfunduar gjithsesi me penë në dorë, sepse shkrimi nuk ishte një zgjedhje


karriere, por një mënyrë për të kuptuar botën dhe për ta pasqyruar atë.

VI. FIGURA ANGLO-AMERIKANE DHE RIKTHIMI I NJË HISTORIE TË MUNGUAR

HEJZA: Puna juaj shumëvjeçare mbi figura si Charles Telford Erickson, Herman Bernstein, Carleton S. Coon, Benjamin Disraeli, Richard Knolles, Aubrey Herbert, *Anglo-Albanian Association*, Sir Noel Malcolm si president i sotëm i saj, dhe të tjerë, ka rikthyer në kujtesën kolektive një kapitull të lënë në hije të historisë sonë. Ky rilexim nuk ka qenë thjesht një akt akademik, por një akt ndriçimi kombëtar. Çfarë ndjetë në çastin e parë kur zbuluat një dokument apo dëshmi që ndryshonte narrativën shqiptare për këto figura? Dhe çfarë lidhje thelbësore kishin ato me Presidentin Woodrow Wilson dhe me fatin e Shqipërisë?

MAL BERISHA: Çdo herë që kam zbuluar një dokument të ri për Charles Telford Erickson, Herman Bernstein apo Carleton S. Coon, kam pasur ndjesinë se po hapej një dritare që ishte mbajtur qëllimisht e mbyllur. Emocioni i parë ka qenë gjithmonë i njëjtë: Tronditje, gëzim dhe një ndjenjë e fortë përgjegjësie. Kjo sepse ata ishin lënë me qëllim jashtë kujtesës sonë kombëtare. Censura komuniste e kishte ndaluar që këta emra të përmendeshin në çfarëdo lloji forme, ndonëse ata i kishin kushtuar jetën Shqipërisë. Këta nuk ishin thjesht studiues apo diplomatë të huaj. Ata ishin miq të vërtetë të Shqipërisë në momentet e saj më të errëta. Erickson e deshi Shqipërinë si atdhe të dytë, punoi për forcimin e miqësisë shqiptaro-amerikane, mori pjesë në Konferencën e Paqes në Paris më 1919 dhe në atë të San Franciskos më 1945, si edhe themeloi Institutin Shqiptaro-Amerikan të Bujqësisë në Golem të Kavajës.

Bernstein, si ambasador i Shteteve të Bashkuara në Tiranë, e mbrojti hapur çështjen shqiptare dhe denoncoi padrejtësitë ndaj saj. Carleton S. Coon, përmes studimeve antropologjike dhe veprës *The Mountains of Giants*, (libër të cilin e kam përkthyer e botuar në 2024) i dha botës një portret dinjitoz të shqiptarëve Gegë, në një kohë keqinterpretimesh dhe paragjykimesh. Të tre kishin një lidhje të ngushta me Presidentin Woodrow Wilson. Ata ishin zëri i parimeve Wilsoniane që i thanë botës: "Shqipëria duhet të ekzistojë." Wilson e mbrojti Shqipërinë në Konferencën e Paqes në Paris, por ishin këta njerëz që ia çuan të vërtetën në tryezë. Ndjeva se ishte detyrë e brezit tonë t'i sillnim sërish në dritë. Sepse historia e tyre



është edhe një pasqyrë e karakterit tonë si komb. Kur gjejmë dhe nderojmë miqtë tanë të vërtetë, Shqipëria ecën përpara. Aubrey Herbert hodhi themelet e *Anglo-Albanian Association* për të ndihmuar pavarësinë e Shqipërisë dhe mëkëmbjen e shtetit të ri shqiptar. Edith Durham, nga ana e saj, e bëri çështjen shqiptare të pranishme dhe të kuptueshme në sytë e botës anglishtfolëse, duke e kthyer atë në një kauzë morale dhe njerëzore të opinionit publik britanik.

HEJZA: Çfarë ishte ajo që ju tërhoqi fillimisht drejt figurave amerikane të lidhura edhe me Presidentin Wilsonit, kurioziteti intelektual apo një thirrje më e thellë shpirtërore?

MAL BERISHA: Në fillim ishte thjesht një kuriozitet intelektual: Si ishte e mundur që figura të tilla amerikane, të lidhura drejtpërdrejt edhe me Presidentin Woodrow Wilson, kishin qenë kaq të rëndësishme për ekzistencën tonë shtetërore dhe, megjithatë, të zhdukura nga historia jonë? Por shumë shpejt ky kuriozitet u shndërrua në diçka krejt tjetër. Ishte profesori amerikan John Freely, i cili jepte mësim në *Kolegjin Robert*, sot *Universiteti i Bosforit*, ai që më solli në zyrën time në Stamboll librin e Edith Pierpont Stickney me titull *Shqipëria e Jugut ose Epiri i Veriut në Çështjet Evropiane Ndërkombëtare, 1920–1923*. Ky punim ishte mbrojtur si

doktoraturë në Universitetin Stanford, në Kaliforni. Më pas, kur u njoha me dokumentet e tyre, me letrat drejtuar Uashingtonit dhe me përpjekjet e jashtëzakonshme që bënë për të mos e lënë Shqipërinë të fshihej nga harta, e kuptova se nuk kisha më të bëja thjesht me një temë studimore. Prandaj e përktheva dhe e botova. Kisha përballë një borxh njohjeje dhe mirënjohjeje. Në një farë mënyre, ishte si një thirrje që vinte nga ndërgjegjja e kombit tonë: “Mos i lini në harresë ata që na shpëtuan.”

Këta amerikanë e deshën Shqipërinë edhe në çaste kur shumë shqiptarë kishin humbur besimin te vetja. Prandaj rrugëtimi im drejt tyre nuk ishte më vetëm hulumtim historik, por një akt misioni dhe falënderimi dhe një përpjekje për ta rivendosur të vërtetën në vendin që i takon. Ishte shteti shqiptar ai që më dha mundësinë të lëvizja, të kërkoja dhe të hulumtoja. Shpërblimi im i vetëm për këtë besim ishte detyrimi im moral për të shkruar dhe për të botuar. Dhe ja ku jemi.

HEJZA: A keni menduar se çfarë do të kishte ndodhur me Shqipërinë nëse Wilson nuk do të kishte ekzistuar?

MAL BERISHA: Po, e kam menduar shpesh. Dhe përgjigjja është e thjeshtë, por e dhimbshme: Ndoshta Shqipëria nuk do të ishte ajo që është sot. Në Konferencën e Paqes në Paris, më 1919, fuqitë e mëdha ishin gati ta copëtonin Shqipërinë mes fqinjëve. Në atë tryezë kishte vetëm një zë të fortë që tha “Jo”, zëri i Presidentit Woodrow Wilson. Dokumentet që kam gjetur në Universitetin Yale dhe në arkivat e Departamentit të Shtetit Amerikan tregojnë qartë se ai nuk veprroi për interesa strategjike, por nga një bindje e thellë morale se çdo komb, i madh apo i vogël, ka të drejtë të jetojë i lirë, sipas parimit të *vetëvendosjes së kombeve*, të mishëruar në Katërmëdhjetë Pikat e tij. Për këtë arsye, unë e quaj shpesh Woodrow Wilson-: “*Presidenti i një kombi që nuk na njihte aq shumë, por që na shpëtoi.*”

Kontributi i tij nuk i përket vetëm historisë pasi është një nga themelet morale mbi të cilat u mbështet ekzistenca e shtetit shqiptar.

HEJZA: A mendoni se misioni juaj i lidhur me figurën e Wilsonit është një kapitull i mbyllur apo ende ka dokumente që presin të flasin?

MAL BERISHA: Nuk e mbaj veten si një “*Wilsonolog*”. Megjithatë, mendoj se ky mision nuk është aspak një kapitull i mbyllur. Përkundrazi, ende ka shumë dokumente të panjohura, letra të pushfletuara dhe gjurmë historike që presin të dalin në dritë. Në arkivat amerikane, britanike

dhe evropiane fshihen ende pjesë të rëndësishme të historisë sonë: vendime të marra në heshtje, takime të zhvilluara larg syve të botës dhe njerëz që punuan për Shqipërinë pa kërkuar asnjëherë mirënjohje. Jam i bindur se zëri i Woodrow Wilson- për Shqipërinë ka ende kapituj për t'u rrëfyer. Sepse misioni im nuk është thjesht të kujtoj atë që ka ndodhur, por të sigurohem që historia të mos heshtë më kurrë, sidomos kur bëhet fjalë për të drejtën e kombit tonë për të ekzistuar. Ky mision, sigurisht, nuk bie vetëm mbi mua, por mbi qindra shqiptarë dhe të huaj që studiojnë historinë tonë. Ndoshta unë jam më i vogli në atë listë.

VII. SHËRBIMI PUBLIK SI SAKRIFICË E HESHTUR

HEJZA: Në shoqëritë tona, shpesh meritoret nuk ngrihen mbi zhurmën, dhe ata që kanë dhënë më shumë, kanë heshtur më shumë. Ju keni qenë pjesë e asaj profecie të heshtur që punon pa kërkuar duartrokitje. A keni menduar ndonjëherë se sakrifica publike ndonjëherë e mbart një vetmi të brendshme? Dhe si e keni përballuar këtë vetmi?

MAL BERISHA: Po, shërbimi publik mbart një vetmi shumë të veçantë, vetminë e përgjegjësisë. Je gjithmonë mes njerëzve, por jo gjithmonë ata janë me ty, as ti me ta. Vendimet i merr vetë, pasojat i përballon vetë, ndërsa duartrokitjet, kur vijnë, shpesh i merr dikush tjetër. Është një barrë e heshtur, që nuk shihet nga jashtë, por që peshohet rëndë nga brenda. Unë e kam përballuar këtë vetmi duke e kuptuar se nuk ka sakrificë të kotë kur ajo bëhet për atdheun.

Dhe në fund të çdo dite të vështirë, mjafton të jesh në paqe me ndërgjegjen dhe t'i thuash vetes: "Kam bërë atë që duhej bërë."

Më kujtohet një rast, gjatë 100-vjetorit të marrëdhënieve shqiptaro-amerikane, në vitin 2012. Kisha përgatitur një ekspozitë me 22 poster, kushtuar biografive të 22 burrave më të rëndësishëm amerikanë që kishin pasur lidhje me Shqipërinë dhe shqiptarët. Ekspozita u paraqit pa autorësi, sepse autorësia e vërtetë ishte lidhja shpirtërore që më shtyu ta realizoja, jo egoja për të treguar vetveten. Kjo është shoqëria më e mirë që mund të ketë një njeri në vetminë e tij.

HEJZA: A është e mundur që njeriu të shërbejë shumë pa humbur diçka nga vetja? Çfarë mendoni sot?

MAL BERISHA: Çdo shërbim i vërtetë ka një kosto. Njeriu nuk mund të japë shumë pa lënë

diçka të vetën pas dore: Kohën, qetësinë, ndonjë ëndërr personale. Por sot mendoj kështu: Nëse ajo që ke dhënë është më e madhe se ajo që ke humbur, atëherë nuk ke humbur asgjë. Përkundrazi, ke fituar.

HEJZA: Si e balanconi misionin publik me jetën personale, kur të dyja kërkojnë kohë dhe prezencë?

MAL BERISHA: Balanca nuk ka qenë kurrë e përsosur, dhe as nuk e kam pretenduar ndonjëherë si të tillë. Ka pasur periudha kur misioni publik ka marrë gjithçka, ndërsa jeta personale ka pritur në heshtje. Në këto momente, dashuria e familjes është bërë strehë dhe shtyllë. Ajo më ka mbajtur si njeri, ndërsa detyra më ka mbajtur në këmbë. Përqijem të bëj më të mirën e mundshme në të dyja, duke e pranuar me modesti se, ndonjëherë, është familja ajo që ka bërë sakrificën më të madhe.

HEJZA: Cili ka qenë çmimi emocional më i lartë që keni paguar në emër të shërbimit?

MAL BERISHA: Çmimi emocional më i lartë ka qenë mungesa. Mos prania ime fizike në momente që nuk kthehen më. Në rritjen e fëmijëve, mungesa në ditët e gëzimeve familjare. Koha ikën dhe nuk kthehet më. Ndaj, ndonëse jam i nderuar për gjithçka kam bërë për vendin tim, zemra ime e di se shërbimi publik gjithmonë e kërkon këtë çmim të heshtur, një çmim që nuk shihet, por që ndihet thellë. Nëntë vitet e mia larg familjes, në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), kanë qenë vite privacionesh të mëdha, që nga mungesa e përditshme e dashurisë së njerëzve të mi, bashkëshortes dhe fëmijëve, deri te vështirësitë e jetës bazike dhe rreziku për vetë jetën në Mitrovicë.

VIII. QYTETARI GLOBAL ME RRËNJË SHQIPTARE

HEJZA: Të jetosh mes kulturash, të ndërveprosh mes disa botëve, të negociosh mes horizontesh, kjo është një gjuhë e dytë që diplomatët e zotërojnë pa e shkruar askund. Por rrënjët janë aty, fshehur nën çdo vendim, çdo nënshkrim, çdo fjalë. Si i ka ruajtur Mal Berisha rrënjët e tij në udhëtimet e gjata të jetës? A ka pasur momente kur rrënja dhe horizonti janë ndeshur?

MAL BERISHA: Rrënjët i kam ruajtur duke mos harruar kurrë se kush jam dhe nga vij, duke e mbajtur Shqipërinë gjithmonë me vete, në mendje dhe në zemër. Por, në çdo udhëtim, në çdo takim,

kam mësuar se sa më shumë e njeh tjetrin, aq më fort e çmon vendin tënd.

HEJZA: Në udhëtimet dhe misionet tua, cilën pjesë të Shqipërisë keni ndier gjithmonë se mbani me vete, edhe kur nuk e mendoni?

MAL BERISHA: E mbaj me vete dialektin Gegë, mikpritjen dhe krenarinë malësore. Janë tri gjëra që mendoj se më përfaqësojnë natyrshëm: Shqipja gegnisht që më tregon origjinën; Zemra e hapur për këdo që më drejtohet për çfarëdo lloj nevojë, edhe kur nuk kam asnjë lidhje me hallin e tij apo të saj; dhe Bujaria, edhe në kushtet kur vetë nuk jam gjithmonë i rehatshëm nga ana materiale. Edhe kur jam larg, kam me vete një Shqipëri, një Kosovë, një Çamëri, një Preshevë e Bujanoc, një Maqedoni Shqiptare, një shqiptari të tërë në Mal të Zi.

HEJZA: A ka pasur ndonjë moment kur jeni ndier më shumë “njeri i botës” sesa “njeri i vendlindjes”?

MAL BERISHA: Po, ka pasur! Kur përfaqësoja Shqipërinë në tryeza ndërkombëtare dhe punoja për paqe, bashkëpunim dhe mirëkuptim mes kombeve, shpesh ndihesha pjesë e një bote më të gjerë se kufijtë e mi. Por, edhe në ato çaste, kur isha “qytetar i botës”, zemra më kujtonte se ky rol global i ka rrënjët te vendlindja dhe se është i përkohshëm. Nuk mund të jem qytetar i botës pa qenë më së pari shqiptar.

HEJZA: Kur ktheheni në Shqipëri pas udhëtimeve të gjata, çfarë është gjëja e parë që e kërkon shpirti juaj?

MAL BERISHA: Kur kthehem në Shqipëri, shpirti im kërkon gjërat më të thjeshta dhe njëkohësisht më të dashura, zërat e njerëzve të mi, aromën e tokës dhe atë ndjenjë të pashpjegueshme përkatësie. Sado larg të kem qenë, sapo prek Shqipërinë, e ndiej se kam mbërritur aty ku më pushojnë më rehatshëm trupi, mendja dhe zemra.

IX. TRASHËGIMIA

HEJZA: Në fund të çdo kapitulli të madh jetësor, lind pyetja e heshtur: çfarë mbetet? Çfarë i le botës, çfarë i le kombit, çfarë u le brezave? Nëse sot do të duhej të përkufizonit trashëgiminë tuaj në tri fjalë, cilat do të ishin ato? Dhe pse?

MAL BERISHA: Nëse do të duhej ta përkufizoja trashëgiminë time vetëm me tri fjalë, do të zgjidhja: Kujtesë – Dinjitet – Shërbim.

Kujtesë, sepse kam besuar gjithmonë se kombi ynë jeton aq sa kujton. Aq sa kam mundur, kam punuar që historia jonë të mos injorohet dhe as të harrohet për nevoja të përkohshme politike. Dinjitet, sepse çdo veprim timin kam dashur ta mbështes te e vërteta dhe te nderi im, pa asnjë interes material. Nuk është e tepërt ta them se, nga i gjithë “korpusi” i punëve të mia, nuk kam përfituar kurrë as edhe një dollar të vetëm. Çdo gjë e kam bërë me mundësitë e mia dhe me mbështetjen e zonjës sime dhe djemve të mi. Shërbim, sepse kjo ka qenë arsyeja dhe qëllimi që më ka shtyrë përpara në çdo etapë të jetës dhe punës sime. Nëse këto tri vlera do të mbeteshin diku, do t’i kujtoheshin ndonjëherë dikujt në ndonjë shkrim, libër apo bisedë, ose në kujtimet e dikujt, atëherë do ta quaja veten me fat.

HEJZA: Kur mendoni për gjurmën që lë njeriu pas, çfarë mendoni se e bën atë të qëndrueshme përtej një brezi?

MAL BERISHA: Mendoj se gjurma që mbetet përtej një brezi nuk është ajo që shohim, por ajo që ndiejmë. Ajo nuk matet me monumente, tituj apo poste, por me ndikimin që ke pasur në jetët e njerëzve. Ajo që e bën një gjurmë të qëndrueshme është e vërteta që mbrojmë, e mira që bëjmë dhe shpresa që frymëzojmë. Nëse një brez i ardhshëm thotë: “Falë tij, mësuam diçka më shumë dhe më mirë se kush jemi”, atëherë “gjurma” është lënë dhe është e pavdekshme.

HEJZA: A mendoni ndonjëherë se veprat tua do t’u flasin brezave ndryshe nga ç’ju flasin njerëzve sot?

MAL BERISHA: Po, çdo vepër flet ndryshe për çdo brez. Prandaj kam arkivuar gjithçka që kam shkruar dhe që vlen të bëhet publike sot, me bindjen se nesër dikujt mund t’i duhet të kuptojë si janë trajtuar marrëdhëniet e shqiptarëve me botën anglo-amerikane në kohën tonë. Ajo që sot duket histori, nesër bëhet mësim. Brezat që vijnë, të çliruar nga emocionet dhe konfliktet e sotme, do ta shohin më qartë thelbin: “Liria kushton, identiteti kërkon mbrojtje dhe e vërteta nuk vjetrohet kurrë.” Në këtë kuptim, shpresoj dhe besoj se ajo që kam lënë në këto platforma do t’u flasë më qartë atyre që vijnë pas nesh.

HEJZA: Nëse pas pesëdhjetë vitesh, një i ri shqiptar do të përballej me punën tuaj, cili do të ishte kuptimi që do të dëshironit të nxirrte për jetën dhe veprimin njerëzor?

MAL BERISHA: Do të doja të kuptonte një të vërtetë të thjeshtë, por thelbësore: se ia vlen të jetosh përtej vetvetes.

Ia vlen të mbrosh të vërtetën, edhe kur ajo të kushton.

Ia vlen të mbash gjallë kujtesën, edhe kur të tjerët përpiqen ta fshijnë.

Ia vlen t'i shërbesh kombit tënd, edhe kur duket se askush s'e vëren.

Nëse një i ri, pas pesëdhjetë vitesh, do të thoshte: "Ky njeri nuk u pajtua me padrejtësinë, punoi për vendin e tij dhe besoi se Shqipëria meriton më shumë", atëherë çdo përpjekje do të kishte marrë kuptim.

X. EPILOGU: NJERIU, KOHA DHE KUPTIMI I FUNDIT

HEJZA: Njeriu e kalon jetën duke grumbulluar gjurmë, disa të dukshme, të tjera të padukshme; disa që i lë te njerëzit, të tjera që i mbeten vetëm shpirtit. Koha, ndërkaq, ecën si një lumë pa kthim, duke na mësuar se asgjë nuk është plotësisht e jona, veç asaj që i kemi falur botës. Në fund, çdo njeri mbetet përballë vetes, përballë pyetjes më të vështirë: ç'kuptim pati gjithçka? Ky është momenti ku njeriu nuk flet më si diplomat, as si shkrimtar, as si historian, por si qenie që ka jetuar, ka dashur, ka gabuar, ka shpresuar. Në këtë frymë, po mbyllim me një kapitull që i drejtohet thelbit njerëzor të Mal Berishës. A mendoni se njeriu është ai që bën, apo ai që lë? Në mënyrë të sinqertë, çfarë keni dëshiruar që njerëzit të kuptojnë saktësisht nga veprimet tuaja?

MAL BERISHA: Mendoj se njeriu është edhe ajo që bën, edhe ajo që lë pas. Por në fund, ajo që mbetet nuk janë veprimet në vetvete, por gjurma e tyre në ndërgjegjen e të tjerëve. Ajo që ke bërë mund të harrohet; ajo që ke lënë te njerëzit, te kujtesa dhe te e vërteta, jeton më gjatë se ti. Unë kam dashur që njerëzit të kuptojnë një gjë të thjeshtë: se gjithçka që kam bërë nuk ka qenë për veten time, por për diçka më të madhe se unë. Kam dashur të kuptohet se Shqipëria nuk është një rastësi gjeografike, por një vend të cilit i detyrohemi deri në vdekje. Se historia jonë nuk është një barrë për t'u fshehur, por një pasuri për t'u bërë e njohur dhe për t'u mbrojtur. Se shërbimi nuk matet me përfitime, por me ndershmëri dhe efikasitet. Nëse dikush, duke parë veprimet e mia, do të kuptonte se mund të jetosh me dinjitet pa bërë zhurmë, se mund të mbrosh të vërtetën pa urrejtje, se mund



t'i shërbesh vendit tënd pa e përdorur atë për përfitime personale, aq më keq të pamerituara, atëherë do të ndihesha i qetë me veten time. Në fund, nuk dua të më kujtojnë as si diplomat, as si shkrimtar, as si historian. Dua të më kujtojnë si një njeri që nuk u pajtua me harresën, që nuk bëri tregti me të vërtetën dhe që besoi, deri në fund, se shqiptarët meritojnë të flitet për ta me zë të lartë dhe të mbrohen me ndërgjegje të pastër.

HEJZA: Kur lexoni shënimet tuaj, qofshin ato nga notesi i rinisë, i kohëve të vështira, apo i periudhave të suksesit, çfarë zëri dëgjoni aty: një zë që kërkon udhë, apo një zë që kërkon kuptim?

MAL BERISHA: Kur rikthehem te shënimet e mia, dëgjoj dy zëra që ecin paralelisht. Njëri është zëri që kërkon udhë, që pyet:

"Ku duhet të shkoj tani? Si t'i shërbej më mirë vendit tim? Çfarë mund të bëj më shumë?" Tjetri është zëri që kërkon kuptim, dhe pyet:

"A ia vlejti? A po le një gjurmë që do të mbetet? A po mbetem besnik ndaj asaj që besoj?"

Në rini, zëri që kërkonte udhë ishte më i fortë, ishte një shtysë për t'ia dalë, për të provuar veten, për të mos humbur kohë. Sot, zëri i dytë është bërë më i thellë. Ai e kërkon kuptimin pas çdo hapi. Por, në secilën faqe të atyre shënimeve, një gjë mbe-

tet e pandryshueshme: Dëshira për të bërë punë të mira. Ndoshta pikërisht aty takohen udha dhe kuptimi.

HEJZA: Nëse do të takonit veten tuaj 20 vjeç sot, çfarë këshille do t'i jepnit, jo si njeri që ka bërë një karrierë të suksesshme, por si njeri që ka parë të dyja anët e jetës: dritën dhe errësirën?

Vepra e shkruar e Mal Berishës nuk është thjesht një korpus librash, por një projekt i qëndrueshëm kulturor dhe diplomatik, në të cilin historia, identiteti kombëtar dhe diplomacia e kujtesës ndërthuren në mënyrë organike. Që nga studimet mbi mënyrën se si Shqipëria dhe shqiptarët janë parë nga bota perëndimore, e deri te monografite kushtuar figurave kyçe të diplomacisë amerikane dhe britanike, librat e tij ndërtojnë një narrativë të qëndrueshme për Shqipërinë si subjekt historik, kulturor dhe politik në arenën ndërkombëtare.

Mal Berisha botoi këta libra:

1. Shqiptarët, lisa mbi truallin ilir (2007)

Një studim i gjerë dhe i dokumentuar mbi artikujt e revistës amerikane *National Geographic Magazine* për Shqipërinë dhe shqiptarët, përgjatë më shumë se një shekulli.

2. Shqiptarët, evropianët më të lashtë dhe më të rinj (2008)

3. Charles Telford Erickson – Amerikani që i kushtoi jetën Shqipërisë (2012)

Botim monumental në tre vëllime, në gjuhën shqipe. Vëllimi i parë përmban një biografi të thelluar dhe të dokumentuar të jetës dhe veprës së Charles Telford Erickson, ndërsa dy vëllimet e tjera sjellin veprën e tij të plotë: pesë libra të mbetur më parë pa botuar, tashmë të përkthyer dhe të botuar me titullin ***Shqiptarët – Enigma e Ballkanit***.

4. Herman Bernstein – Jeta dhe vepra (2014, anglisht; 2018, shqip)

Një studim që ndriçon marrëdhëniet e veçanta ndërmjet hebrejve, shqiptarëve dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përmes figurës së diplomatit dhe intelektualit Herman Bernstein.

5. Ambasadori amerikan Herman Bernstein në Mbretërinë Shqiptare (1930–1933) (2018)

Monografi historike mbi veprimtarinë diplomatike të ambasadorit amerikan Herman Bernstein në Shqipëri, në një nga periudhat më delikate të shtetformimit shqiptar.

6. Realitetet shqiptaro-britanike (2015)

Botuar në gjuhën shqipe në prag të përfundimit të misionit diplomatik të autorit në Mbretërinë e Bashkuar, libri trajton marrëdhëniet historike dhe bashkëkohore shqiptaro-britanike në plan politik dhe kulturor.

7. Ambasador i pushtetit të butë / The Ambassador of Soft Power (2021)

Një reflektim dygjuhësh mbi diplomacinë kulturore dhe rolin e “soft power”-it në marrëdhëniet ndërkombëtare, i ndërtuar mbi përvojën personale dhe institucionale të autorit.

8. Sir Noel Malcolm’s Albanianada / Shqiptariada

Një publikim *sui generis* kushtuar historianit britanik Sir Noel Malcolm, që përmbledh dhe analizon tri nga veprat e tij madhore: *Kosovo: A Short History*, *Agents of Empire* dhe *Rebels, Believers, Survivors*, duke theksuar rëndësinë e tyre për historiografinë shqiptare.



MAL BERISHA: Do t'i thosha vetes sime 20-vjeçare ato gjëra që realisht dhe ja kam thënë: Mos u tremb nga errësira; mposhte atë me dritë! Lufto për t'i fituar betejat e jetës, por mos përdor çdo mjet për të fituar. Mos u gëzo para kohe; si fitorja, ashtu edhe humbja e sprovonë karakterin e njeriut. Jepi gjithmonë përparësi njeriut. Ki mëshirë. Vendose trimërinë përpara frikës.

Dhe, mbi të gjitha, mbaje besën ndaj vetes dhe shpirtin të pastër, larg mëkatit, edhe kur sheh se bota rreth teje po ndotet. Sepse një ditë, kur të kthesh kokën pas, drita që ke ruajtur brenda vetes do të jetë fitorja më e madhe që ke arritur.

HEJZA: Ka një moment në fund të ditës kur njeriu mbetet vetëm me heshtjen. Kur mbeten vetëm me heshtjen tuaj, cilat janë tri gjërat që ndieni se ia kanë dhënë kuptimin më të mirë jetës suaj?

MAL BERISHA: Në heshtjen time, aty ku njeriu nuk ka më nevojë të justifikohet, të shpjegojë apo të provojë asgjë, kuptimi i jetës më vjen gjithmonë nga tri gjëra themelore:

Së pari, sa kam bërë për njerëzit që kam dashur dhe që më kanë dashur, për familjen, miqtë dhe ata njerëz që më kanë qëndruar pranë, si në ditë të mira, ashtu edhe në ato të vështira.

Së dyti, si i kam shërbyer vendit tim: nëse çdo përpjekje, sado e vogël apo e madhe, i ka bërë nder atdheut dhe nëse i kam qëndruar besnik idealeve të mia.

Së treti, ajo që kam shkruar dhe kam dokumentuar, si fjala e thënë me ndershmëri sot, a mund të bëhet motiv i mbarë për dikë nesër, edhe kur unë të mos jem më.

Në fund, njeriu nuk jeton vetëm për veten e vet, por edhe për gjurmën e heshtur që lë te të tjerët në rrugën e tyre. Dua që fëmijët, nipat, mbesat dhe brezat që vijnë të jenë kokëllartë për atë që unë kam bërë në jetë!

PERDJA

MAL BERISHA: Kur bie perdeja, mbetet vetëm e vërteta e brendshme e njeriut, pa tituj, pa poste,

pa protokoll. Në atë çast, unë e di se çfarë dua të mbetet nga unë:

Ajo që kam dashur fort, pa kursim;

Ajo që kam punuar me ndërgjegje për vendin tim;

Ajo që kam shkruar për të mos u harruar ata që ishin lënë në harresë ose të ndaluar me qëllim nga politikat e ditës, në mënyrë që të mos njiheshin nga brezat e mëpastajmë.

Perdja në jetë nuk është fundi. Është thjesht një ndalesë, përpara se drita të ndizet në një botë tjetër.

HEJZA: Nëse do të duhej të linim për të nesërmen vetëm një fjali nga Mal Berisha, një fjali që mund ta mbajë një brez i tërë si një busull të vogël shpirtërore, cila do të ishte ajo?

MAL BERISHA: *"BËHU I DOBISHËM PËR VENDIN TËND, SEPSE KËSHTU DO JESH I DOBISHËM EDHE PËR FAMILJEN DHE PËR SHOQËRINË."*

Veprimtaria përkthyesë e Mal Berishës nuk qëndron në periferi të veprës së tij autoriale, por e plotëson dhe e thellon atë. Titujt e përzgjedhur për përkthim dëshmojnë një vetëdije të qartë kulturore dhe historike: sjelljen në gjuhën shqipe të veprave themelore që kanë ndikuar perceptimin ndërkombëtar mbi Shqipërinë, shqiptarët dhe figurat e tyre historike. Në këtë kuptim, përkthimi shndërrohet në një akt të dyfishtë: filologjik dhe diplomatik! Ky angazhim i z. Berishës rikthen në qarkullim kombëtar tekste referenciale të mendimit perëndimor mbi botën shqiptare.

Mal Berisha ka përkthyer në shqip këta tituj

1. Southern Albania or Northern Epirus in European and International Affairs, 1912-1923

(Shqipëria e Jugut ose Epiri i Veriut në çështjet evropiane dhe ndërkombëtare, 1912-1923)

Vepër e Edith Pierpont Stickney, që trajton një nga çështjet më të ndjeshme të diplomacisë ballkanike dhe ndërkombëtare në fillimshkullin XX.

2. Rescue in Albania

(Shpëtimi në Shqipëri)

Vepër e Harvey Sarnier, kushtuar shpëtimit të hebrenjve në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, një dëshmi e rëndësishme historike dhe morale për kulturën e mikpritjes shqiptare.


3. The Rise of Iskander

(Naltësimi i Iskanderit)

Vepër artistike dhe historike e Benjamin Disraeli, kushtuar Heroit Kombëtar Shqiptar Gjergj Kastrioti-Skënderbeut, si një tekst i rrallë i romantizmit politik evropian mbi figurën e Skënderbeut.

4. The Mountains of Giants / Malet e Gjigantëve (2024)

Vepër e antropologut amerikan Carleton S. Coon, studim klasik mbi gegët e maleve veriore të Shqipërisë. Libri u botua fillimisht në anglisht më 1950, si pjesë e serisë shkencore të Peabody Museum of Archaeology and Ethnology të Universitetit Harvard, dhe u bë i disponueshëm në gjuhën shqipe për herë të parë pas më shumë se shtatë dekadash, falë përkthimit të Mal Berishës.



ISMAIL KADARE

(POEZIA)

Vepra letrare e I. Kadaresë e ka kompleksin e një kryevepre të madhe, të gjerë dhe të gjithanshme që kemi

Nehas SOPAJ

I lindur në Gjirokastrë më 1936, moshatar me R. Qosjen, A. Demaçin, T. Laçon e ndonjë tjetër, i ngritur letrarisht dhe intelektualisht në kush-tet e një komunizmi ortodoks, i shkolluar në Tiranë e Moskë, i ndërtuar me një edukatë qytetari botëror, që rrënjët i ka në Ballkanin e paparashikueshëm, në reliefin e tij të “egër”, I. Kadareja është një ndër shkrimtarët që me biografinë e tij nuk dallon dukshëm nga shkrimtarët e tjerë bashkëkohorë shqiptarë. Shkollimin fillor e të mesëm i nxë në Gjirokastrë, kurse studimet për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe i kryen në Tiranë. Ngjashëm si edhe shumica e shkrimtarëve të tjerë shqiptarë, një kohë ndjek studimet në **Institutin për Letërsi “Gorki”** në Moskë dhe me t’u kthyer, punon nëpër redaksi të ndryshme letrare, prej të cilave e dre-

jton revistën letrare *Les Lettres Albanaises*. Gjersa jetoi në atdhe, ishte shkrimtar i lirë. E veçanta e biografisë së tij është **azili i tij**. Shpërngulja e tij në Francë bëri bujë të madhe në atdhe dhe jashtë. Ky ishte rasti që të dalë në sipërfaqe një polarizim pro dhe kundër tij, diçka që ua rrotulloi mendjet kuluareve më të larta pushtetare dhe intelektuale, që ndodhi në prag të **përmbysjes** së komunizmit si rend shoqëror dhe politik në Shqipëri, në vitin 1990.

Veprat letrare të autorit janë: **Frymëzimet djaloshare, 1954; Ëndërrimet, 1957; Shekulli im, 1961; Përse mendohen këto male, 1964; Vjersha dhe poema të zgjedhura, 1966; Motive me diell, 1968; Poezia shqipe, 1976; Koha, 1979; Princesha Argjiro – 2003; Ca pika shiu ranë mbi qelq, 2004; Pa formë është qielli, 2005; Vepra poetike në një**

vëllim, 2018; Buzëqeshje mbi Botë, 1980, *poezi*; Gjenerali i ushtrisë së vdekur, 1963; Qyteti i jugut, 1967; Dasma, 1968; Kështjella, 1970; Kronikë në gur, Tirana, 1971; Dimri i vetmisë së madhe, 1973; Nëntori i një kryeqyteti, 1975; Emblema e dikurshme, 1977; Dimri i madh, 1977; Ura me tri harqe, 1978; Prilli i thyer, 1978; Gjakftohtësia, 1980; Kush e solli Doruntinën, 1980; Dosja, 1980; Sjellësi i fatkeqësisë, 1980; Viti i mbrapshtë, 1980; Krushqit janë të ngrirë, 1980; Nënpunësi i pallatit të ëndrrave, 1981; Prilli i thyer, 1980; Koncert në fund të dimrit, 1988; Ëndërr mashtuese, 1991; Përbindëshi, 1991; Pësia e kryqit, 1991; Nata me hënë, 1992; Piramida, 1992; Shkaba, 1996; Spiritus, 1996; Kushëriri i engjëjve, 1997; Lulet e ftohta të Marsit, 2000; Hija, 2001; Qyteti pa reklama, 2001; Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut, 2002; Vajza e Agamemnonit, 2003; Pasardhësi, 2004; Çështje të marrëzisë – 2005; Darka e Gabuar, 2008; , 2009; Aksidenti, 2010; Kukulla, 2015; Vajza e Agamemnonit, 2000; Breznitë e Hankonatëve, 2000; *tregime, novela, romane. Autobiografi e popullit në vargje*, 1971; Linja të largëta, 1973; Eskili, ky humbës i madh, 1990; Ftesë në studio, 1990; Koha e shkrimeve; Migjeni ose uragani i ndërprerë, 1990; Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe, 1991; Dialog me Alain Bosquet, 1996; Kohë barbare (Nga Shqipëria në Kosovë) – 2000; Elegji për Kosovën, 2000; Bisedë përmes hekurash – 2000; Ra ky mort e u pamë, 2000, Poshtërimi në Ballkan, 2004; Identiteti evropian i shqiptarëve, 2006; Dantja i pashmangshëm, 2006; Hamlet, le prince impossible, 2007; Don Kishoti në Ballkan, 2009; Mosmarrëveshja, mbi raportet e Shqipërisë me vetveten, 2010; Mbi krimin në Ballkan; Letërkëmbim i zymtë, 2011; *kritikë, ese, letra, udhëpërshkrime, intervista etj.*

Vepra letrare e I. Kadaresë është shumë e gjerë dhe ajo shtrihet në lloje dhe zhanre të ndryshme letrare, poezi dhe prozë si dhe shkrime të ndryshme diskursive. Si rrallë edhe ndonjë shkrimtar bashkëkohor shqiptar, kaptinë më vete janë intervistat dhënë gazetave dhe mediave të tjera elektronike brenda dhe jashtë shtetit, që do të përbënin disa blene, që mund të jenë sa të karakterit letrar, po kaq edhe shoqëror, publicistik, politik etj. Ndër llojet e ndryshme letrare që i krijoi autori, vend kryesor zë proza, kurse nga tri llojet e prozës që i kultivoi ai, siç janë tregimi, novela dhe romani, vend të parë dhe kryesor e zë romani, llojet dhe zhanret e ndryshme të atyre romaneve me të cilat paraqesin një letërsi më vete.

Romani i I. Kadaresë është ndër ato krijime letrare që, në përgjithësi, në historinë e letërsisë shqipe është ndër trajtesat më të mëdha dhe më të rëndësishmet që prijnë si kryevlera e artit shqiptar. Nuk është e tepërt të thuhet se romani i I. Kadaresë është ndër ato zbulime çfarë janë, për shembull, romani latinoamerikan në letërsinë botërore. Nuk është e tepërt të thuhet kështu, kur marrim parasysh faktin se ai, romani i tij pra, është reprezentuesi më i mirë që kemi si vlerë kombëtare para botës, në të vërtetë është letërnjoftim i identitetit shqiptar. Kështu, si i tillë, ai lirisht mund të matet me shumë vepra të rëndësishme në letërsinë botërore sot.

Vepra letrare e I. Kadaresë e ka kompleksin e një kryevepre të madhe, të gjerë dhe të gjithanshme që kemi. Ajo, në tërësi, ndahet në poezi dhe prozë. Shkrimet eseistike dhe diskursive, pastaj intervistat e ndryshme të dhëna ndër vite, si në kohë të komunizmit, ashtu edhe në kohë të sotme, dëshmojnë sa për gjerësinë, po kaq edhe për kompleksitetin e veprës së tij. Pastaj shkrimet e ndryshme, siç janë qasjet, kritikrat dhe studimet për veprën letrare të I. Kadaresë, nga studiues të ndryshëm, të vendit e të huaj, janë të shumta, kurse bibliografia e tij në internet është ndër më të mëdhatë ndër shqiptarët dhe kjo flet se ai, si rrallë ndonjë krijues tjetër, po përjeton sot vlerësimin me meritë. Një epitaf standard i shqiptuar shumë herët që është përsëritur nga të huajt me vite e që del nga emri i tij, *ambasadori i letrave shqipe*, mbase e arsye-ton letërnjoftimin e tij të vërtetë, që për shumë kohë s'do të hiqet nga mendjet e njerëzve. Një kualifikim të ngjashëm, në kohën midis dy luftërave botërore, shqiptarët me mburrje e mbajnë mend për Gj. Fishtën si *apostull i shqiptarizmit*. Ndërkaq kjo e I. Kadaresë, ma merr mendja do të zgjasë shumë më gjatë. Gjithçka te vepra letrare e I. Kadaresë është me peshë të vëçantë dhe ajo me vite po i thyen barrierat e të gjitha gjuhëve më të kulturuar në botë si vlerë e pakontestueshme. Ajo po bën jetën e vetë si shqiptarë në mendjen e miliona lexuesve në botë dhe kjo në na profilizon si komb i vëçantë në Evropë, si popull shumë i lashtë, siç jemi. Laureat i shumë çmimeve më prestigjioze në botë, edhe pse realisht akoma nuk e ka marrë më të lartin, I. Kadareja prej vitesh sikur e ka në dorë çmimin Nobel.

Ismail Kadare i ka botuar këto përmbledhje poetike: **Frymëzime djaloshare, 1954; Ëndërrimet, 1957; Shekulli im, 1961; Përse mendohen këto male, 1964; Motive me diell, 1968; Koha, 1976** etj. Karakteristikë e poezisë së tij janë temat dhe



motivet që përfaqësojnë janë identike me prozën e tij. Këto janë: historia, folklori, bashkëkohësia, angazhimi politik, intima personale etj. Këta janë qerthujt e parë kryesorë tematikë, ku mbështetet poezia e tij. Paraqitja e poezisë së I. Kadaresë në letrat shqipe është paraqitje e një talenti të veçantë. Në përmbledhjet e tij të para, siç janë **Frymëzimet djaloshare, Ëndërrime dhe Shekulli im**, spikat një botë e re letrare, që në kushte të një realizmi socialist, gjithnjë e më të sofistikuar, sa shkonte koha, depërtojnë zëra të një moderimi, që shkojnë kah tradita dhe sosin në eksperimente bashkëkohore botërore. Këtë, gjithsesi, do ta hetojë kritika e kohës, e cila asnjëherë s'do të jetë indolente ndaj veprës së tij. Andaj, me kohë, I. Kadareja, në sprovat e tij letrare, gjithnjë e më shumë e me seriozitet do ta parashtrojë një platformë letrare, ndërkaq kritika e kohës do ta kodifikojë atë si novatorizëm. Në përmbledhjet e mëvonshme poetike të asaj faze, kritika e kohës dhe studiuesit për veprën e tij do të flasin si për një

poet i cili edhe kur e lëron romanin, në fakt mbetet me vokacion të poetit.

E reja e poezisë së Kadaresë është orientimi tematik drejt "urbanizimit" të saj, diçka që ishte e kundërta e bukolikes dhe rustikales. Synimi drejt novatorizmit është çlirimi i poezisë nga tradicionalizmi. E reja e tij presupozon shkarkimin nga hipotekat e ngurtësisë shprehëse dhe kjo, sipas tij, duhet bërë duke përdorur një leksik të ri poetik, tjetërfare çfarë i presupozon koha aktuale. Andaj, poezia e I. Kadaresë cilësohet me një gjerësi tematike, me larmi ideore dhe, përgjithësisht, me tipa të ndryshëm të modelimit të poezisë. Për nga cilësimi i përgjithshëm poetologjik, poezia e tij do të ndahet në: 1. poezi programatike, 2. lirikë qytetare, 3. lirikë meditative, 4. lirikë baladeske dhe 5. poema.

Në një lexim kreativ të kësaj poezie, më e para gjë që i bie në sy lexuesit është ndarja e poezisë së tij në: 1. poezi të angazhuar shoqërore të realizmit socialist, 2. poezi të angazhuar që mbësht-



tetet mbi bazë të traditës kombëtare dhe 3. poezi të angazhuara intime ose thjesht poezi të shpirtit.

Përderisa me nocionin poezi të angazhuar do t'i përfshinin poezitë dhe poemat me tematikë shoqërore, me substrat politik ose poezi që sjell dita dhe çasti, me nocionin poezi, pa epitetin "të angazhuara", është poezia që mbështetet mbi traditën shqiptare. Kjo është poezia që përbën përpjekje për të dalë nga kallëpi socrealist i kohës dhe mbështetet në faktografinë historike, mitike e folklorike shqiptare, të cilën ai e thith në gurrat e memories popullore, në ato krijime poetike të autorit, që shtysë për trajtim marrin në visaret dhe në polifoninë e këngëve popullore. Ndërkaq, shumë prej poezive peizazhiste dhe poezi që lidhen me botën jashtë unit të autorit mbështetjen e gjejnë në orientimin e poetit kah krijimi i poezisë meditative, reflektive dhe, përgjithësisht, të intonuar me nota intime. Që këtu, në të tri këto formate të ndryshme të poezisë lexuesi heton një prerje të madhe të poezisë së tij në: 1. poezi me tematikë jashtë Unit dhe në 2. poezi personale ose poezi të brendshme intime, që lidhen drejtpërdrejt

me Unin e poetit. Dallimet e këtyre dy tipave të poezisë lexuesi mund t'i dallojë lehtë, para së gjithash për nga aspekti i ligjërimit poetik ose thënies poetike, në të cilën më qartë hetohet intonimi i zërit paradesk me ritëm buçitës, gati luftarak, për dallim nga e dyta, si më e padukshme, në të cilën hetohet zëri i dhembjes, i mallit dhe i intimitës së butë, ku dominojnë ndjenjat e holla individuale. Le t'i shohim më poshtë vetëm disa nocione, terma dhe formulime të kësaj natyre në poemën **Shekulli XX**. Këto janë: *mermeri, celuloza, atomi, frymëmarrje reaktive, elektronet, radari, aeroportet, uraniumi, bajonetat, fabrikat, antenat e televizorëve, shpërthimi atomik, raketat, vinçat, traktori, rripat e makinave, radiostacionet, pastaj nocionet tjera, të po asaj familjeje: shekujt, punëtori i thjeshtë, luftërat botërore, revolucionet, negrit, pasaporta, postbllloqet, bota e dy kampeve të ndara, komunizmi, qeveritë, kryeministrat, traktatet, nota, tensioni* etj. Sikundër shohim nga fara e natyrës, këto nocione dhe terma i takojnë tipit të parë të poezisë.

Në moshë fare të re, autori e botoi librin e parë poetik me titull **Frymëzime djaloshare**. Në të janë

përmbledhur një mori krijimesh poetike, të cilat lënë t'i njohësh rrugët e para prej nga krijuesi e thith lëndën artistike dhe ky është folklori shqiptar, ndërsa pastaj vijnë shkrimtarët shqiptarë dhe të huaj që janë mësuesit e parë të letërsisë së tij. Dy përmbledhjet që do të pasojnë pas librit të parë, *Ëndërrime* dhe **Shekulli im**, të botuara në distancë me nga tre vjet ndërmjet, përbëjnë shtegun e hapjes gjithnjë e më të sigurt të krijuesit tonë, i cili para vetes dhe lexuesit proklamonte një platformë të re letrare, që do ta mbështesë, para së gjithash, ardhmërinë dhe të cilën ai e sheh në socializëm, në barazi sociale dhe kombëtare, në konturat e ndërtimit të rendit shoqëroro-politik komunist dhe, përgjithësisht, në letërsinë pa barrikadat e tradicionalizmit.

Duke mësuar nga shprehja e vargut të lirë të Migjenit (nga letërsia shqiptare), duke mësuar natyrën e "rrëfimit" lirik të Jeseninit, duke mësuar sidomos nga leksiku poetik me ngjyrë të rendit të ri shoqëroro-politik nga Majakovski, si dhe duke mësuar nga natyra dhe ritmi i poezisë së P. Elyarit, pra duke mësuar nga letërsia e kohës që atij i ofrohet ta njohë, në penën e I. Kadaresë shohim talentin e krijuesit i cili, në krijimet e veta poetike, para së gjithash, shpreh frymën aktuale personale. Në librin **Shekulli im** identifikohet synimi i autorit për një poezi me vargje të lira, me një ritëm krejt të thyer dhe përgjithësisht me një botë të re poetike, në të cilën edhe kur i këndohet popullit, si edhe kur i këndohet intimës personale, duhen gjetur forma të reja poetike të panjohura më parë. Mbi bazë të këtyre parametrave do të krijohet poezia e mëvonshme e autorit.


Poezia e I. Kadaresë i ka përbërësit e gjuhës poetike, e cila, sikundër e kanë vërejtur kritikët e kohës, lidhet drejtpërdrejtë me poezinë e Majakovskit, me lirikun e njohur rus, që, siç dihet, për kohën kur krijohet lidhet me të ashtuquajturin novatorizëm. Kjo gjuhë poetike, stilistikisht në mënyrë analoge, mund t'i ruajë atributet e futurizmit rus, me një dallim se ajo në poezinë e autorit tonë identifikohet me përdorim më të dendur të termave teknike e teknologjike, me nocionet që vijnë si zëvendësim i florës dhe i faunës, karakteristike për modernistët. Kjo gjuhë është e sferës politike dhe përbën një shtytës të brendshëm që, kryesisht, mbështetet në jetën urbane dhe në rrethanat e reja të ndërtimit të socializmit.

Ky novatorizëm që bëhet model në poezinë e sotme shqiptare të formatit socrealist, megjithatë do të mbetet i vetmuar dhe tani, me rënien e komunizmit, si duket do të harrohet. Megjithatë,

ky orientim, që për kohën do të bëjë bujë të madhe dhe në lirikën e I. Kadaresë do të rezultojë me një "teknicizim" të poezisë (një poezi e I. Kadaresë e asaj kohe quhet Teknika dhe poezia). Në të vërtetë, vargu erdhi në kohë të teknikës, poezia u prish (shihni te libri **Motive me diell**) dhe tani tingëllon si parodi. Vërshimi i terminologjisë teknike dhe i zbulimeve shkencore në poezinë e I. Kadaresë do të dominojnë në të gjitha krijimet e tij letrare. Lexuesi i kujdesshëm, ndërkaq, do të hetojë se leksiku i këtyre më shumë do t'u shkojë për shtati atyre krijimeve në të cilat poeti i trajton temat e aktualitetit. Ndërkaq, nga ato tema më së tepërmi janë ato që lidhen me zhvillimin shoqëror të kohës, zhvillimin social dhe, në përgjithësi, me zhvillimin teknologjik të epokës socialiste. Që këtu, këtë leksik dukshëm më shumë e gjejmë të përdorur nëpër poema sesa nëpër vjersha.

Në opusin poetik të I. Kadaresë shquhen vjershat dhe poemat si krijime të veçanta. Gjersa vjershat e tij shquhen me vokacionin e tyre thjesht lirik, në poema hetohet një rrëfim i hapur, i shqiptuar me zë të lartë, gati paradesk, në të cilat poeti nxjerr një zë si isot popullore, një zë kolektiv, një sintezë të të gjitha kohërave brenda një ligjërimi unik poetik. Vjershat e tij, ngjashëm si edhe poemat, para së gjithash shquhen me një llojllojshmëri tematike, që kryesisht del nga metagjëllimi shqiptar. Vjersha e tij programatike me titull *Poezia*, si dhe shumë poezi të tjera, krahas natyrës dhe botës, para së gjithash presupozon nismën e një individualiteti të veçantë letrar, me të cilin sos një traditë e vjetër dhe nis një epokë e re. Duke e hiporbelizuar rolin e poezisë në vjershën *Sfidë*, poeti thotë: *Poet është ai që me dorën e fortë / ashtu siç këput një trëndafil në lëndinë / mund të zbërthejë pranë trëndafilin / edhe një minë.*

Poezia e I. Kadaresë është e shumënduarshme. Janë shndërruar gati në zhargon popullor shumë poezi të tij, siç janë *Ali Pashë Tepelena*, *E shkruar më 31 dhjetor*, *Plakat pijnë kafe*, *Baladë njizamësh*, *Mallë*, *Vallja shqiptare*, *Ikja e Mojsi Golemit*, *Poezia e teknika* e shumë të tjera. Popullorësia e poezisë së tij i kushtohet, para së gjithash, natyrës së tij shprehëse. Pothuajse nuk ka fjalë që nuk mund të poetizohet, sikur profetizon teoria e poezisë së tij. Ndryshe nga purolirika lasgushiane, e cila nisët nga një leksik i zgjedhur poetik, në poezinë e I. Kadaresë pothuajse çdo fjalë, sintagmë e frazë poetike mund ta marrë "shtimungun" e poetizimit, kështu që ky orientim drejt hapjes së të gjitha portave për lëndë poetike mundëson dhe lejon të depërtojë nocione të ndryshme, që i sjell aktualiteti, duke u nisur nga



zhargoni i përditshëm politikanesk e deri te neologjizmat teknike e teknologjike.

Karakteristikë e poezisë së autorit është larushia e formave të ndryshme të poetizimit, duke u nisur nga ato të cilat mund t'i konsiderojmë thjesht poezi të shkurtra e të vogla, gati miniatu-riale, e deri te ato të cilat reduktojnë një histori të tërë të rrëfyer. Në kuadër të trajtave dhe të formave të ndryshme poetike më të dukshme janë poezitë me rimë, po kaq sa edhe ato me vargje të lira. Ndër poezitë me rimë shquhet orientimi i autorit drejt të të ashtuquajturave poezi-këngë, në të cilat mënyrat e këndimit alternohen me mënyrat e këndimit folklorik, si në tekstin poetik të poetit; poezi-këngë me trajta të ndryshme, që prej atyre thjesht intimiste e deri te ato elegjiake, himnizuese ose edhe paradekse. Duke bërë fjalë për këtë tip të vjershave të I. Kadasës, autor do të shprehet se "edhe kur shkruan prozë, poezia është elementi i tij kryesor", që do të thotë se fryma dhe vokacioni i tij do t'i përcjellë të gjitha krijimet letrare, madje edhe romanet e tij. Një mori vjershash mund t'i grupojmë si krijime poetike që realizohen si poezi

figurative. Të këtilla mund t'i konsiderojmë shumicën e poezive, të cilat për lëndë të tyre poetike e kanë një rrëfim lirik të lidhur me një figurë të poetizuar. E kështu është vasha si figurë këndimi (të këtilla janë poezitë *Pritja, Një vajze, Vajza, Dashuria* etj.) Në poezinë e autorit dallohen figurat mitike (të këtilla janë poezitë: *Kali i Trojës, Kështjella, Troja, Lakuriqet e natës në Apolloni*), pastaj figurat simbolike (të këtilla janë poezitë: *Kali i Trojës, Embëtha, Përse mendohen këto male* etj.), por edhe figura të tjera të ndryshme.

Dy poemat, *Ëndërr industriale* dhe *Shënime për brezin* tim, do të jenë krijime poetike në të cilat do të shfaqen me të madhe një mori nocionesh teknike në poezinë e tij. Në vazhdë të krijimtarisë, me botimin e librit me titull *Përse mendohen këto male*, gjithnjë me një entuziazëm dhe fuqi të madhe talenti, ani pse me shtysa dominonte të utopisë komuniste, e shohim krijuesin i cili merr për barrë t'i këndojë historisë kombëtare, temave të bashkëkohësisë, po kaq edhe aktualitetit, por gjithnjë me sy kah perspektiva. Një shprehje krejt tjetër, sidomos në planin e figurave origjinale të

gjetura (p.sh. malet shqiptare) në të cilën i këndohet qëndresës historike njerëzore të përvojatur siç janë shqiptarët, kënduar me një frymë të perspektivës komuniste, për kohën kur shkruan autori. Duke qenë një libër i përbërë me vjersha dhe poema, disa prej të cilave, madje, do të jenë kulmi i tij poetik (vjershat *Troja*, *Perëndimi*, *Të huaj jemi* etj. dhe, sidomos, poemat *Poema e blinduar*, *Buzëqeshje mbi botë*, *Përse mendohen këto male* etj.), libri do të bëjë jehonë dhe do ta ngrejë autorin duke e dalluar si krijues që veçohet dukshëm nga të tjerët.

Në *Poemë vjeshte* lexuesi më pak se një poemë do të lexojë një mori figurash që faktikisht ia shtojnë imazhin e peizazhit të vjeshtës, së cilës i ndajvishet një melankoli në një hapësirë të papërcaktuar dhe në një horizont që në perspektivë e ka pikëllimin. Ndryshe nga rrëfimet e drejtpërdrejta me substrat historik, si te poema *Përse mendohen këto male*, në këtë krijim poetik prej dhjetë këngësh mungon rrëfimi i mirëfilltë, mungon tabloja klasike e vjeshtës dhe aty, në fakt, përmes imazhit të vjeshtës së përfytyruar, fshehtë, autori në natyrën e pikëllimit të pashpjeguar sikur synont' i kërkojë fshehtësitë e artit. Vjeshta është vetë art i pikëllimit; pikëllimi është e fshehta që shumë bindshëm do të gdhendë sintagma lirike, të cilat poetit "i vijnë" natyrshëm dhe pa dhunë. Në të radhiten një varg metaforash dhe metonimish, si: 1. *ky ajër plot elektricitet*, 2. *koncerte të verdha fletash*, 3. *lokomotivat me gjoksin e zi*, 4. *minuta të kristalizuar /të gjitha të ngrira*, 5. *çarçafët e zhubrosura të reve të rebeluara*, 6. *vetëtimat, kujtimet e bukura të verës*, 7. *copa qielli e deti*, 8. *qielli meskin* etj. një varg shenjëzimesh-poetizike me motiv vjeshtën, që përbën mozaikun e pikëllimit ose vjeshtën si peizazh, që në shpirtin e njeriut e ngre imazhin e dhembjes njerëzore.

Poema **Përse mendohen këto male**, në të vërtetë, është një sintezë e të gjitha motiveve të njohura të poezisë së Kadaresë. Në këtë krijim prej 24 këngësh, autori zhvillon një dialog me kohërat shqiptare, që nga antikiteti e deri në ditët e sotme. Ky është një dialog me atdheun, duke marrë për simbol reliefin shqiptar dhe duke i personifikuar malet, pllajtat e detet me frymën e qëndresës shqiptare. Ky është dialog me vetë shqiptarin, duke i bërë sfidë qëndresës së tij nëpër kohë dhe duke e marrë pushkën si simbol i rezistencës së trysnive historike, që atij, në periudha të ndryshme, i kano-set për zhdukje të përhershme. Poema ndërtohet në dy forma të mëdha të gjuhës poetike: e para ka të bëjë me pasqyrimin e tablove lirike, që nëpër

këngë të ndryshme lexuesit i jepen si imazhe të fiziksit real objektiv të kohës dhe të hapësirës, kurse e dyta ka të bëjë me gjuhën e gjallë dialogë, që poeti i drejtohet një Ti-je, që shpesh identifikohet si relief shqiptar, si njeri shqiptar, si kohë e caktuar historike dhe, më shumë se kaq, identifikohet si atdhe, si Shqipëri.

Poema ndërtohet si rrëfim lirik nëpër këngë të ndryshme, që përshkohen me një frymë të dukshme të socializimit të njeriut me rendin e ri shoqëror, duke i shquar kategoritë e tilla si amorfe në pozicionimin e ri shoqëror (shihni minaret dhe kambanoret, priftërinjtë e hoxhallarët, pastaj poetët "të ulur në mobilie të prera" si përfaqësues të shtresës, supozojmë borgjeze nga e kaluara). Poema, pra, përgjithësisht, është odë Shqipërisë dhe ajo herë sinjifikohet si një personifikim i relievit të saj ose thjesht si Ajo dhe herë edhe si objekt me të cilin zhvillon dialog poeti. Si edhe në të gjitha poemat e tjera, edhe këtu poeti shfaq optimizëm për një ardhmëri, duke menduar se me transformimin final të atdheut njëherë e përgjithmonë është fituar beteja e shqiptarëve për mirëqenie dhe këndellje shoqërore. Sado që nga distanca ky optimizëm i poetit duket grotesk, as vlerësimet pro dhe as vlerësimet kundër nuk do të ndryshonin asgjë në sharmen e këtyre vargjeve.

Në rrugën e tij krijuese, I. Kadareja do t'i botojë edhe dy poema të tjera, **Shqiponja fluturojë lart** (1966) dhe **Vitet gjashtëdhjeta** (1969), në të cilat poeti e himnizon komunizmin, kurse shqiptarët i simbolizon si komunistë, pra diçka që për kohën e atëhershme kishte një domethënie të theksuar pozitive.

Proza romaneske e tij, duke qenë moderne në kuptimin e vërtetë të fjalës, madje edhe kur ka koekzistuar, ajo e ka thyer tabunë e realizmit socialist. Marrë në përgjithësi, nga tërësia e veprave letrare, romani është e arritura më e lartë e I. Kadaresë. Ajo, si në kohën e epokës komuniste, ashtu edhe në ditët tona, është shkruar njëlloj me tërë strukturën e vetë rrëfimore, mënyrën e shkrimit dhe idetë për çka shkruhen veprat letrare në përgjithësi. Duke i bishtnuar mjeshtërisht dogmën e ideologjizmit, ajo me tërthoret e saj në kohë të shtrëngesave ideologjike, ka krijuar simbolikën dhe alegorizimin e saj, duke mbetur e njëjtë si atëherë, ashtu edhe në ditët tona. Me ndonjë përjashtim të rrallë e të parëndësishëm (shih një pjesë e poezive dhe romanin **Dasma**), veprat letrare në prozë të I. Kadaresë i kanë ikur diktatit të shkollës së realizmit socialist, duke u bërë e kundërta e saj.

(Vijon në numrin e ardhshëm)


PARADOKSI HERETIK

(Për romanin **HEREZIA E DËRVISH MALLUTËS** të Teki Dërvishit)

Ibrahim RUGOVA

1. ME AUTORIN

Teki Dërvishi është njeri ndër shkrimtarët lanë të shquar bashkëkohorë, që vepron e krijon në fusha të ndryshme të krijimtarisë. Shkroi disa përmbledhje poezish e tregimesh, u sprovua edhe në tekstin e dramës dhe i botoi katër romane: Pirgu i lartë (1972), Padrona (1973), Skedarët (1974) dhe Herezia e Dërvish Mallutës, (1981). Meqenëse kësaj here kemi marrë për vështrim romanet e tij, po ndalemi pak më shumë në rrugën e zhvillimit në këtë plan, e kryesisht do të përqendrohemi te romani i fundit. Të katër romanet e autorit flasin se ai ka arritur një nivel të mirë dhe të vazhdueshëm të shkrimit romanësor, madje nivel të qëndrueshëm. Kështu Dërvishi hyn në radhën e atyre shkrimtarëve tanë bashkëkohës që i janë përkushtuar romanit. Që nga tregimet e para të këtij autori të botuara kryesisht në "Jeta e re" e deri te romani i fundit, mund t'i vërejmë disa elemente tejet të rëndësishme për prozën e tij. Gjithë ato përpjekje dhe rezultate në prozën e tij të mëparshme vijnë e formulohen te romani i parë Pirgu i lartë, ku ngritët dhe formohet një tip i prozës poetike, ku në formë të shquar vërehet funksioni i poezisë në roman dhe ndjenja e zhvilluar e njohjes së jetës. Këtë vazhdë të perceptimit, po me një thellim të meditacionit dhe të depërtimit psikologjik, e kemi edhe te romani Padrona, kurse romani Skedarët thuhetse largohet nga kjo rrugë. Me të marrë për temë burokracinë dhe sferën e botës mediokre, autori, në mënyrë të adaptueshme gjithë këtë na e jep përmes cilësimeve të ligjëratës, të gjuhës në të vërtetë. Është një ndër romanet e rralla humoristike në fushën e romanit tonë, pa tepri dhe pa vulgarizim të çështjes. Përmes ligjëratës së varfër të personazheve dhe po ashtu situatave e ideve të varfra, autori na jep një botë, në të vërtetë, c ngrit një botë njëherësh të varfër, botën burokratike që vegjeton në të përditshmen më se të rëndomtë. Herë - herë na duket se është një roman ironik për këtë problematikë, sepse nuk e postulon tepër



vetëm humorin, përmes talljes apo përqeshjes me qëllime injorimi e argëtimi.

Romani i fundit i Dërvishit, mendojmë se paraqet një përgjithësim të përvojës së tij në fushën e romanit, një thellim dhe zgjerim tematik e artistik, që autorin e vë në pozitë të romansierit të formuar, e që gjendet vazhdimisht në rrafshin krijues të shkrimit. Mbasi jemi te këto çështje të përgjithshme, është e mirë dhe e drejtë të thuhet se Dërvishi ka një aftësi tejet të domosdoshme për shkrimtarin, aftësinë e vrojtimit artistik. Përmes këtij objektivi autori na i jep edhe gjërat e fenomeneve më të thella, më interesante e produktive për

veprën artistike, që i ikin vrojtimit të rëndomtë. Po ashtu këtë fenomen, pra vrojtimin e tij, mund ta vështrojmë edhe në planin tjetër, në atë artistik, që përmes rivendosjes dhe zhvendosjes së ekzistueses, arrin të japë një vizion tjetër, mjaft adekuat dhe mjaft të bindshëm, të natyrshëm. Dhe ç'është e mira, ky vrojtım gjithnjë e më shumë thellohet e materializohet në veprën e tij.

2. ETIMOLOGJI

Vetë titulli i romanit, Herezia e Dërvish Mallutës, fare qartë dhe në formë konkrete na bën me dije se kemi të bëjmë me çështjen e herezisë dhe të heretizmit. Prandaj, mu për këtë ndiejmë një obligim të merremi pak me planin historik, apo gjenetik, apo të etimologjisë së termit thënë me gjuhën e filologjisë. Po nisemi nga burimi: herezia është një doktrinë (teori), që u shfaq në gjiun e kishës katolike, që ka të bëjë me gjykimin e asaj që korrupton (prish) dogmat. Më tutje, doktrinë kundër ortodoksisë në gjiun e një religjioni, ide, teori, praktikë që i kundërshton mendimet e konsideruara si të sakta, të drejta e të arsyeshme. Vështuar historikisht, kuptimin e këtij termi që u bë fenomen në fusha të ndryshme të veprimit shoqëror, shpirtëror e intelektual të njeriut dhe të grupeve shoqërore, na dalin disa herezi qendrore: adamizmi, airianizmi, kalvinizmi, jansenizmi, luterizmi, manikeizmi, protestanitizmi, kietizmi, socianizmi etj. Kështu, me kohë, herezia ka marrë kuptimin e përjashtimit të pikëpamjeve dhe të gjesteve, që nuk përkojnë me një gjë të shpallur, me dogmën. Le të përkujtojmë Renesansën dhe dogmën e shpallur të kishës, që dominoi disa shekuj. Zhvillimi historik e ka demantuar herezinë, po ajo gjithnjë është fryt i së tashmes, i atyre momenteve kur nuk merret parasysh perspektiva. Në raportin midis deklamatorit të herezisë dhe të heretizuarit (heretikut), na shfaqet hereziarku, autori i një herezie, shefi i një sekte heretike. Kështu në skenën historike bëjnë jetën e vet hereziarkët dhe heretikët në planin opozicional (kundërshtues), të cilin fenomen e zgjidh dhe e afirmon koha. Dhe kështu prej kësaj etimologjie terminologjike po dalim te etimologjia letrare, në të vërtetë romaneske.

3. MJETI DHE QËLLIMI

Këtë etimologji të herezisë në planin filozofik e ideologjik e dhamë me qëllim të vështimit të kuptimit të saj. Kështu, me përgjithësime të

ndryshme do të mund të bëhej fjalë për herezinë teologjike, sociale, filozofike, artistike, nacionale, profesionale e të tjera, të cilat në praktikën e realitetit paraqiten si kundërshti apo kundërthënie. Në romanin e Dërvishit kjo çështje realizohet në fushën e artit, të rrjedhës së proceseve jetësore e intelektuale të një mesi. Në këtë roman kemi të bëjmë me fenomenin e herezisë, të cilin autori e nxjerr nga empiria e një grupi social, që jeton në bazë të asaj teorie. Në të vërtetë këtu e kemi kontaktin me atë grup, kur përcillet ideja e herezisë. Prandaj sektën e dervishëve, mund të themi lirisht, autori e përdor vetëm si mjet për të nxjerrë qëllimin. E qëllim i tij është të tregohet, të vërtetohet paradoksi i herezisë, që vjen e kthehet në paradoks heretik, e që njëherësh del edhe si paradoks jetësor. Me këtë nxjerrim konstatimin se në qendër të herezisë dhe të heretizmit qëndron paradoksi, kundërthënia, kundërshtia me shkakun dhe pasojën e vet.

Këtë shpjegim ndoshta tepër të formuluar e të fortë e dhamë me arsye që të veçojmë lëndën e romanit dhe implikacionet që dalin prej saj, në të vërtetë implikacionet artistike. Kështu, intelektual i ri apo dërvishi i ri, duke ikur nga tjetërsimi personal dhe tjetërsimi jetësor, kërkon një riambientim të personit dhe të personalitetit të vet: vendoset në Teqenë e Sukës së Cërmjanit dhe vendos që me inkuadrimin e vet në atë sektë, apo grup social të gjejë veten. Nga tjetërsimi ai shkon në mesin që e ka zënë e shpall herezia si mes heretik, prandaj është mes i eksoduar. Mirëpo edhe në atë mes ekziston shkalla tjetër e herezisë, brendaherezia, e cila vepron në bazë të sistemit të kierarkisë (Dërvish Malluta) dhe heretikët e heretizuar. Në kuadër të doktrinės heretike, realizohet edhe heretizmi personal, nënshtrimi dhe vetë nënshtrimi, që është formë e vetëtjetërsimit dhe e mbitjetërsimit. Personazhi që bën udhëtimin e vet nëpër grupin e heretikëve e që vjen nga vetëtjetërsimi, kthehet përsëri në mesin e mëparshëm, i cili më në fund arrin të thyjë herezinë prindore, çfarë na sugjeron fjalë përmbyllëse e romanit: "Megjithëkëtë ligjë atnore, e ndjeve dënesjen time". Si duket me këtë përfundim autori na jep atë paradoksin e parë se fenomeni i heretizmit zë fill në gjiun e familjes, midis prindit e fëmijës, ku vetëdija e aftësisë e thyen atë të herezisë së jetës, të ligjeve të ekzistimit. Si duket, kthehemi përsëri në dilemën e fillimit, kthehemi në zanafillë, që prej aty zhvillohet një proces ciklor i ekzistencës individuale, apo më afër i asaj personale. Me shtjellimin dhe formësimin e vet romani, në kontu-

rat e tij vendoset në bazën e paradoksit. Kërkesa e intelektualit të ri për nënshtrimin e vetes, është kërkesë për të pushtuar jetën, po ky akt, që është akt i njohjes dhe i vetënjohjes, duhet të zhvillohet në një pikë të lartë, që autori na e jep figurativisht me masë reale, në Sukën e Cërmjanit, në majën e ngritur sikur na sugjeron se për të nënshtruar veten është problemi më i madh.

4. ASKEZA-SPASTRIMI, DOGMA

Kështu, për t'u realizuar akti i nënshtrimit, autori përmes një rrafshi topografik real dhe kuptimor na jep paradoksin e spastrimit që duhet të zhvillohet në dy pika kundërshtuese. Dihet se akti i nënshtrimit është një akt përunjtesie, i cili simbas logjikës së zakonshme duhet të realizohet diku poshtë, ashtu simbas kuptimit të tij, po këtu në roman ngjet e kundërta: ky akt zhvillohet në një vend të ngritur në Sukën e Cërmjanit. Aty, përmes situatave sprovuese të fizikës dhe të metafizikës njerëzore të kryepersonazhit, akti i nënshtrimit, në të vërtetë i spastrimit, realizohet nëpër procedurën e organizuar të askezës aktive konkrete: të vetëmundjes, të vetëpushtimit dhe të vetëpërballimit të kushteve dhe të instrumenteve që parashihi me atë doktrinë të sektës. Në mënyrë fare të vrazhdë dhe reale realizohet spastrimi, sepse, së pari, për të pranuar idenë e imponuar apo të vetëkërkuar, që gjithnjë vjen si e imponuar, duhet pranuar aktin. Për t'u bërë kjo, duhet të shpallet dhe të kryhet herezia mbi vetveten, që është një ide dhe akt i fuqisë së brendshme të njeriut. E simbas kësaj filozofie apo ideologjie, spastrimi shpirtëror gjithsesi zhvillohet përmes shuarjes fizike të trupit, atij organizimi që e mban dhe realizon shpirtin. Ja kjo është ajo kundërvënia e përhershme midis trupit e shpirtit, midis mendjes e ndjenjës. midis reales e ireales. Siç na del në roman, ky është akti i shpalljes së herezisë nga hereziarku Dërvish Malluta, i cili me rreptësinë të madhe i zbaton të gjitha rregullat për spastrimin e shpirtit përmes trupit. Mendojmë se në këtë kapitull të romanit kemi punktin konkret të ekzistimit të ri të qenies, që bartet nga kryepersonazhi. Këtu spastrimi na del në dy plane, në atë të brendshëm, ku është fjala për vetë personazhin dhe në planin e jashtëm, që përsëri lidhet me personazhin, i cili kërkon drejtpeshimin e vetes në jetë, kërkon harmoninë e brendshme dhe atë të jashtme, po që e lë të hapur, sepse nuk e arrin dot. Dhe po bëmë pyetjen se kush është kryepersonazhi, dërvishi, intelektual i ri, i cili nuk ka arritur të spastrohet



përmes situatave reale jetësore e intelektuale, po që tash do të bëjë këtë përmes spastrimit asketik, që është njëfarë mohimi, vetëmohimi, mund të themi se ai është një karakter i intelektualit-krijues, që kërkon realizimin e vet edhe përmes akteve më të vështira, krijues i pathyeshëm. i cili në plan të parë e ka veprën, atë fuqi që mban në vete dhe që e sprovon nëpër jetë. Dhe ky është ai individ, që gjithnjë e kërkon identitetin e vet përmes një causa sui (shkakut, arsyes së ekzistimit të vetes) në planin real, në atë metafizik dhe në planin e realizimit të brendshëm. Kështu, në raportet e vendosura nga ai (me botën dhe me vetveten) mund të gjejmë raporte të tjera që lidhen me çiftet opozicionale: intelektual-i-sharlatani, mendimi krijues-dogma, dogma - antidogma, autoriteti-antiautoriteti, totalitariteti-liria individuale e të tjera raporte, të cilat me këtë rast autori, në të vërtetë, kryepersonazhi, na i jep përmes njohjes dhe mospajtimit me idolatrinë, ku në rend të parë vihet ideali, që e ka dhe kërkon ta realizojë intelektual i vërtetë, intelektual autonom. Për të vër-

tetuar këtë qëndrim dhe botëkuptim ndaj dogmës së imponuar, të cilës nuk i beson as ai që e pranon (Dërvish Malluta), del fakti tjetër se ai e zbaton me qëllim të ruajtjes dhe të mbajtjes së vetes apo të vetë dogmës. Siç e pamë kryepersonazhi e kërkon këtë në rrafshin real, në atë doktrinar të sektës religjioze dhe në rrafshin historik, të gjenetikës së depërtimit dhe të aprovimit të saj: "Hipokrizia e sociologëve intuitivë të Perandorisë, këtu e pesëqind vjet më parë, me gjeturi inventive kishte reviduar sa nga syret më të rëndësishme të Librit të Shenjtë, duke e predikuar aty pamundësinë e përsëritjes dhe të imitimit të punëve të Perëndisë, duke dashur kështu ta nënvlerësojë dhe ta zhdukë fuqinë e amshueshme të artit dhe të historisë, duke dashur kështu të fshijë prej faqes së botës kulturën e vjetër, që në vend të saj të vë themelet e një anarshie religjioze sharlatane e dogmatike. Themelet e asnjë religjioni, më në fund, nuk mund të vihen pa ndihmën e dogmës dhe të hipokrizisë". Kështu dërvishi i ri, intelektual i ri që është i formuar në bazë të faktografisë, të filozofisë dhe të të historisë, insiston në njohjen autentike dhe në vetëdijen e aprovimit, që shkojnë kundër rrjedhës së dogmës dhe aktit të mendimit e të krijimit, sepse duke u realizuar përmes dogmës, ai konstaton se janë shuar shpirta të mëdhenj që kanë mundur të jenë në vijën e burimores, siç është Hamidi i Verdhë, personazh i rëndësishëm në këtë roman, që vazhdimisht i ka qëndruar afër kryeheretikut, Dërvish Mallutës, i cili nuk e mendon, po e zbaton dogmën: i cili është shpallur si heretik, po e zbaton, e aplikon një herezi, krijon heretikë të tij. Vërtet një paradoks i bukur, të cilin në roman e kemi pa ndonjë imponim, as nga autori, as nga rendi i vendosjes së gjërave brenda prosedeut, por del vetvetiu nga ai rend i vendosur artistik.

5. INVENCIONI

E nxorëm në plan të parë kryepersonazhin e këtij romani, dërvshin e ri, që është përfaqësues i tipit të intelektualit të formuar, me qëllim që të theksojmë vetëdijesimin e tij nëpër situata të ndryshme të jetës e të dogmës, në të vërtetë, të një filozofie dhe ideologjie, e cila autorit i shërben vetëm si objekt për të provokuar realizimin e veprës së vet, romanit. Autori, me të drejtë, me mjaft aftësi artistike, përmes prosedeut modern të romanit, të vendosjes së sistemit të elementeve e të ideve, arrin, madje të mos e ekspozojë "dorën" e vet, po edhe atë të kryepersonazhit. Kështu kryepersonazhi është vetëm një "udhëtar", që provo-

kon zbërthimin e një ideologjie të tërë, e për të cilën nuk flet vetë, por na lë të vendosim vetë. Po ashtu këtij fakti i vjen në të mirë edhe konstatimi se në këtë roman narracioni zhvillohet në formë koncentrike dhe shpesh me elemente të simultanitetit (njëkohësisë), që do të thotë rendi i vendosur i gjërave vazhdimisht zgjerohet e thellohet dhe kështu zënia e elementeve shpirtërore e intelektuale të personazheve pasurohet vazhdimisht. Këtë mjet të poetikës së shkrimit e gjejmë edhe më parë në prozën e Teki Dërvishit, sidomos te romani Pirgu i lartë, por në këtë roman e zhvillon më shumë dhe nuk e ndërpret me fragmentaritet, po e hap më shumë brenda formave të njësive narrative. Ky simultanitet i paraqitjes romaneske, na bën të pohojmë se ky roman është roman mbi vetëdijen, siç e vërejtë një kritik (R. Musliu), po do të shtonim se është roman i vetëdijesimit, që na del në roman në plan të dytë, pra i vetëdijesimit të kryepersonazhit. Këtë konstatim do ta bartnim edhe te poetika e autorit, se është edhe një vetëdijesim artistik i tij, në të vërtetë një aftësim i tij individual me rëndësi edhe për korpusin tonë romanesk. Duhet të shtojmë se ky roman është i pasur edhe me mjaft tema të tjera interesante, që meritojnë zhvillime të posaçme analitike e kritike, po kësaj here kishim për qëllim të flasim për një temë bazë të tij, për paradoksin heretik, në të cilin, simbas mendimit tonë qëndron vlera më e madhe e tij dhe që e bën të jetë roman mjaft autonom në vlerë dhe në realizimin në kuadër të romanit tonë bashkëkohor. Mendojmë se me romanin Herezia e Dërvish Mallutës, autori ka arritur standardin e shkrimit të romanit, po mbetet që në të ardhmen, ta mbajë këtë dhe, natyrisht me bindjen tonë të plotë, do ta zgjerojë këtë, të krijojë dhe të formojë standarde të reja. E për të mbajtur këtë nivel, duhet t'i largohet fragmentaritetit. që në romanet e tij të mëparshme, e ndonjëherë edhe këtu, e dobëson tërësinë dhe intensitetin narrativ, mbi të cilin qëndron romani modern e bashkëkohor. Madje, ky roman është i pasur me planin figurativ dhe asociativ, ku, pa kurrfarë ngurrimi jepet realiteti i përditshëm. i ndërlidhur përmes njësive narrative me fiksionin artistik, apo siç e thotë autori, është njëfarë metafore konkrete, që në vetë përmban edhe "metaforën" e domethënies universale të tematikës së realizuar. Marrë në përgjithësi, po e përfundojmë me konstatimin se romani Herezia e Dërvish Mallutës, është romani më i mirë i autorit dhe një ndër romanet më të rëndësishme të botuar brenda viteve të fundit në letërsinë tonë.

(18 shtator, 1982)


DRAMA E LUFTËS DHE DRAMA POETIKE

Ismail Syla, **ËNDËRR NË ZARF** (poezi), 2025

Prof. Dr. Bajram KOSUMI

Njëzetvjetëshi i fundit i shekullit XX ka qenë koha më dramatike e Kosovës dhe e shqiptarëve. Kulmoi në tërheqjen më të skajshme të lakores së jetës, në dy pikat e kundërta: liria e Kosovës dhe krimi deri në gjenocid kundër shqiptarëve. Ndryshe nga jeta, kjo dramë ende nuk ka lindur kryevepra në letërsi dhe në art. Ka vepra që e shtjellojnë dramën, është motiv dytësor në shumë të tjera, shumë poezi u shkruan për lirinë e Kosovës, për dramën dhe për heronjtë një e nga një, por ende nuk ka një a më shumë kryevepra. Këtë ngathtësi krijuese disa e shpjegojnë me traumën e luftës: në një dramë tmerr, pjesëmarrësit dhe shikuesit, e të tillë kemi qenë të gjithë, traumatizohen dhe nuk sillen normalisht. Edhe shkrimtarët janë traumatizuar. Mbase, është e domosdoshme një largësi kohore, e cila ia hapë sytë vetëdijes dhe të nënvetëdijes, e cila e sjell mallin, e sjell përjetimin e vërtetë të dramës së tmerrit, për t'u jetësuar në art.

Ka një fjalë tjetër në shqip që mund ta shpjegojë këtë traumë, fjala *shitë*, *shitoj*, *shitova*, *i shituar*, e cila buron nga mitologjia shqiptare, me kuptimin ndëshkim, mallkim, magjepsje nga zanat, i cili shfaqet me ngurtësim trupor (shndërrimi i njeriut në gur), ngurtësim të pjesshëm (njeriu nuk mund të lëvizë), marrje e gojës dhe marrje e mendjes. Në kuptimin figurativ, fjala ka kuptimin edhe i plagosur nga plumbi (jo i vrarë!) dhe, ky është një rast i rrallë në të cilin kuptimi i dytë, figurativ, e sqaron edhe më shumë dhe e kthjellon kuptimin e parë: *i shituar* është njeriu i plagosur rëndë në shpirt, në mendje e në trup. Fjala *e shituar* nga lufta e Kosovës i shkon shumë mirë letërsisë shqipe, për shkak të mos prodhimit të një a disa kryevepra arti për dramën e madhe. A është ky pohim krejtësisht i besueshëm, nuk e di. Ndoshta ka një përgjigje më të shkurtër: mungon një krijues i madh?



A ËSHTË POEZIA E ISMAIL SYLËS NJË PIKË KTHESE NË TEMËN E DRAMËS SË KRIMIT?

A është poezia e fundit e Ismail Sylës, në librin *Ëndërr në zarf* (2025), një pikë kthese e letërsisë sonë ndaj kësaj drame? A është kjo poezi një monument poetik, një vepër e lartë për dramën e madhe të Kosovës, për tmerrin që krijoi dhe la prapa makineria serbe e luftës? Diskutimi im i mëtejme do të përqendrohet në gjetjen e

përgjigjeve në këtë pyetje. Në këtë poezi Ismaili nuk rrëfen, nuk përshkruan, nuk shfaq emocionet, por rikrijon ose evokon imazhe, situata, objekte, njerëz dhe natyrë, të cilat në tërësinë e tyre dhe veç e veç zbulojnë pulsën e krimit njerëzor. Ai nuk përdor ligjërim thirrës e as vlerësues, nuk përdor ligjërim emocional e as mallkues për ta shfaqur natyrën e krimit, përkundrazi, përdor simbolet të cilat shfaqin më thelbësisht dhe më përjetësisht shpërhytyrimin apokaliptik të natyrës njerëzore. Në aspektin ligjërues ai e arrin këtë në pesë fjalë, pesë ide poetike apo pesë parime poetike: **emërtime, procese, njerëz, objekte dhe natyra**. Secili prej këtyre fjalëve ka degëzime të ndërlikuar, ka fjalë kyçe të cilat bartin motive e ide të shumta poetike. Një mënyrë e mrekullueshme për ta kuptuar këtë poezi është diskutimi për këto pesë fjalë.

EMËRTIME- SIMBOLE

Emërtimet në këtë poezi shprehin dhe emërtojnë njerëz, objekte dhe vende. Duke qenë kryesisht emra, ata shndërrohen në simbole. Po përmend disa: *bunar, varr prej uji, thasë me rroba, kocka që nuk u çua në laborator, blloku me rrëfime, inicialet në rrip, shënimet në shall, kova, dëshmitari i fundit, harta pa shenjë bunari, zarfi pa adresë, çorapja e vetme, gjurmë në mur, thika në tavolinë, biçikleta e kuqe, libri në komodinë, dhoma pa dritare, xhami që nuk lahet, pjata që nuk përdoret, lugët e nxira, tava e pjekur, bibla e plakut, kamishi i të zotit të shtëpisë, zilja e shkollës, çanta e shkollës, telefoni, kutia e këpucëve, kutia e shahut* etj.

Secili prej këtyre emërtimeve është një simbol. Secili ka peshën e vet të veçantë. Secili është më vete. Secila prej këtyre fjalëve në secilën poezi është një vepër poetike, si e thotë Borges (Borges, *Raporti i Brodit*). Ai ka gjetur fjalët e bymehura të cilat, një nga një, qoftë edhe një e vetme, e rikrijon dramën e madhe të tmerrit. Prandaj poezitë e tij në këtë vëllim janë të shkurtra dhe me një strukturë të thjeshtë të tipit *dikur dhe sot*, sepse mjeshtëria poetike është drejtpeshuar te roli i një fjale të vetme e jo te strukturat ligjërimore. Ai e di që, si poet i mirë, ku ka shumë, del pak! Çka shfaqin këto emërtime - simbole në përmasën semantike?

Këto janë objektet dhe vendet ku ndodhi drama e krimit, emërtojnë krimin dhe përmasat e tij, emërtojnë dëshmitë e krimit dhe në fund emërtojnë dëshmitë e kujtesës. Krye emërtimi dhe krye-simboli i këtij areali është **bunari**, vendi ku ndodhi një prej dramave më të tmerrshme gjatë luftës

së Kosovës, në shumë anë të Kosovës, kur forcat serbe hidhnin në bunarë civilë shqiptarë, burra e gra, pleq e të rinj, fëmijë e nëna, të vrarë e shpesh edhe të gjallë. Rreth simbolit të bunarit baresin dhjetëra simbole të tjera, të cilët e rikonstruktijnë aktin barabar të mbytjes, të dëshmimit dhe të kujtesës. Bunari është një varr i zgjedhur, apostafat, për të dërguar mesazhin e shumëfishuar të tmerrit:

Lumi ishte afër,
por nuk i hodhën atje.
Zgjedhën bunarin.
(Zgjedhja e varrit)

Bunari është burimi i jetës. Mbytja e njerëzve në të është mesazh i mbytjes së jetës në gjenezë, në burim. Njëkohësisht, bunari është dëshmitari i krimit, ai e ruan brenda vetes krimin, për ta zbuluar në kohën e duhur. Simboli i bunarit, bashkë me simbole të arealit të vet, si: **uji i bunarit, kova, gurët e bunarit, guri i munguar, uji i bunarit tjetër** etj., e rritin intensitetin e ligjërimit poetik dhe të krimit e tmerrit të ndodhur. Këto simbole shfaqin imazhin e shpërhytyrimit apokaliptik të natyrës njerëzore. Si, për shembull, simboli i **kovës**, brenda arealit të bunarit, e cila:

E para i pa trupat që binin
një nga një.
Pa lutje.
Pa britmë.
(Kova - histori në katër akte)

dhe e fundit që largohet nga vendi i krimit:

dhe u kthye gojëhapur
pa asgjë.
(Kova e fundit)

Edhe kova, një hekur i ftoftë e pa ndjenja, kthehet gojëhapur nga tmerrri që pa. Simboli tjetër, **frika e vrasësve**, e shpërfaq përmasën e madhe të tmerrit: ata nuk u lutën as nuk bërtitën, por vetë vrasësit frikësohen nga zërat (*Frika e vrasësve*). Te poezia *Dëshmitari i fundit* paraqitet veprimi i fundit i të mbyturve:

Kam parë një nënë me dy fëmijë.
E fundit që bëri
Ishte t'i përqaftonte fort.

Secili krijim letrar në këtë libër e ka një identitet të vetin, një lloj veçantie, e cila e bënë të duket më ndryshe nga krijimet tjera. Janë së paku tri elemente të cilat i japin vullë identitetit të kësaj vepre letrare: topika, tmerrri dhe, normalisht, pas tmerrit, trauma. Topika është vendi – Kosova (më saktë emblema e saj, Drenica), tmerrri është lufta – respektivisht masakra dhe e treta është trauma. Poezia e Ismail Syles në përgjithësi, ka gjetje të hatashme të cilat aq sa të mahnitin me forcën shprehëse, po aq edhe të tronditin me tragjedinë që e mbështjellë. Secila poezi është një epitaf i veçantë poetik, është një gdhendje mbi gurët e varreve. Është kujtesë, që nuk duhet ta fshijë kurrë rrjedha e historisë.

Lulzim Tafa

Në këtë vepër poetike, Sylja nuk shkruan – ai dëshmon. “Ëndërr në zarf” është më shumë se poezi: është arkivi shpirtëror i humbjeve njerëzore, një refuzim estetik par excellence për t’u pajtuar me harresën. Një ftesë për të kujtuar – jo vetëm me mendje, por edhe me zemër. Ky nuk është vetëm libër për t’u lexuar – është frymë me kronika dhimbjesh që edhe pasi t’i kesh lexuar, jetojnë me, dhe në ty.

Isuf Sherifi



ISMAIL SYLA

ËNDËRR NË ZARF

ISMAIL SYLA

ËNDËRR
NË ZARF

Edhe në atë çast shtazërimi, kur vdes çdo qelizë njerëzore në trupin e vrasësit, nëna- viktimë, e ruan ndjenjën njerëzore, dashurinë e thellë për fëmijët, e sheh fundin, por i përqafton fort, për t’ua bërë fëmijëve vdekjen më të lehtë, për të vdekur në përqaftimin amnorë, i cili e zbutë edhe vetë krimin, tmerrin dhe vdekjen. Vendi i krimit shndërrohet në një pikë të veçantë në tokë, që nuk u nënshtrohet ligjeve të natyrës e as të njeriut, sepse aty u çart natyra e njeriut, aty njeriu, vrasësi, përdhosi çdo natyrë, çdo ligj e çdo kod njerëzor. Rreth vendit të krimit natyra nuk sillet e nuk shfaqet sikur në çdo kënd tjetër të botës:

Nata s’është e qetë pranë bunarit.

Qentë nuk afrohen.

Edhe zogjtë fluturojnë më lartë.

(Vetëm hëna di çka sheh)

Edhe njerëzit sillen e shfaqen ndryshe pranë bunarit, sikur në këngën e bukur të Gjergj Elez Alisë:

Dikur aty këndonin.

Tani, kur kalojnë, ulin kokën.

Kënga ka mbetur në ujë,
e shurdhët.

(Shurdhimi i këngës)

Këtë gjendje të mbretërisë së dhunës vrastare, të cilës i shkon përshtati edhe toponimi **‘vendi më i vetmuar’** (Zogu dhe vetmia), e paraqet mjaft mirë edhe simboli i **‘gurit’**, te poezia *Gur i hedhur në pafundësi*, kur dikush e hedh një gur në bunar, por nuk e dëgjon rënien e tij në fund, *Sepse disa gjëra s’kanë fund.* Ky është një varg antologjik për tmerrin e krimit, sepse nuk ka fjalë, nuk ka përmasë, nuk ka imazh as nuk ka mendje që mund ta kapërthejë atë të keqe të madhe, prandaj i vetmi shpjegim i mundshëm është pranimi i moskuptimit të tij, sepse disa gjëra nuk do të kuptohen e nuk do të shpjegohen kurrë. Është një gjetje e jashtëzakonshme ky varg, sa filozofik aq dhe poetik:

Dikush hodhi një gur

për të parë sa zgjat.

Por nuk dëgjoji fund.

Sepse disa gjëra s’kanë fund.

i cili paraqet më fort se çdo pasthirrmë, çdo klithmë e çdo fjalë dhimbjeje, vetë tmerrin që nuk mund të shpjegohet, as të kuptohet e as të interpretohet. Sado ne mendojmë se e kuptojmë luftën, e kuptojmë tmerrin që përjeton një njeri të cilin e mbysin, vargu na thotë që kurrë nuk do ta kupto-

jmë sa duhet. Po kaq gjetje e mirë është simboli i **gurit që mungon**, te poezia *Një gur që mungon*, në të cilën vetë guri është në vend të viktimës, guri është i viktimizuar, dhe një djalë që numëron gurët që hedh në bunar, vëren që mungon një gur: ai gur është vetë ai, ai tashmë vet është një gur brenda bunarit dhe nuk po e numëron veten, sepse ani pse ka shpëtuar gjallë, ai është si i vdekur sepse është peng i vdekjes së njerëzve më të afërt të tij, pa të cilët jeta e tij nuk ka kuptim. Kjo mbretëri tmerri, ku nuk mund të thuhet fjalët **ujë, gëzim, këngë** (*Fjalë që më nuk thuhet*), nuk hesitet, nuk mbyllet e nuk shuhet. Edhe po të duan ta fshehin, edhe po të pajtohen njerëzit që të harrohet, natyra nuk do ta durojë këtë anashkalim, sepse krimi ka prishur edhe ligjet e kodet e vetë atomeve të planetit, prandaj „hëna e di çfarë sheh poshtë“ (*Vetëm hëna e di çka sheh*) dhe uji vetë do të dalë mbi betonin e gurët e hedhur mbi bunar për të dëshmuar mizorinë (*Betonim i dështuar*). Bunari tashmë është një skenë krimi anti-njeri dhe anti-naturë, sa që as natyra nuk e duron fshehjen e tij. Një radhë tjetër e simboleve rreth bunarit ka të bëjë me zbulimin e krimit e të tmerrit, si për shembull, **incipialet në një rrip**, të mbetur si shenj nga krimi, një **shall i mbetur**, një **lodër në fund të pusit** (viktimat janë edhe fëmijë që luajnë me lodra), një **bllok shënimesh** etj. Zbulimi i krimit është një pothuajse rastësi, ose një shfaqje e natyrës për mendjet e hallakatura njerëzore, një vënie përpara të provës për të bërë esëll mendjen tonë. Një tjetër radhë simbolesh, njëkohësisht një imazh tjetër tronditës në këto poezi, shfaqin mënyrën se si njerëzit e përjetojnë këtë humbje njerëzore. Poezia më e skajshme këtu është *Frika e gruas në ëndërr*.

Një grua pa një ëndërr.

Bunari ishte bosh.

Dhe ajo qau,

jo nga gëzimi,

por nga frika se nuk do t'i gjente më.

Aq e madhe është zbrazëtia që lanë pas të mbyturit, aq e ankthshme është jeta pas krimit, sa që gruaja që ëndërron qanë nga frika se mund të ndodhë edhe një krim tjetër, në vazhdimësi: fshehja e krimit dhe harrimi i tij. Tri simbolet e fundit të arealit të bunarit që do të përmend janë **pika e referencës**, **harta** dhe **muzeu**. Janë të kundërta në kuptim. I pari paraqet kujtesën kolektive për gjëmën e madhe. Detajet mund të harrohen, po kurrë nuk do të harrohet vendi ku i kanë hedhur ata.

Bunari është kthyer

në pikë orientimi.

Thonë:

“Kthehu djathtas,

aty ku i hodhën njerëzit.”

(*Shenjë orientuese*)

Vargu „Ata janë më thellë se harresa“ (*Më thellë se harresa*) e parathotë mos harrimin. Edhe në disa poezi të tjera shfaqet në forma të ndryshme ky mos harrim, tash ndryshe nga poezia popullore për Gjergj Elez Alinë, në të cilën, pas një viti varri i heroit prishet, bliri thahet, e në vend të zogut – qyqja vajton. Por, te dy poezi tjera, te *Harta pa shenjë bunari* dhe në aktin e katër të poezisë *Kova – histori në katër akte*, shfaqet motivi i harresës. Çuditërisht, në të dy rastet, harresa nuk është popullore, por zyrtare, e që simbolizon aparatin shtetëror, institucionin. Hartat janë produkte të institucioneve, njësoj sikur edhe muzetë, e në të dy rastet ngrit krye harresa: te harta si mos shenjim i vendit më të vetmuar në botë, bunarit, ndërsa te muzeu ka një falsifikim të historisë së kovës, e cila rri aty si një eksponat i kohës së kaluar, por që me asgjë nuk tregon e askush nuk e pyet se çka ka parë e çka ka përjetuar deri sa ishte në bunar, sa krimet e mizoritë i pa, mbeti gojëhapur e kurrë nuk i tha. Ky proces i emërtimit semantik e gjuhësor – poetik në poezinë e këtij libri krijon një ligjërim të lartë simbolik. Simbolet nuk janë gur zbukurues, por mishi dhe gjaku i ligjëritimit. Flasin simbolet. Këto simbole nuk janë tradicionale, janë personale, autoriale dhe janë një prej majave të kësaj poezie: është një ligjërim poetik i ndërtuar mbi simbole origjinale. Duke qenë personale dhe origjinale, këto simbole e pasurojnë shumë ligjërimin poetik shqip, duke rritur fjalorin e fjalëve që luajnë rolin e simboleve.

PROCESE - FOLJE- METAFORA DHE METONIMI

Foljet shprehin atë që ndodhë, procesin. Ato, bashkë me pjesët tjera ndihmëse të ligjëratës, bëhen metafora ose metonimi, si për shembull: zgjedhja e varrit, blloku që thith rrëfime, kamera që nuk kap ngjyrën e vdekjes, një gur që mungon, nëna kërkoi tokë për ta mbuluar, bunari nuk pranon harresën, kujt t'ia them këtë emër, më nuk më njeh ai, nëna nuk i pa etj. Ngjashëm me simbolet, ligjërimi i kësaj poezie ndërtohet përmes metaforave dhe metonimive dhe të formave strukturore të afërta me këto dyja. Duke qenë edhe

këto origjinale e personale, dekonstruktimi i tyre mund të jetë vetëm personal, pra jo tradicional, e kjo d.m.th. se këto metafora duhet gjurmuar për herë të parë dhe janë një pasuri e re për poezinë shqipe. Te poezia *Kur nuk thirret emri* paraqitet ndjesia tepër e hollë e vuajtjes për mungesën e djalit e të vajzës së mbytur. Atij dhe asaj nuk ia thërrasin emrin nga frika se mos copëtohet emri:

Se
një emër kur heshtë është zog
që nuk guxon të këndojë më.

Një emër që nuk guxon të thirret më, për shkak të frikës se do t'i plasë zemrat e të gjallëve, prandaj heshtë si një zog që nuk guxon të këndojë! Metafora më e lartë në këtë libër e cila e shprehë ankthin a kujtesës, të atyre që mbetën gjallë dhe jetojnë me dashurinë e të mbyturve dhe me tmerrin e vdekjes së tyre, të cilët nuk i harrojnë kurrë por zemra u djeg për ta, si thuhet në vargjet:

Sot, kujt t'ia them këtë emër
që më përvëlton gjuhën,
e s'e kam guxim ta heq nga goja?
(*Kujt t'ia them këtë emër*)

është metafora që e **ndërlidh këtë vuajtje e ankth me frymën e mbajtur në mushkëri:**
Është si të mbash frymën për shumë vite,

nga frika se po e lëshove,
humbet ai...
(*Dhoma që nuk lëshon frymën*)

Kjo është një situatë poetike të cilën e quaj të pamundshme në jetën objektive, por tërësisht funksionale në poezi, pra të mbash frymën për vite është si të vdesësh, po aq, ta lëshosh frymën është njësoj sikur ta humbësh të dashurin e mbytur. Këto situata të pamundshme paraqesin modele të përkryera të ligjërimit dhe të idesë poetike. Po kaq të bukura janë edhe metonimitë, të cilat zakonisht i përshtaten narracionit, po këtu, edhe pse Ismail Sylja nuk rrëfen por emërton, metonimia funksionalizohet perfekt. Në poezinë *Më nuk më njeh ai*, i gjalli, nëna a babai, ruajnë një fotografi të birit të mbytur. Ai dhe ajo nuk e pranojnë humbjen, nuk pajtohen, qoftë duke jetuar edhe me fotografinë e birit të tyre. Por, realiteti është më i vrazhdë dhe e copëton çdo përjetim: me kalimin e viteve shfaqet një dallim midis fotografisë dhe atij që jeton me të:

Unë u mplaqa.
Ai jo.
E, tani më sheh si njeri të huaj.
Më nuk po më njeh as në ëndërr.
Humbja është e përjetshme.

Në poezinë e këtij libri, metafora dhe metonimia vijnë pas simbolit. Kjo do të thotë, poeti nuk ka zgjedhur të tregojë, të dëshmojë e të rrëfejë, por ka zgjedhur të emërtojë dhe duke emërtuar të rikrijojë mbretërinë e tmerrit të ndodhur. Ai nuk pasqyron në poezi atë që ka ndodhur, por e rikrijon. E rikrijon në atë format dhe në atë formë që të qëndrojë për shekuj.

VRASËS, TË VRARË DHE PENGJE TË VDEKJES

Njerëzit në këtë poezi, si emra, vijnë pas simboleve e metaforave. Poeti ka dashur ta vërë theksin te objektet dhe rekuizitat e krimin, te natyra ku ndodh krimi, te gjërat që ndodhin, ndërsa njeriu është në sfond, thjeshtë është **ai** dhe **ajo**. Mund të jetë fëmijë, shpirt fëmije në bark të nënës, mund të jetë nënë, baba, vëlla, motër, mik, shok, kushdo, secili njeri. Ai dhe ajo janë secili prej nesh. Ndahen në tri tërësi të mëdha: të vrarë, pengje të vdekjes dhe vrasës. Përshkrimin më të bukur dhe monumental të njerëzve të vrarë e bën poeti në një pjesë të poezisë *Duart që bien erë dhé*:

Donjetën,
që emrin e kishte poezi:
e bukur,
e re,
e pafajshme...
e vrarë.

Në poezinë e këtij vëllimi vihet në dukje tmerrin i krimin, një tmerr i lëmerishëm, dhe jo vetë njeriu, ai që e përjeton tmerrin, i mbyturi dhe i gjalli, edhe pse poezia është shkruar pikërisht për ta, por këtu mesazhi i poetit përqendrohet te përmasa çnjerëzore e krimin. Më e papranueshme se vuajtja e njerëzve, të mbytur e të gjallë, është përmasa e krimin, e *pakapshme për mendjen* e shëndoshë. Vetëm në ciklin e fundit të poezive, *Duart që bien erë dhé*, poeti u vë poezive, në vend të titullit, emra njerëzish, emrat e anëtarëve të familjes Deliu nga Abria e Epërme, vrarë e mbytur nga forcat serbe, mbetur gjallë vetëm Imer Deliu, për të jetuar tmerrin e vrasjeve çdo ditë e çdo çast, për pjesën e zezë të jetës së mbetur. Me këtë emër-

tim të poezive me emra njerëzish, poeti e thekson peshën e rëndë të vuajtjes për ata që mbetën gjallë, vihet në spikamë koha e mbetur e Imer Deliu, e cila nuk ka emër tjetër përveç vuajtje dhe kërkim pa qëllim. Të parët e kanë mbyllur ciklin e tyre jetësor, fatkeqësisht në një dramë të tmerrshme, por edhe të dytët, të gjallët jetojnë të gjitha format e dhunës, të dëshpërimit, të vuajtjes, të mallit, të pengut. Ata kujtojnë, nuk harrojnë, kërkojnë të gjejnë të mbyturit, i zbulojnë, kërkojnë gjësendet e tyre, ruajnë nëpër shtëpi ato që u kanë mbetur, fotografi, libra, fletore, orë dore, kuti shahu, kuti këpucësh, biçikletë, top loje, shall, shami... çfarëdo qoftë një objekt, i cili fetishizohet dhe shndërrohet në medium komunikimi me të mbyturin, ose shndërrohet në masë matëse të largimit kohor nga drama e krimit. Ndonjëherë ata ngritin krye, nuk e pranojnë realitetin, e mohojnë, bëhen sikur nuk ka ndodhur asgjë, shtiren sikur ata do të kthehen, sikur te poezia *Shtirje*, në të cilën gjithë jeta e tij varet nga mospranimi me zë, pra ai gjen edhe një fije të hollë kashte në detin e tërbuar:

Gjithë jeta ime lutet
Të mos e pranoj me zë.

Ndërsa në poezinë *Gjyshi i heshtur* të gjallët metamorfozohen, nga një prind që pyet fëmijën ku ishe, ku shkove, çfarë bëre, në një roje guri:

Nuk ka më kush t'i përgjigjet.
Tash rri në verandë,
me sy nga porta,
si rojtar i një dere
që nuk hapet më për askënd.

Një poezi rezyme për këtë grupin e dytë të njerëzve, të mbetur gjallë e për gazep, shfaqet te poezia fusnotë në fund të kapitullit *Duart që bien erë dhé*, një nga më të mirat e krejt librit (prandaj nuk e kuptoj pse është në fusnotë). Në strofën e parë tregohet masa e dhembjes së Imer Deliu që varrosë familjarët e masakruar - për çdo të varrosur, një zemër e tij e varrosur:

Imer Deliu, me duart e tij
varrosi dhjetë copa zemre
edhe po aq trupa të tjerë...

Dhembja e tij është planetare, ndërsa në gji ka një shpellë, brenda së cilës është një humnerë, ndërsa që natën e krimit këmisha e dhimbjes, e padukshme, në trup i rri. Ai së pari varros një

zemër të tij, pastaj një trup të familjarit. Jo e kundërta. Përsëri një zemër të tij dhe një trup tjetër familjar..., dhjetë herë e varros zemrën e vet dhe një fëmijë, nënën, gruan... Imer Deliu merr për vete një status tjetër njerëzor dhe nuk mund të jetë në një radhë me njerëzit e zakonshëm:

Duart e tij të lara me lot dhe me gjak
me aromë pune e me erë djerse deri dje
Nuk ka ujë që i shpërlandë...
Kanë prekur shumë dhé.

Imer Deliu mbeti i gjallë, por i shituar prej krimit e vdekjes dhe s'mund të qëndrojë më në radhë me të gjallët. Grupi i tretë i njerëzve janë vrasësit, të cilët nuk janë në skenë, por janë të pranishëm në çdo varg, në çdo fjalë dhe në çdo rrokje. Edhe kur ata përjashtohen nga skena historike, janë të pranishme shenjat e tyre të krimit: i vrari, i mbytur, i mbijetuari, dëshmitari, të gjallët e mbetur pengje të vdekjes, si dhe rekuizitat e krimit. Një karficë e gjetur në hi e rindërton gjithë skenën e krimit, një top fëmijësh mbetur në fushë rikthen imazhin e krimit, apo si në poezinë *Gjurmë në mur*, në të cilën askush nuk e fshinë një gjurmë në murin e shtëpisë, mbetur nga ai, të cilën

Nëna e prekë ndonjëherë me gisht,
si të kërkon puls në atë mur.

Metonimia më e dhimbshme dhe më e tmerrshme është te poezia *Shoku i humbur*, në të cilën dy shokët e një fotografie ndahen dhunshëm dhe njëri ekzekutohet. Tjetri mbetet gjallë e për gazep dhe poezia përfundon me vargjet:

Tani njëri mban tjetrin në xhep
Si kujtim,
Si vëlla,
Si vetvete.

OBJEKTE

Objektet në këtë poezi fetishizohen dhe kanë rol parësor. Një *bunar*, një *kovë*, një *gur*, një *libër*..., nuk janë si bunarët, si kovat, si gurët a si librat e tjerë, sepse ato janë artefakte të një drame të madhe krimi, ato janë mediumi midis të gjallëve e të vdekurve, ato ruajnë kujtimet për më të dashurit e vrarë e të mbytur me çnjerëzi. Me këto objekte poeti rikrijon botën e krimit të ndodhur dhe krijon alfabetin e kujtesës. Poezia shkru-



het për një objekt. Disa nga poezitë kanë në tituj emrat e këtyre objekteve, si: blloku, rripi, shalli, letra, lodra, zarfi, çorapja, gjurma, thika, biçikleta, libri, pjata, syzat, ngjyrat, topi, lugët, ora etj. Këto objekte jetojnë dy jetë: të parën, kur ishin me ata, të mbyturit, pronë e tyre, objekte të zakonshme dhe, jetën e dytë, të mëvonshmen, kur ata nuk janë më, këto objekte ruhen si të shenjta, bëjnë një jetë të fetishizuar dhe shërbejnë si medium midis të gjallëve e të vdekurve. Përmes këtyre objekteve poeti ka krijuar dramën e krimit, por edhe dramën psikologjike, të cilat janë rrjedhojë e kujtesës, si te poezia *Dritarja e heshtur*.

Në atë shtëpi,
dritaret nuk janë më për t'u hapur.
Janë për të ruajtur brenda
atë që nuk guxon të dalë jashtë.
Dhembjen.

Është befasuese se si poeti ka arritur të krijojë drama të mëdha me objekte aq të zakonshme e të përditshme! Zakonisht, ai e përdor paradoksin për ta arritur efektin e dramës, si në vargjet e mësipërme, në të cilat dritarja shërben për të kundërtën e vet. Përdorimi i paradoksit nga Sylja, ngjashëm me simbolin dhe me metaforën e meto-

niminë, është shfaqje origjinale, pra nja paradoks që nuk e hasim në poezinë tjetër shqipe. I tillë është paradoksi te poezia *Nëna nuk i pa*, në tri vargjet e fundit:

Askush nuk ia mbylli sytë.
Sepse ajo nuk i kishte hapur
që kur filloi krisma.

Ajo i mbyllë sytë në çastin më të vështirë, kur ia marrin dhe ia vrasin para syve djalin, burrin, vëllain dhe një tjetër me fytyrë të panjohur, edhe pse ajo i sheh dhe i vuan të gjitha, sepse ajo sheh me zemër e jo me sy. Më befasuesi është paradoksi te poezia *Pjata që nuk ndotet asnjëherë*, në të cilën pluhuri që shprehë tradicionalisht harresën, aq sa vetë fjala *i pluhuros* ka tejkuptim të harresës, këtu ka kuptim të kundërt, të mbamendjes. Në raftin e një nëne ruhet pjata e pluhuros dhe e palarë e fëmijës së saj të mbytur:

Një ditë një mbesë tha:
"T'ia heq pluhurin..."
"Mos e prek!"
Bërtiti Nëna
me një zë si të një panjohuri...
Dhe tha:
"Atëherë, fillon harrimi..."

NATYRA

Natyrë është tepër aktive në këtë poezi. Ky status i natyrës i përngjan rolit të natyrës në *Eposin Kreshnik*, si në këngën *Ajkuna kjan Omerin*, kur gjithë natyra e kozmosi, hana, dielli, yjet, zogjtë, ahu..., të prekur nga vajtimi i nënës për djalin e vrarë, marrin anën e saj. Natyra është jo vetëm dëshmitarja e përjetshme e dramës së madhe të krimit çnjerëzor, por duke parë përmasat e pakufishme të çnjerëzimit, ajo merr anën e njerëzores. Aq i shpërfytyruar është krimi, sa që natyra e personifikuar nuk mund të jetë indiferente, ajo sheh, gjëmon dhe shënjon krimin, për t'ua dhënë njerëzve të tjerë kumtin. Natyra nuk luan as rolin e Zotit, i cili në shumë letërsi vështrohet dhe regjistrohet të keqen, për t'ua hakmarrë në botën tjetër. Në poezinë e Ismail Sylës edhe zoti dorëzohet përpara këtij krimi: „Mu duk se Zoti po kërkonte falje” dhe „si për Zotin që atë natë mungoi.” (*Duart që bien erë dhë*). Jo. Natyra këtu është e pafuqishme ta ndalë krimin, është e pafuqishme të hakmerret, por ajo merr shpirt për të parë e për të ruajtur kujtimin e krimit dhe për ta bartur te njerëzit në forma të ndryshme. Ky status i natyrës në poezi e ngre dramën e krimit në një akt antinatyre e

të çnatyruar, diçka që natyra njerëzore dhe ajo planetare e kozmike nuk mund ta durojnë. Hëna merr pjesë në këtë dëshmim, nata vëzhgon këtë krim, sepse krimi bëhet natën, toka rreth bunarit trishtohet, gurët e bunarit e kova çmeriten, bari lemeriset e nuk mbinë aty, zogu nuk pi ujë më aty (*Një zog nuk piu ujë*), manushaqet shndërrohen në sy për të parë e për të kujtuar (*Manushaqet si sy*), era fryn dhe pëshpëritë një emër të të vrarit (*Emri fryu si erë*), edhe gjethja zhytet thellë në varrin e ujit, si ata (*Gjethja e rënë në ujë*) etj. Në disa raste, se te poezia dramatike *Tek ai vend*, natyra bëhet bashkëvuajtëse e njerëzve të gjallë:

E dinë ku u ndal.
E dinë kush e mori.
Por jo ku e lanë.
Çdo vit, në të njëjtën ditë,
ata shkojnë në atë cep toke,
dhe flasin me erën.
Si të flasin me vetë atë.

Të gjallët çmallen me erën, sikur të flisnin me bijtë e bijat dhe me familjarët e tyre të mbytur, sepse era ishte dëshmitare e krimit, ajo e përjeton, e ruan dhe e kujton atë.

PËRMBYLLJE

Ligjërimi poetik i këtyre poezive nuk është emocional, si mund të pritet e si ka ndodhur në poezitë e tjera për një dramë tmerri. Poeti nuk synon dhimbjen emocionale. Poeti ka zgjedhur, e si poet i madh që është ka zgjedhur drejt, që fjalëve të zakonshme t'ua jap kuptime të pazakonshme, që vendeve të zakonshme t'ua krijojë imazhe të pazakonshme, ka zgjedhur jo të tregojë por të rikrijojë situatat e krimit çnjerëzor, që lexuesi ta shohë me sy e jo ta dëgjojë me veshë. Situatat e pazakonshme dhe procesi i pazakonshëm i vrasjes dhe i mbytjes së njerëzve të pafajshëm shfaqen si situata e veprime që nuk mund të durohen jo vetëm nga njeriu, por as nga natyra. Ato janë situata dhe veprime kundër natyrës njerëzore. Si lexues i përhershëm i poezive dhe i çdo teksti letrar të Ismail Sylës, besoj se ai ka krijuar një kryevepër poetike për dramën e madhe të krimit që ka ndodhur në Kosovë në luftën e fundit. Dhe, për t'iu përgjigjur shkurt pyetjes së vënë në fillim të kësaj eseje, po, drama e madhe e krimit në Kosovë tashmë e ka edhe një dramë të madhe poetike, e kjo është Ëndërr në zarf e Ismail Sylës.

Dhjetor 2025

SIMBOLIKA E GRUAS SHURDHMEMECE NË ROMANIN “AMERIKANI” TË ODISE KOTES


Kjo grua shurdhmemece që duket si një dritë e bardhë (si për çudi) mbart në paaftësinë e saj, në kufizimin e saj shqisor natyrën e vdekur që duhet të kishte njeriu në kohën e diktaturës komuniste

Anxhela PASHAJ

Autorët shqiptarë duket se e gjejnë tharmin e tyre letrar në të shkuarën e largët e të afërt të popullit shqiptar. Disa parapëlqejnë të largohen në Arbëri, të tjerë në kohën e errët otomane e shumë të tjerë në atë diktatoriale. Edhe pse në librat e historisë na janë kursyer nuanca të thella të së zezës diktatoriale shumë nga pararendësit tanë na kanë rrëfyer për mizorinë e kohës më të dhimbshme të shqiptarëve. Kohën kur ai nuk kishte frikë vetëm nga i huaji (ushqyer kjo prej politikës), por edhe nga vetja, sidomos prej vetes. E në kohë të tilla, në kohë kur vetja mund të bëhet shkaktare e mijëra dhimbjeve, më mirë është të mos jesh. Ose me qenë, pa qenë, pa u dukur. Rrekja e përditshme e autorëve shqiptarë për të na sjellë në veprat e tyre një pamje të jetës dhe dhunës së asaj kohe herë dështon e disa herë të tjera realizohet mjaft mirë duke iu qasur lexuesit bashkëkohor e duke lënë brenda tij keqardhjen dhe mirënjohjen e të jetuarit në kohë më të jetueshme.

Një qasje shënjuese të asaj kohe të padëshirueshme realizohet në romanin “Amerikani” të autorit Odise Kote, ku paraqitet një personazh, një grua që tërheq vëmendjen e lexuesit duke e bërë atë të pyesë veten se çfarë kërkon ajo aty, përse gjendet në faqet e këtij romani.

Ajo është gruaja e atij që e cilësojnë si “Amerikani”, e cila as flet as dëgjon, një shurdhmemece që gjallon në një realitet ku të gjithë janë të zënë në çark. E vetmja e gjallë. Personazhi i saj është nga



më të realizuarit në veprën e Kotes, ndoshta edhe më mirë se personazhi qendror, i cili përtej tërësisë dhe kulmit narrativ që mban është sikurse gjithë të tjerët një i vdekur që merr frymë. Burgimi, izolimi brenda një qyteti, përgjimi nga të gjithë sytë, ndalimi i muzikës së tij, internimi janë vuajtjet që

e sfilitin fizikisht, mendërisht dhe shpirtërisht në të gjithë romanin.


Amerikanit i propozojnë ose më mirë të themi i japin për bashkëshorte këtë grua shurdhmemece po ashtu të dënuar prej sistemit dhe natyrës me mendjen se një i përçmuar, i parë me sy të keq nga sistemi si ai aq meritonte; një tjetër të përçmuar, të përçudnuar me të cilën të kalonte një vetmi të përjetshme. Një ndëshkim mizor që çuditërisht tjetërsohet, pasi përmes vështirimeve (syve) ata të dy ia dalin të lidhin botët e tyre shpirtërore. Botë që vuajnë, njëra se nuk mund ta ndajë me një shpirt tjetër atë që ndjen pranë zemrës së vet, e tjetra se nuk mund t'i tregojë magjinë e tingullit që aq shumë adhuron.

Kjo grua shurdhmemece që duket si një dritë e bardhë (si për çudi) mbart në paaftësinë e saj, në kufizimin e saj shqisor natyrën e vdekur që duhet të kishte njeriu në kohën e diktaturës komuniste. Kjo grua shurdhmemece apo më mirë shurdhmeceria e saj bëhet simbol i mbijetesës dhe ekzistencës në një kohë vuve, të shtrembët. Një qenie që i është mohuar prej natyrës të dëgjuarit dhe të folurit, kënaqësia e rrekjes së botës tingullore dhe të lidhurit me njeriun përmes zërit dhe fjalës, një qenie që edhe është edhe nuk është midis të tjerëve, edhe gjallon edhe vdekëron. Ajo është aty brenda sistemit, ama sistemit nuk i vyen për qëllimet e tij djallëzore. Ajo, ashtu siç është ruan pafajësinë e saj, humanitetin në një kohë kur ishte krejt e pamundur për të tjerët. Ishte fati dhe fatkeqësia e saj, i një gruaje të vdekur të gjallonte mes të gjallëve prej kohësh të mbaruar.

E vetmja qenie që gjallonte në njëfarë mënyre e sigurt, ndoshta mund të themi edhe e lirë... Pandorës i mungonte gjuha, ura lidhëse me njeriun. Sa kohë kjo urë mungonte, ishte e lirë, e gjallë, ata nuk mund të arrin te qenia e saj.


Pavarësisht kësaj, narratori na rrëfen se sistemi dhe njeriu i asaj kohe nuk njihte asnjë limit. Edhe shurdhmecia bie në kthetrat e egërsisë dhe çmendurisë së njeriut të sistemit diktatorial.

"Mbërriti në shesh dhe shqeu sytë. Ushtarë me automatik. Ushtarë të gardës e kishin lidhur me



duart pas Pandorkën. E gjora! Përpëlitej dhe iu bënte shenjë. Teshat gati ishin grisur. Dy binjakët e kishin mbërthyer fort prej fustani dhe nuk pushonin së qari."

Megjithkëtë, çka narratori na tregon në përfundim të romanit për fatin e gruas shurdhmemece, na rikthen të mendojmë simbolikën e shurdhmecërisë së saj. Narratori na tregon se në një ngjarje festive ku bashkëshorti i saj luan muzikë, ajo zhduket. Nuk gjendet kurrë. Zhdukja e saj duket e vullnetshme, sikur ajo të ketë kuptuar diçka madhore për jetën e saj në sistemin e ri politik që u hap pas diktaturës. Thuaj ajo të ketë kuptuar se në një botë të re, me ngjyra, me tinguj, të qeshura, shpresa e liri ajo nuk do të gjallonte më, por më në fund do të vdekëronte. Kutia e saj u hap përsëri dhe shpresa që pati mbetur në fund doli si gjithë të tjerat, si gëzimet dhe fatkeqësitë që i ranë në hise njeriut.



PSALMËT OSE MË VETE E TË TJERËT

Poezia del vetëm nga vetmia e vërtetë. Poetët pa vetmi janë pjesë e turmës pa tru! Janë fundi i zhganit. Vetmia është i vetmi pentagram i poezisë së madhe

Shaip BEQIRI

* Pas Zef Serembes, Ndre Mjedës, Lasgush Poradecit, me të cilët dikur ke shënuar pikat kulmore të diagramit poetik shqiptar, tash duhet të vazhdosh atë vijë në ngjitje të mëtejme deri në mbyllje të shekullit XX. Pa u hamendur shumë

mund të shtosh tre kryemjeshtër të rëndësishëm të letrave shqipe: Martin Camaj, Beqir Musliu, Anton Pashku.

Ty të duket e pabërë lista ime personale! Tepër e ngushtë dhe tendencioze? Unë kam shpjegimin tim për këtë radhitje. Rëndësinë e këtyre të

treve e shoh pikësëpari tek vazhdimi i traditës së shkrimit të shqipes dhe shpirtit të pastër shqiptar, duke i dhënë asaj tradite përmasa të mëdha e të kulluara pikërisht në pjesën më të rrezikuar të vlerave tona krijuese.

I pari Camaj e rimbolli rrënjën shqipe të asaj tradite që kërcënohej katërçipërisht, duke e flijuar artin e vet, të cilin do ta ringjallë tërësisht në fazën e mëvonshme; i dyti Musliu krijoi trungun e universit të vet letrar duke mbërthyer brenda tij njëkohësisht dy shtylla gjigante: modernitetin e një shkalle të lartë të abstraksionit dhe etnitetin e përmasave kolosale; kurse i fundit Pashku të gjitha këto i vuri në rrafshin e përkryerjes artistike, duke krijuar shqip një kurorë të rrallë të artit modern letrar.

* Po tjetër! Lirika shqipe ka pasur edhe nismëtarë të tjerë të papërsëritshëm: Besim Bokshin, Bilal Xhaferrin, Fahredin Gungën, Azem Shkrelin, Rrahman Dedajn, Frederik Rreshpen, Ali Podrimen, Teki Dërvishin, Eqrem Bashën e ndonjë tjetër deri te Mimoza Ahmeti dhe ndoshta më tutje. Këta janë poetë të pastër. Më të kulluarit dhe më të ndryshmit njëri me tjetrin. Udhët dhe individualitetet e tyre krijues janë shumë të veçantë në origjinalitetin e vet. Dyshoj që do të kuptohen si duhet për shkak të epigonëve të shumtë që janë përpjekur me i ndjekur. Për të mos u bërë tepër cinik s'po them që epigonët e tyre janë bërë më të famshëm se vetë ata!

* Po them kalimthi se edhe Shqipëria tjetër ka pasur shkrimtarë të mëdhenj në këtë periudhë kohe, por ata i ka përçudnuar socrealizmi: Xoxa, Arapi, Agolli, Kadare, ose i ka ngulfatur mizorisht diktatura: Kuteli, Kokalari, Trebeshina.

* Për Ismail Kadarenë kam menduar shpesh dhe jo pak. Ai nuk ka qenë për mua kurrë ndonjë model i adhuruar krijues. Nuk njoh ndonjë autor tjetër që si ai t'i ketë rënë kaq keq më qafë veprës së vet. Këtë padrejtësi ndaj veprës së vet letrare ai e ka bërë sidomos pas arratisjes në Francë. Edhe pjesën e pastër të veprës së vet si duket do ta ndjekë hija e tij e keqe edhe më me ashpërsi nga varri i autorit të saj! Ndoshta s'do të më merret për maliciozitet po të them një të vërtetë të përgjasueshme me fatazmagorinë e këtij njeriu-letar: s'është kurrfarë çudie që edhe nga varri, ku do të jetë kallur një ditë, të arrijë ndonjë dorëshkrim i tij i fshehur me mundimin e pareshtur që të fshijë e pastrojë si me magji jo pak njolla të jetëshkrimit dhe të vepërkrijimit vetjak!

* Mos rrok armën të shkosh në front të asnjë lufte. Ti luftën e ke gjithmonë brenda vetes, kurse lirinë duhet ta kërkosh pareshtur në çdo fjalë të artit tënd. Si kërkimtar i pareshtur i lirisë, je i dënuar të mos kesh paqe kurrë.

* Plagët në ballin dhe kraharonin e luftëtarit të rënë për atdhe mos i krahaso me petale trëndafili mbuluar me vesë mëngjesi. Këso figurash kanë bërë vjershëtarët, prandaj ato ti duhet t'i shohësh ndryshe. Për shembull, ato janë qepalla sysh të përjetshëm që i dalin atij pasi t'i ketë mbyllur sytë natyralë. Nëpër to ai vazhdon të soditë përherë vendin dhe njerëzit në mbrojtje të të cilëve ka rënë.

* Vetëm ti mund ta shqiptosh deri në fund idenë e mbetur përgjysmë të luftëtarit të lirisë të rënë në fushë të betejës.

* ...lirinë(!) rrëmbeje dhe mbroje(!) me grahmën tënde dhe me pikën e mbramë të gjakut(!!!)...

* Lirinë tënde mund ta flijosh vetëm nëqoftëse shtrëngohesh ta përdorësh për t'ia rrëmbyer atë tjetërkujt.

* Lirinë krijuese nuk e ka kurorëzuar asnjë regjim, qoftë ai diktatorial apo liberal. Madje as që do të ketë ndonjëherë ndonjë regjim që do ta bëjë këtë gjë. Ajo gjendet vetëm brenda shpirtit krijues dhe askund tjetër.

* I mjerë është kombi që ndodhet në situatat kur poetët duhet t'ia drejtojnë politikën. Edhe më të mjerë janë poetët që marrin në duar të bëjnë një punë të tillë.

* Politika gjithmonë ka qenë arma më helmuese kundër poetëve. Ajo me shekuj ka tentuar të vrasë poezinë. Helmi i politikës ka pasur efekt katastrofik vetëm kur poetët kanë rënë në kthetrat e saj.

* Shëmbëllimi më i përkryer i dy gjërave krejt të ndryshme në këtë botë është ai midis politikës dhe kurvërisë. Kurrë nuk do të dihet me saktësi se cila mjeshtëri i ka marrë ose i ka dhënë më shumë tjetrës, sikundër që nuk dihet as fakti se cila është më e moçme se tjetra.

* Poeti i vërtetë politikën s'mund ta shohë ndryshe përveç me përbuzje.

* Ruaju nga censorët e vonshëm. Të hershmit i kanë shërbyer një regjimi, nga i cili kanë qenë



të paguar e të nderuar si të tillë. Ndërkaq këta të tjerët nuk përfillin kurrfarë regjimi shoqëror e as nuk mbështeten tek ndonjë kod moral. Po edhe regjimi i përbuz pa mëshirë ata, prandaj detyrohen të bëjnë tempullin e tyre para të cilit gjunjëzohen ditë e natë. Ai tempull veç emrin e ka të pandryshueshëm: inferioritet krijues.

* Ruaju nga vjershëtarët që duan të bëhen të famshëm me publicistikë, me politikë dhe me çfarëdo pune tjetër publike! Për ta poezia është një stacion i katandisur ku kanë zbritur gabimisht nga treni i fundit në pikë të natës më të gjatë të dhjetorit.

* Ruaju sidomos nga vjershëtarët që gjatë tërës jetës bëjnë vjersha lajkatare duke ëndërruar të ngjiten në shkallaren e pushtetit, qoftë edhe në postin e shefit të policisë lokale të vendlindjes së vet.

* Heqja e deliktit verbal nga juridiksioni i pothuaj gjithë vendeve me sistem të ashtuquajtur socialist në kohën pas rrëzimit të Murit të Berlinit, krahas anës së mbarë, e pati edhe anën tjetër të

zezë: grigjën e madhe të disidentëve të shpifur e la përgjithmonë pa alibinë e censurës. Në kohën kur s' mund t'ia hidhnin më fajin samarit të censurës se gjoja po ua lëndonte kurrizin, ata zunë të zhvatnin madje edhe lëkurën e artit të vet vetëm për t'u dëftuar si të dëmtuar të përjetshëm!

* Poetët me shekuj janë rropatur të futin muzikën në poezinë e tyre. Janë shpikur skema të panumërta teorike-metrike-ritmike nga studi-mtarë të ndryshëm të poezisë, duke bërë një punë kolosale e të mundimshme. Pas këtyre skemave kanë ngarendur theqafas sidomos vjershëtarët, duke vënë rima rigoroze në bisht të çdo vargu, madje shpesh edhe në mesin e tij.

Poetët e vërtetë nuk kanë vuajtur kurrë për këso gjërash. Ata e kanë ditur se muzika është e ngjizur me poezinë mu në thelbin e idesë fillestare të saj; e kanë ndier se s' mund të ketë kurrë poezi pa muzikë; e kanë kuptuar se muzika është e vetmja mvëshje hyjnore e poezisë.

* A ka ndonjë lidhje thelbi i idesë fillestare me të ashtuquajturin frymëzim poetik? Kjo pyetje është shtruar dhe diskutuar me shumë zjarr në kohën

e rinisë sime. Qëndrimi ndaj kësaj çështjeje si të thuash ishte një përcaktues i ashpër i përkatësisë krijuese të akëcilit. Prej atëherë ndiej dhembshuri për ata që humbin kohë pas gjërave të tilla.

* Megjithatë, diku thellë në vete e kam zap-tuar ndonjëherë këtë farë *pandjeshmërie krye-neçe!* Në përfytyrimin tim poetin e mbështjell një kristal gjigant, shpërthimi shkundullues i të cilin nxjerr buçimën shurdhuese nga e cila del skicimi i parë themelor i muzikës së poezisë. Ky fenomen i magjishëm nga të tjerët ndoshta është quajtur frymëzim...

* Midis faktit dhe fiksionit është një hapë-sirë e pagjurmuar fare. Aty janë të përqendruara shtjellat e mëdha të frymës jetësore, të cilat arti duhet t'i vendosë në thelbin e vet. Ngadhënjim-tarë të njëmendtë janë sall ata krijues që atë mur e shkallmojnë pa u vënë re prej askujt, pra në heshtje të plotë.

* Është një pjesë e madhe udhe në jetën e nje-riut që duhet kaluar nëpër një errësirë të padepër-tueshme as nga rrufetë. Ajo udhë bie midis mija humnerash përmes një tuneli pa fund. Ecja në atë udhë bëhet si nëpër teh shpate. Fjalën e kam gjithnjë për udhën e vërtetë krijuese. Pra, po flas për udhën e madhe të krijimtarisë, nëpër të cilën na prin vetëm fuqia e pashtershme e dashurisë. Ai që s'e di se dashuria qëndron më lart se të gjitha shenjtëritë e tjera, nuk mund të dalë kurrë nga terri e balta.

* Tragjedia. Qëkur e kam dëgjuar së pari herë këtë fjalë - gjithmonë të lidhur me emrin e Shekspirit - më është mbërthyer në tru si një mynxyrë, që s'ka aspak lidhje me kuptimin e saj të mirëfilltë. Brenda kësaj fjale më është dukur se ka diçka që digjet vazhdimisht, se në thellësi të saj ekziston një prush i përjetshëm të cilin nuk e shohim dot kurrësesi. Me fjalën tragjedi as sot nuk kuptoj gjë tjetër përveç: themelit të madhështisë, majës së pastërtisë dhe thelbit të bukurisë.

* Ndër komeditë e historisë mos ngarend kurrë të marrësh ndonjë rol. Ty roli të është dhënë me kohë. Luaje rolin tënd!

* Askund tjetër nuk ka mall e mllef sa brenda shpirtit të poetit. Madhësinë e shpirtit të tij e për-caktojnë njëkohësisht dashuria dhe revolta. Njëra

është një dashnore e patundur në besë dhe tjetra motër që nxë vendin kryesor në kujtesë.

* Frymën hyjnore të gjuhës shqipe e kanë kri-juar dhe e kanë ruajtur të gjallë e të shëndoshë kri-juesit e saj të mëdhenj. Ndërkaq shkencëtarët, ata që i thonë vetes gjuhëtarë, jo rrallë e kanë lënduar frymën e shqipes. Po të mos ishin poetët tanë të mëdhenj, bijtë e vërtetë të shqipes, gjuhëtarët do ta mbytnin pamëshirshëm këtë krijesë delikate. Ata do të bënin prej saj vetëm një herbarium.

* Edhe diçka për gjuhën. Për gjuhën shqipe. Është thesari më i madh i shqiptarëve. Sado që ne shqiptarët kemi një vend të mrekullueshëm me çdo lloj pasurish, vlera e gjuhës sonë është më e madhja pasuri jona.

* Skeletin e ngrehinës së një shoqërie njerëzore e mveshin fisnikërueshëm vetëm vlerat e artit e të kulturës dhe e bëjnë të qytetëruar atë. Pa ato vlera njerëzimi tepër shpejt do të katandisej në një mamuth krimi, në një dinosaur gjigant imorali-teti, në një rend të pafund dordolecësh trishtues.

* Vetmia. Një shtyllë e madhe e poezisë. Rro-tull saj janë bërë jo rrallë vërtitje të stisura poe-tike nën dritë të hënës. Më shpesh e kanë aktruar vjeshëtarët e majmur mirë, me faqet e skuqura si mollat në rremb, në ndonjë çast zalisjeje të thellë shpirtërore. Nuk ka asgjë më të keqpërdorshme se vetmia. Poezia del vetëm nga vetmia e vërtetë. Poetët pa vetmi janë pjesë e turmës pa tru! Janë fundi i zhganit. Vetmia është i vetmi pentagram i poezisë së madhe. Ajo është pjesa më fisnike e shpirtit të poetit. Vetëm me këtë virtut mund të matet morali i krijuesit.

* Sa përmasa kolosale zbrastësie do të kishte bota jonë sikur të mos i mbushte ato fryma e pashtershme e dashurisë. Pra atë e mban vetëm drejtpeshimi i vet, i cili pafundësisht mban gjithë rruzullimin.

* Sado thellë e fort të jenë futur rrënjat e bimës së dashurisë në dheun e *pruarar*, patjetër që vrullin jetësor ua rrit një sasi e domosdoshme e plehut të xhelozisë.

* Asnjë dashuri e madhe në këtë botë nuk ka mundur me mbujtur kurrë bukën e saj pa thar-min e mbarimit të vet tragjik!

POEZIA KUNDËR HARRESËS

Poezia e Molliqit nuk është e zbukurimit formal apo ornamentit gjuhësor. Ajo lind nga përvoja e jetuar, nga prekshmja, dhe nga ajo që mund të quhet “provë” në diskursin juridik, por që në letërsi shndërrohet në dëshmi morale

Nga Mërgim BEKTESHI

Vëllimi poetik *Ata udhëtonin pa e ditur fundin* i Ari Molliqit, botuar nga Shtëpia Botuese Armagedoni, shfaqet si një nga librat më përfaqësues të poezisë shqipe bashkëkohore. Ai ndërthur jetën individuale me fatin kolektiv, siç thotë autori në një varg: *“përrallë e vjetër me rroba të reja”*.

I botuar në prag të përfundimit të vitit 2025, ky libër përmbledh rreth pesëdhjetë vjet krijimtari dhe funksionon si një biografi poetike, ku historia personale, kujtesa, dhimbja, mërgimi dhe varfëria shpirtërore e një populli të përndjekur nga peripecitë historike shndërrohen në materie poetike. Molliqi nis nga koha kur lind në vendlindjen e tij dhe kujton gjithçka organike e të zakonshme, që nga këngët e vjetra të Sali Agës e deri tek ajo e Rrushës, që shembi shumë burra, por pa harruar as kuvendin e pajtimit, i cili tani mban emrin rruga e qenve – një fyerje për dinjitetin individual dhe kolektiv të shoqërisë.

Poezia e Molliqit nuk është e zbukurimit formal apo ornamentit gjuhësor. Ajo lind nga përvoja e jetuar, nga prekshmja, dhe nga ajo që mund të quhet “provë” në diskursin juridik, por që në letërsi shndërrohet në dëshmi morale. Që nga poezitë e hershme e deri te ato më të vonat, autori ndërton një univers ku realizmi i vrazhdë bashkëjeton me simbolizmin e ngjeshur, ironia e hidhur me tragjiken njerëzore, ndërsa liria dhe humbja mbeten dy pole të pandara të përvojës ekzisten-



cialle. Kjo manifestohet edhe kur mungon shpirti lirik ose tendenca për të thënë të vërtetën, si në vargun: *“ka mbulojë qiellin / ka dyshek tokën”*, që reflekton jetën evropiane, por edhe situatën e njeriut të sotëm.

Një nga boshtet themelore të këtij vëllimi është kujtesa, e cila shfaqet në mënyrë të theksuar në poezitë e përzgjedhura nga botuesi Armagedeon. Poezia shfaqet si akt rezistence kundër harrësë dhe përpjekje për të ruajtur përvojën njerëzore nga zhdukja: *“të dytë jemi zverdhur / e gjethet po na bien”*. Kthimi i vazhdueshëm te shtëpia, te fshati i Llukës së Epërme, te figura e babait dhe nënës, te varfëria dhe frika e fëmijërisë, nuk ka karakter nostalgjik, por etik. Poezi si *“Im atë të shtunave më blinte këpucë llastiku”*, *“Nëna ime, heroina ime”* apo *“Në Prishtinë”* funksionojnë

si dokumente shpirtërore të një kohe të errët, ku jeta e njeriut të zakonshëm ishte e zhveshur nga heroizmi, por e mbushur me dinjitet. Ky dinjitet shfaqet mallshëm dhe herë me gjuhë të ashpër kur poeti lëndohet.

Atdheu në poezinë e Molliqit nuk idealizohet. Redaktori i librit e shquan këtë me realizëm emocional: ai shfaqet si hapësirë e plagosur dhe e mbingarkuar nga historia, ku poeti nuk i drejtohet atdheut me patos romantik, por me realizëm emocional, si në vargun: *"Te Verrat e Llukës / këtë të diel nuk mbahet Kuvendi Pajtimit / do të mbahen gara e qenve"*. Dashuria për vendin shprehet përmes dhimbjes, jo retorikës, duke e forcuar lidhjen emocionale që shpesh e çon autorin deri në ekstrem. Poezia i kundërvihet mitizimit dhe vendos përvojën kombëtare në një plan kritik dhe reflektues, duke qortuar keqësinë që katandisë vendin.

Motivi i lirisë përshkon pothuajse gjithë librin, por gjithmonë si mungesë. Liria nuk shfaqet si gjendje e arritur, por si pritje e vazhdueshme, si *"folje dëshirore"*. Në poezinë *"Liria është folje dëshirore"*, ajo lidhet me varfërinë e refugjatit, dritaret e thyera, kollën e fëmijëve dhe ekzistencën e pasigurt. Këtu liria nuk triumfon, por mbetet premtim i shtyrë, duke kthyer jetën në përpjekje të pandërprerë për mbijetesë. Mbijetesa dhe koncepti i Mbinjeriut i Niçes reflektojnë në vargjet e Molliqit, jo alegorikisht, por në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe konkrete.

Një shtyllë tjetër qendrore është mërgimi, plagë që e rrëmben poetin si qenie fizike dhe metafizike. Molliqi nuk e trajton mërgimin si aventurë apo udhëtim, por si gjendje shpirtërore të copëtimit. Poezia *"Kur qeni i shtëpisë nuk më njeh"* përmbledh tragjedinë e mërgimtarit: kthimin në vendlindje dhe humbjen e përkatësisë, deri në pikën ku as qeni nuk e njeh më. Ky imazh i fortë shndërrohet në metaforë të humbjes së identitetit: *"sepse brenda kornizës metalike të aeroplanit / kam ngarkuar një peshë të rëndë malli / kam ngarkuar atdheun plot me sëmundje"*.

Qytetet evropiane në poezinë e Molliqit shfaqen të ftohta, të zhveshura nga estetika turistike, hapësira ku njeriu mbetet i huaj dhe i ndarë nga vetvetja dhe të tjerët. Poezi si *"Qyteti pa kinema"* dhe *"Kujtime për Adelen"* dëshmojnë se mërgimi nuk është vetëm fenomen social apo ekonomik, por një plagë ontologjike: gjendje ku njeriu nuk është kurrë i plotë, as këtu, as atje.

Ironia dhe sarkazma përbëjnë armë të rëndësishme në këtë libër. Molliqi i përdor ato për të

demaskuar absurditetin e jetës moderne, moralin e rremë dhe zbrazëtinë e pushtetit. Në poezinë *"Në 'Monako' të kryeqytetit"* ironizohet kultura urbane e konsumit, ndërsa *"Grafite"* zhvesh gjuhën zyrtare nga çdo solemnitet, duke sugjeruar se e vërteta shpesh del më e pastër nga margjina sesa nga foltorja. Kjo ironi nuk është lojë gjuhësore, por qëndrim etik dhe i vendosur.

Universi simbolik i Molliqit është i qëndrueshëm dhe dallueshëm: zogjtë shfaqen si metaforë e pafajësisë së vrarë dhe e popullit të plagosur; qeni si shenjë e besnikërisë së humbur; merimangat, gjarpërinjtë dhe kafshët e liga si figura të prishjes morale; bora, shiu dhe acari si gjendje shpirtërore. Në këtë botë poetike, shpesh më shumë flasin kafshët dhe natyra sesa njerëzit, duke vendosur njeriun në pozitë të brishtë.

Dimensioni intim, familjar dhe erotik zë vend të rëndësishëm. Poezitë mbi marrëdhëniet njerëzore, si *"Burri që hante djathë zviceran"* dhe *"Rrëfim i një pijaneci"*, trajtojnë degradimin moral, vetminë dhe vetë-shkatërrimin pa romantizim. Ato janë rrëfime të ashpra, por të ndershme, ku njeriu përballet me vetveten. Poeti trajton edhe gruan, nga Eva e tutje, si dhe kujtime të trishta dhe të dhimbshme, duke i kthyer në përvojë jetike që analizohet me syrin e artistit.

Lufta dhe pasojat e saj shfaqen si traumë e vazhdueshme. Varret, heronjtë e heshtur, vrasësit dhe sëmundjet biologjike e politike ndërthuren në një ligjërim ku trupi individual dhe ai shoqëror duket i infektuar nga harresa dhe moskuptimi. Poezitë e Molliqit e shndërrojnë librin në dokument të një epoke të trazuar, duke treguar dhimbjen e brendshme dhe duke evidentuar çka është e shëmtuar dhe e padrejtë në shoqëri.

Stilistikisht, Molliqi përdor gjuhë të drejtpërdrejtë, të zhveshur nga ornamentet e panevojshme, por të ngarkuar me figuracion dhe intensitet emocional. Vargu shpesh afrohet me prozën poetike, por ruan thellësinë lirike. Gjuha nuk kërkon vetëm të kuptohet, por të përjetohet. Dallohen poezitë ndër vite, si nga vargu ashtu edhe nga kuptimi gjuhësor, temat dhe aktualiteti.

Përfundimisht, *Ata udhëtonin pa e ditur fundin* është më shumë se një përmbledhje poezish: është një arkiv moral, akt kujtese dhe formë rezistence kundër harresës. Poezia e Arif Molliqit i kundërvihet heshtjes me fjalë, zbrazëtisë me etikë dhe harresës me kujtesë. Në një kohë të banalizimit të gjuhës, ky libër rikthen peshën e poezisë si akt përgjegjësie dhe vetëdijeje.

MËRGIMTARI MARTIN CAMAJ

Çfarë do të thotë për një autor të jetosh në mërgim e të mos e harrosh gjuhën e nënës dhe të shkruash vetëm shqip?

Xhahid BUSHATI

Martin Camaj është një nga figurat më të rëndësishme të letërsisë shqiptare të shek. XX, krijues, gjuhëtar dhe studiues i kulturës shqiptare. Personaliteti i tij dallohet nga disa veçori:

- Njeri i përkorë dhe i tërhequr. Camaj jetoi një jetë larg zhurmave publike. Edhe në mërgim, ruajti dinjitetin e heshtur dhe një profil të atij rrafshi, duke lënë të flasë vetëm vepra e tij. Në qendër të botës së tij artistike qëndrojnë përsiatjet filozofike, kërkimi i kuptimit të ekzistencës dhe identitetit, dialogu i njeriut me natyrën dhe me veten.

- Studiues dhe ruajtës i kulturës shqiptare. Ai i përkushtohet thellë dialektit të gegnishtes e më **gjerë**, strukturave të gjuhës dhe traditave të kulturës së Veriut, por i sheh ato me syrin e një krijuesi modern europian.

- Është Personaliteti i dy botëve. Një "njeri i ndarë më dysh": korpusi i tij shpirtëror është Malësia dhe Shqipëria, por realiteti fizik është mërgimi. Ky dyzim ushqen krijimtarinë e tij në poezi dhe në prozë.

Po të **ndaleshim te motivet, disa prej tyre** janë: - Mërgimi dhe vetmia (Ndjenja e shkëputjes nga vendlindja, e braktisjes, e të qenët gjithmonë "jashtë"). - Gjuha dhe identiteti (Gjuha shqipe i bëhet strehë, atdhe, substanca përmes së cilës ruhet vetja). - Natyra e Malësisë (Shpesh e mitizuar: malet, erërat, bora, krojet, pyjet - një peizazh i marrë nga kujtesa). - Kujtesa dhe fëmijëria



(Camaj e kthen fëmijërinë në një territor poetik, ku realja dhe mitikja bashkohen). - Simbolika dhe metafizika (Shumë poezi ngrenë pyetje mbi kohën, fatin, qenien, mungesën, komunikimin me të



padukshmen). - Raporti mes traditës dhe modernitetit (Ai e sjell traditën shqiptare në formë moderne poetike, duke e transformuar atë në simbol).

Tani të vijmë te pyetja më e vështirë: - Çfarë do të thotë për një autor të jetosh në mërgim e të mos e harrosh gjuhën e nënës dhe të shkruash vetëm shqip? (Për Camajn, ky është një akt i vështirë, por edhe heroik. - Paraqitet Gjuha si identitet (Shkrimi në shqip është mënyra për të ruajtur veten, rrënjët, kujtesën kulturore). - Paraqitet Gjuha si strehë shpirtërore (Në mungesë të vendit, i vetmi atdhe i mbetet gjuha). - Paraqitet Gjuha si Rezistencë kulturore (Në një mjedis kur mund të shkruante gjermanisht apo italisht për të fituar më shumë lexues, ai zgjodhi shqipen, duke dëshmuar një lidhje të pathyeshme). - Paraqitet Gjuha si Krijim në izolim. (Shkrimi në një gjuhë të vogël në mërgim e bën autorin të jetojë në "dy vetmi": vetminë fizike dhe vetminë e lexuesit të munguar. Por Camaj e përballon me dinjitet dhe triumf).

Edhe kësaj pyetje: Si i konceptoi Camaj në mënyrë moderne zakonet, ritet, të folurën, peizazhet dhe botën e malësorit? Përgjigja e parë : - Camaj nuk është etnograf tradicional; ai krijon art modern duke përdorur elementet e kulturës së malësisë: **Përgjigja e dytë: - U ndal te zakonet dhe ritet, të cilat nuk i përshkruan si folklor, por i sheh si struktura psikike që përbëjnë shpirtin e komunitetit.** Camaj tregon si zakoni formëson individin dhe konfliktet e tij. - U ndal te e folura e personazheve, **për ta përdori gegnishten e më gjerë**, por me një ritëm poetik modern. E ngre të folurën e malësorit në nivel të një letërsie të lartë. U ndal te dialogu, ku, shpesh, është simbolik, i shkurtër, i


prerë. - U ndal te peizazhet, **të cilat pikturohen me mjeshtëri**, por jo romantike. Peizazhi nuk është dekor: është shpirt, është gjendje e brendshme. Ai e rikrijon peizazhin e fëmijërisë në mënyrë imagjinare, siç e jetojnë në kujtesën tonë. - U ndal te psikologjia dhe bota e **Malësorit, ku njerëzit e Malësisë** nuk janë tipa folklorikë; por janë qenie me dilema, frymë, plagë, madhështi dhe tragjedi. Ai i sheh në marrëdhënie me natyrën, me zakonet, me fatin dhe me misterin.

Camaj është shkrimtari i kujtesës, i shpirtit të mërguar dhe i kërkimit për rrënjët. (Letërsia e tij është një univers më vete - e pasur, enigmatike, estetike dhe thellësisht njerëzore. Camaj nuk rrëfen realitet të jashtëm. Ai krijon botë të brendshme, të simbolizuara, shpesh duke përdorur realitetin e malësisë si mit, metaforë, kujtesë. - Shkrimi i tij ka natyrë filozofike e hermetike, i kërkon lexuesit bashkëpunim).

Gjuha e Camajt është më e veçanta e letërsisë shqiptare moderne. Ai përdor Gegnishten Veriore, por e shndërron në një gjuhë poetike universale, të rafinuar, me sintaksë të copëzuar dhe me ritëm të brendshëm. Shkrimi i tij shpesh është kodik, simbolik, jo i drejtpërdrejtë. Poezia e tij është e përqendruar, dhe e ngarkuar me kuptime të shumanshme.

Camaj është autori që e shndërroi kulturën tradicionale shqiptare në letërsi moderne dhe postmoderne, jo duke e përshkruar, jo duke e denoncuar, por duke e përjetësuar si mit, simbol dhe memorie të brendshme. Është Poet metafizik i identitetit shqiptar, i gjuhës dhe i mërgimit. Në letërsinë shqipe Camaj është Shkrimtari i kujtesës.

Poezi / Ymer SHKRELI



SHËNIME NGA EPIRI

(ME NATËN NË JANINË)

bredh
me natën e shurdhër në xhep
herë shikoj fytyrën time
mbrapsht herë
kollitëm thatë pështyj
pështyj gjak në hënën e pafaj
si në faculetë
pra meje qëndrojnë hijet
e zbrazët dhe fjalët boshe
vazhdoj më tutje me hijen përdore
si fëmijën e humbur
e nuk njihemi as sot
nënë as babë nuk kam as gjuhë
as gjuhë nuk kam në gojë kam heshtje
as zjarrit nuk i fryj

origjinën e ndjek në tym të cigares
që digjet atdheu në thonj
vendlindja shkruan në leje të njoftimit
dhe diçka tjetër që nuk lexohet
nga shiu breshëri bora
kanë dimër në katër stinë
me natën në xhep bredh i shurdhët
dita ime është flamur
në anën tjetër të kohës
kam natën e urtë
kam çelësin e saj të ndryshkur
dhe ofshaj ofshaj
i bardhë dhe i urtë dhe i lodhur
me sytë që i ruaj nga drita e tepërt
bredh i harruar i humbur
ne natën e shurdhët në xhep
me terrin

(DODONA)

gjeje lisen tënd e vari E
e vdis pak që të shohësh më në fund
si jetohet përnjëmend
gjeje gurin që ke mbi kokë
sepse aty diku e ke kokën
ngule atë rrashtë në gjoksin
e lodhur e thuaj
ky është varri im
dhe në mos qofsha unë

(TË IKURIT NGA GJUHA NË GOJË)

ditë e përditë
do fjalë të hidhura barishte
do fjalë të kota pelim
që vjellin helm
do gjuhë të trembura do gojë
të hidhur do sy
që shikojnë verbër do gjymtyrë
të këputura do shqisa të djegura
përsëri do fjalë të pakripë
që nuk pinë ujë
do fjali të shpifura e do
Fjalorë të pafytyrë ditë e përditë
dhe do sy kinse të urtë që nuk shohin
fare do veshë që nuk dëgjojnë
nëpër do net plot terr
në pritë .
ditë e përditë
do fjalë të hidhura barishte hita
do qen që lehin në erë kafshojnë
përsëri do fjalë që nuk janë
as pinë ujë e na bëjnë
më pak fare pak një grimë
do duar që na fshijnë nga fytyrë e dheut
dhe do libra që grisen sepse
të lexohen nuk kanë guxim
do flet të ndojtura do kaptina
që ngrysen e në ngryse
përpijnë hanë kafshojnë

(PARGA)

të vë shkrumb mbi vetull e natën
ta gdhend në sy e mallin
e djegur të dëfton dhe bëhet poezi
e hyn këtu nuk e ka vendin
nuk do zemër sepse
ta pi dhe ujin në mëlçi

të vë akull pastaj
e të thotë diçka me gjuhë të djegur
të rëndon me gurë ballin
dhe nuk të mbetet rrugë tjetër
pos të kthehesh saherë
koha të të mungojë e liga
kështu e ka parga pikë loti
në mollëzën që nuk është imja
në ujin që huazoj e pi e dehem
dhe dita e sotit '
kot më zbret tashti nga dega
dhe deti ik nga ullishtet
i lodhur, ah parga
pikë më shumë pikë e dobët
të vë shkrumb në qerpik pastaj
e zhduket thotë vonë është
njëherë tjetër
kur të kthehesh i thinjur
si e kaluara si floku si gjethi
i vyshkur pa adresë me një letër
të djegur, eh parga
parga parga në pliko

(PËRKUSHTIM)

njeriut që nuk e njohim fare
as unë as ju askush
e që do të vdes në një çast
për një fjalë goje
dhe që do të mos mbetet mbi dhe
që mos t'ia hanë sytë larashët
duhet hapur varr këtu
në këtë varg të gjorë
njeriut që mbase nuk e njohu
sa veten e tij sepse
ishte hidhëruar me fatin
dhe nuk fliste as me historinë
njeriut që e kishte çelësin
por nuk ishte e tij koka e tij
njeriut që më në fund nuk desh
të shoh as në këtë kohë të ligë
me përkushtim i hap varrin
mu në këtë poezi
dhe i bëhem dhe përmbi varrin
që bimët të marrin frymë

TREGIM/ GENT MARKAJ



VRASËSIT

Çeli sytë! E di që nuk do, por të paktën provoje. Shikoje drejt e në sytë e pjetë dhe pyete vetën nëse të pëlqen çfarë ke bërë! Sodite mirë e mirë veprën tënde e analizoje çfarë ndien. E di që nuk të mundon ajo që sheh, as gjaku, as trupi i pjetë e i palëvizshëm i tjetrit, madje s'të bezdisin as duart e përgjakura të cilat në mënyrë mjeshtërore kryen veprën. Por ky s'është faji yt. Me kalimin e viteve zemra e çdokujt dalëngadalë kthehet në gur, e nervat bëhen të hekurta, saqë s'ndien më as shqetësimin, as frikën. Duket e çuditshme se si njeriu pak nga pak, me kalimin e kohës, mësohet të mos preket më nga vdekja e tjetrit. Trishtuese duhej të ishte me siguri veç hera e

parë, përballja e parë me vdekjen e tjetrit, sidomos po të ishte faji yt. Ndoshta as e dyta e as e treta s'ishin më të lehta. Vetëm pasi të shkonin dëm një numër i madh njerëzish filloje të pajtoheshe me fatin dhe çuditërisht të pjetët pak nga pak humbnin tiparet e njeriut në mendjen tënde, e ktheheshin në numra, në statistikë, e hiç më shumë.

E ti, a mos vallë do të bësh atë që do të bënte çdo njeri tjetër, të arsyetohesh që s'ishte faji yt dhe që ti vetëm kreve punën tënde, apo do të gjesh ndonjë arsyetim më interesant e më të veçantë? Sido që të jetë, me naivitetin tënd fëmijëror nuk do ta mashtrosh askënd. Shfajësohu sa të duash, siç shfajësohen të vegjlit pasi kanë bërë gjëra për



të cilat presin ndëshkim. Mu sikur e tradhtojnë fëmijën buzët e përlyera me çokolatë, ashtu të tradhtojnë edhe ty duart që të kullojnë gjak. Bëhu burrë e pranoje, ishte faji yt e i askujt tjetër!

Me shpërfillje ia kthen shpinën trupit të pajetë dhe largohesh i qetë sikur asgjë të mos kishte ndodhur. Në sy të bie dielli, i cili ka filluar të ulet dhe duket se shumë shpejt nata do t'ia zërë vendin ditës. Në agoninë e tij sizifiane, ai lëshon mbi ty rrezet e fundit për sot, ndoshta që të vezullojnë pikat e gjakut e t'i shohin të gjithë, edhe pse ngutesh të arrish te çezma për t'i shpërlarë. I shpërlan me kujdes të gjitha, si një Pilat, derisa të duket se s'të ka mbetur më asnjë pikë gjaku, pa e ditur që të ka mbetur një njollë e madhe, e atë, edhe në mos e pafsh vetë, e sheh i Gjithëpushtetshmi, në sytë e të cilit ti sikur ke vrarë gjithë njerëzimin.

Jashtë, nën dritën e diellit që po zbehet, të duket se nuk të kushtojnë vëmendje. E heq maskën dhe prapë dukesh si njeri, si gjithë të tjerët, si të pafajsh-

mit; ndoshta thellë në vete pandeh se maska ishte ajo që të bënte monstër. I kthehesh prapë normales, përditshmërisë së mërzitshme, halleve e vuajtjeve që të ndjekin pandarë. Ndien një lodhje dhe një dëshirë që të ulesh diku të pushosh pak e ta njomësh atë gojën e shkretë me ujë. Ecën mendueshëm për ca kohë dhe shkëmben shikime me njerëz, sytë e të cilëve kryqëzohen me të tutë. Sikur harron se diçka ka ndodhur para ca kohe, ose vetëm shtiresh ashtu. Por mu atëherë kur mendja jote shkon diku tjetër, ndodh diçka që të tremb.

Ndihet një zë femre që i jepet kujës. Një vaj therës që ta plas zemrën tënde të ngurtë. Zëri tërheq mbi vete shikimet kureshtare të njerëzve përreth. Një grua kishte vënë duart mbi fytyrë e po dëneste me gjithë shpirt. Që larg dallohen rrudhat e cekëta që ia mbulojnë duart. Në trupin tënd ndien një forcë të padukshme që të tërheq drejt saj.

- A thua ç'ka vallë? - thua me vete i kapluar nga një ndjenjë dhembshurie. Këmbët tua të çojnë

drejt saj por nga goja të del veç një shprehje e mbytur. Ajo kthen kokën dhe pyetjes "A mund të të ndihmoj" i përgjigjet me tundje koke.

– A mos do ujë? – vazhdon ti me tënden. – Të ndihmon të qetësohesh.

Ajo tund kokën përsëri në shenjë mohimi.

Sytë e tu janë ulur përdhe dhe shohin tokën kurse sytë e saj janë të mbyllur dhe përpiqen të shohin diçka që s'është më e kësaj bote. Të vie keq që ajo e mjera vuan por nuk e kupton pse. Ndoshta po ta dije do të mund të ndryshojë ndonjë gjë.

– Ç'është ajo që të mundon?

Ajo vazhdon të dënesë dhe me zërin që i dridhet, e të cilin herë pas here e ndërpresin gulçimat, thotë: "Ma morën shpirtin tim... zemrën time...Ma vodhën..."

– Kush vodhi dhe çka?

– Ma morën birin!

Në vajtim e sipër shqipton një mallkim. Mallkon atë që ia bëri këtë të zezë.

– Kurrë mos paftë ditë të bardhë! Ia ktheftë Zoti në fëmijët e tij! I gjetë edhe ata si e gjeti timin!

Ajo që në fillim s'të bëri përshtypje, befasi ta drodhi qenien tënde me tërë fuqinë. Ajo pa e ditur as vetë të mallkoi ty. T'u desh kaq shumë kohë që të kuptojë se si njeri i pafat që ishte, kishe ndeshur nënën e atij që shkoi në amshim.

Gjaku t'u ngri nga tronditja. Të duket vetja si mbi prush por je si i ngrirë e nuk lëviz dot.

"Epo, mos u brengos se tani është në një vend më të mirë", thua i zënë ngushtë duke u përpjekur të ikësh sa më parë. Sytë e saj tanimë janë bërë të padurueshëm. Ndoshta ajo pandehte diçka. Tani të duket se më parë ke pikasur një ndriçim të egër në sytë e saj, një shenjë urrejtjeje të kamufluar. Sikur të ka tërhequr e të ka lënë të afrohesh që të të mallkojë më mirë, që mallkimi i cili Zoti e di si përhapet, të të kapë drejtpërdrejt. Ti kërkon vetëm të arratisesh diku larg nga këtu.

– Më duhet të shkoj tani. Ngushëllime për djalin! Më vjen shumë keq.

Kur ia kthen shpinën ndien akoma shikimin e saj përcëllues që të ndjek, derisa dëgjon zërin therës të gruas që prapë ia fillon të qarit. Atëherë kupton se shpëtove. More frymë thellë dhe u mundove të qetësohesh.

Çuditërisht, me atë shpejtësi me të cilën u largove nga ajo, me atë edhe e harrove ç'ndodhi. Rastësisht, pa kaluar shumë kohë nga takimi shqetësues me gruan, e pe një mik dhe çdo shenjë shqetësimi u fashit. Ndoshta kjo është pjesë e mallkimit.

Tani përkundrazi dukesh i qetë dhe herë pas here edhe buzëqesh. Ndoshta e ke nga drita e

dobët artificiale që nuk të ndriçon fytyrën mjaftueshëm, e nuk dallohet qartë se ç'shpreshje shfaq fytyra jote: shqetësimin apo lehtësimin.

Më në fund përshëndetesh edhe me këtë e nisësh për në shtëpi, atje ku të presin fëmijët e tu. I përqafton me ngrohtësi dhe i ledhaton. Ndien një shqetësim në kohën që i mban në krahë. Ke frikë. Por frika shafitet shpejt. Pastaj shtrihesh në shtrat dhe e vë kokën mbi nënkresë. Duket se vetëm ajo mund ta bartë peshën gjigante që të rëndon mbi kokë.

Brengosja të lexohet në fytyrë. Një çast i beftë pikëllimi të paska kapluar tinëzisht. Thellë në vete duket se ndihesh fajtor për gjithçka. Pyet veten se a ke bërë zgjidhjen e duhur kur i hyre kësaj rruge. "Ç'profesion i mundimshëm, të grish njerëz," psherëtin me vete. "Ç'djall më shtyri të zgjidhja këtë drejtim?"

Duket se shpesh pendohesh për këtë zgjedhje por si për shumëçka tjetër në jetë tani është shumë vonë për të ndryshuar ndonjë gjë. Ka kohë që kur zaret janë hedhur.

Por pendimi yt si gjithçka tjetër në këtë botë duhet të jetë i përkohshëm e i rrejshëm. Ti prapë vazhdon ta vrasësh njerëzimin, çdo ditë të re që lind, pa u frikësuar se ata lumenj gjaku që derdh do të të ngulfasin një ditë, atje ku do të ketë vetëm kujë e kërcitje dhëmbësh. Ti vret çdo ditë nga një njerëzim të ri, por a thua pse nuk të mundon kjo aq shumë? Përse nuk vuan aq shumë sa dua që të vuash?

Tani, ti nuk ma vë më veshin sepse të ka kapluar kotja. Dalëngadalë po kridhesh në botën e të pavetëdijshmes, thellë nën sipërfaqen e ujit dhe sa më tepër zhytresh aq më fort ikën nga e vetëdijshmja që noton mbi të si një majë e ajsbergut kërcënues. E sheh si po fundosesh thellë e më thellë në ujë, larg e më larg nga maja e akullnajës e zëri im po bëhet më i dobët e më i pakuptueshëm. Gjithçka rreth teje tani po shuhet. Çdo dritë, çdo zhurmë, çdo brengë, çdo gjë; edhe mundimet e mia, ndërgegjes tënde...

Fli pra i qetë... në botën e të pavetëdijshmes unë s'vij dot. Mirëpo do të jem te kryet tënd qysh në çastin e parë kur do të hapësh sytë, e gjithçka do të fillojë prapë nga e para.

Ndoshta një ditë do të pushojë së rënduari kjo barrë e rëndë mbi supet e tua, e atëherë do të ndihesh i lirë edhe jashtë botës së ëndrrave. Fli pra i qetë, fort i nderuari kirurg, e lute Zotin që nesër ato duar të arta mos të mbysin njerëz, por të shpëtojnë!

Janar 2015

ANA KARENINA: NJË KUJTIM QË ENDE DHEMB

Të lexosh Ana Kareninën shpesh ndjehesh si të kthehesh në veten e mëparshme - personi që ishte kur ke hasur për herë të parë dashurinë, shpresën dhe zhgënjimin pa e ditur se sa të brishtë ishin


Disa romane nuk mbarojnë thjesht kur mbyllet faqja e fundit. Ata zgjasin - qetë, kokëfortësisht - si një melodi që dikur e ke dashur dhe kurrë nuk mund ta harrosh plotësisht. Ana Karenina është një libër i tillë. Nuk nxiton drejt lexuesit; ai pret. Dhe kur më në fund flet, e bën këtë me një trishtim aq intim sa të ndihet personal, sikur romani të ka kujtuar gjatë gjithë kohës.

Të lexosh Ana Kareninën shpesh ndjehesh si të kthehesh në veten e mëparshme - personi që ishte kur ke hasur për herë të parë dashurinë, shpresën dhe zhgënjimin pa e ditur se sa të brishtë ishin. Ka diçka thellësisht nostalgjike në botën e Tolstojt: dhomat me qirinj, trenat e dimrit, bisedat e pëshpëritura dhe zemrat që thyhen në heshtje nën shtresat e dekorimit social.

NJË BOTË E RËNDË ME HESHTJE

I vendosur në Rusinë e shekullit të nëntëmbëdhjetë, romani shpaloset në dhomat e vizatimit dhe pasuritë e fshatrave, megjithatë nën këtë elegancë qëndron një mbytje e pashprehur. Shoqëria buzëqesh me mirësjellje, ndërsa kërkon bindje. Lumturia, veçanërisht për gratë, duhet të ndjekë rregulla strikte ose të mos ekzistojë fare.

Ana hyn në këtë botë tashmë e papushuar. Tragjedia e saj nuk është se dashuron shumë, por se jeton në një shoqëri që nuk lejon hapësirë të sigurt për ndjenjën e ndershme. Tolstoj nuk e portretizon atë si një rebele të pamatur; përkundrazi, ajo është dhimbshëm njerëzore - e tendosur, e pasionuar, e frikësuar dhe gjithnjë e më e izoluar.



Melankolia e romanit rritet ngadalë, si dimri që zvarritet. Në fillim ka ngrohtësi, madje edhe emocion. Por gradualisht, gëzimi fillon të ndihet i huazuar, i paqëndrueshëm dhe më në fund i pamundur të mbahet.

DASHURIA SI MALL, JO PLOTËSIM

Një nga arritjet e qeta të Tolstojt është refuzimi i tij për të romantizuar dashurinë si shpëtim. Marrëdhënia e Anës me Vronskin fillon me intensitet dehës, por së shpejti zbulon një të vërtetë mizore: vetëm dashuria nuk mund ta mbrojë një person nga vetmia. Anën e duan - por nuk e kuptojnë. E dëshiruar - por jo e pranuar. Kjo kontradiktë emocionale bëhet torturimi i saj. Romani na kujton se pasioni pa përkatësinë mund të bëhet forma e vet e mërgimit.

Në kontrast, Tolstoj e ofron historinë e Levinit jo si një zgjidhje perfekte, por si një kundër-ekuilibrë. Luftimet e Levinit me besimin, qëllimin dhe thjeshtësinë tregojnë një lloj tjetër malli - mallin për kuptimin dhe jo për shpëtimin. Edhe këtu, lumturia është tentative, fitohet përmes dyshimit dhe qëndrueshmërisë, jo sigurisë.

SHOQËRIA SI EKZEKUTUES I PADUKSHËM

Ndoshta aspekti më i përndjekur i Ana Kareninës është se sa pak mizori kërkohet për të shkatërruar një jetë. Asnjë personazh i vetëm nuk e dënon vërtet Anën - megjithatë të gjithë e bëjnë. Përmes vështrimeve, përjashtimeve dhe heshtjes.

Tolstoj e ekspozon shoqërinë jo si një horr me zë, por si një sistem që dënon devijimin me tërheqje. Ana nuk dëbohet me zë të lartë, ajo fshihet në heshtje. Kjo e bën atë të zbrësë më të dhimbshmen, sepse ndihet e njohur. Shumë lexues e njohin këtë braktisje të ngadaltë sociale në jetën ose kujtimet e tyre.

NJË TRAGJEDI QË NDIHET E PASHMANGSHME, MEGJITHATË E PARANDALUESHME

Ajo që e bën Ana Kareninën kaq shkatërruese është sensi se gjithçka mund të ketë qenë ndryshe. Shoqëri e sjellshme. Një ndershmëri më e guximshme. Pak më shumë dhembshuri. E megjithatë, asgjë nuk ndryshon.

Tolstoj nuk e gjykon ashpër Anën. Në vend të kësaj, ai na lejon të ulemi me konfuzionin e saj, frikën e saj për të humbur dashurinë, dëshpërimin e saj në rritje. Në momentin që romani arrin momentin më të errët, lexuesi nuk ndjen tronditje - vetëm një njohje të rëndë, të dhimbshme.

Kjo është tragjedi jo si spektakël, por si pashmangshmëri e qetë.



PSE ROMANI NDIHET ENDE PERSONAL

Dekada ose edhe shekuj më vonë, Ana Karenina vazhdon të rezistojë, sepse flet me të vërtetë emocionale që nuk plaken:

- kostoja e jetesës në mënyrë të pandershme,
- vetmia e keqkuptimit,
- pesha e padurueshme e pritshmërisë sociale,
- vija e brishtë midis dashurisë dhe humbjes.

Është një roman që shumë njerëz ngurrojnë ta rilexojnë - jo sepse është i zymtë, por sepse mban mend shumë.

REFLEKTIM PËRMBYLLËS

Ana Karenina nuk është thjesht një histori për dashurinë e shkuar keq. Është një meditim se sa e brishtë mund të jetë lumturia kur bota refuzon t'i bëjë vend të vërtetës. Melankolia e saj nuk është dramatike - është e ngadaltë, intime dhe e paharrueshme.

Ju nuk e mbaroni këtë roman duke u ndjerë i ndriçuar. Mbaroni duke u ndjerë i ndryshuar. Dhe shumë kohë më pas, kur një fishkëllimë treni tingëllon ose një kujtim shfaqet papritur, mund të kuptosh se Ana nuk të ka lënë kurrë fare. (Marrë nga: English Literature)

Përshtati: Fitim Nuhiu

15 JANAR 2026



MONIKA BELLUÇI, IKONA E ELEGANCËS DHE ARTIT

Për publikun, kritikën dhe historinë e kinemasë, Monika Belluçi mbetet një mit i gjallë, ku takimi i artit, ndjeshmërisë dhe bukurisë fizike arrin të sfidojë kohën, duke lënë pas një trashëgimi që do të vazhdojë të frymëzojë breza

Leonard VEIZI

Ka emra që, sapo shqiptohen, evokojnë jo thjesht një figurë, por një përvojë të tërë estetike dhe emocionale. Një prej tyre është edhe Monika Belluçi. Ajo nuk është thjesht një

aktore apo një modele, por një muzë moderne, frymëzimi i së cilës e ka origjinën thellë në traditën e artit dhe bukurisë italiane. Përmes syve të saj, bota ka parë një reflektim të gjallë të shkëlqimit dhe misterit që e ka karakterizuar kinema-

tografinë dhe modën, duke e kthyer elegancën mesdhetare në një gjuhë universale.

1964 shënoi fillimin e këtij rrugëtimi magjepsës. Në qetësinë dhe gjelbërimin e kodrinave të Umbrias, në Città di Castello, lindi Monika Ana Maria Belluçi, një emër që shumë shpejt do të shndërrohej në një nga ikonat më të mëdha të kinemasë botërore. Me një bukuri që tingëllon si një jehonë e thellë e kohës, Belluçi nisi rrugëtimin e saj artistik në pasarellet e modës, ku statura dhe tiparet e saj klasike u krahasuan menjëherë me figurën e përkryer të Rilindjes Italiane. Megjithatë, bukuria e saj nuk mbeti kurrë thjesht sipërfaqësore; ajo ishte një portë drejt artit. Belluçi e shndërroi atë në një gjuhë të rafinuar aktrimit, ku estetika bashkohej me forcën e ndjeshmërisë dhe thellësinë psikologjike të personazheve.

Hyrja në botën e kinematografisë ishte një kalim i natyrshëm, një ftesë e destinacionit për të shkëlqyer në ekranin e madh. Në një karrierë që i kalon tre dekada, Belluçi ka lënë një shenjë të pashlyeshme, duke u spikatur me role të guximshme, intensive dhe të paharrueshme. Ajo interpretoi në filma italianë, amerikanë dhe francezë.

Kujtojmë performancat e saj te "Bram Stoker's Dracula" në vitin 1992, ku shkëlqeu me praninë e saj mistike, dhe sidomos te "Malèna" prodhim i vitit 2000, ku portretizoi me mjeshtëri fuqinë shkatërrimtare dhe jetëdhënëse të bukurisë në kohë lufte. Role të tjera si ato te "Tears of the Sun" i vitit 2003, "The Passion of the Christ" i vitit 2004, dhe roli magjepsës në sagën e Xhejms Bond te "Spectre" i vitit 2015, e konfirmuan statusin e saj si një aktore me diapazon të gjerë.

Roli i saj në trillerin francez "L'appartement" i vitit 1996, e çoi atë në një famë shumë të madhe pasi fitoi ekuivalentin francez të një nominimi për Oscar.

Me dhjetëra nominime dhe tre çmime si aktorja më e mirë protagoniste, Belluçi u kurorëzua jo vetëm si një artiste e kompletuar që di të balancojë komercialen me artin, por edhe si një simbol i përjetshëm i sofistikimit dhe bukurisë autentike mesdhetare. Për publikun, kritikën dhe historinë e kinemasë, Monika Belluçi mbetet një mit i gjallë, ku takimi i artit, ndjeshmërisë dhe bukurisë fizike arrin të sfidojë kohën, duke lënë pas një trashëgimi që do të vazhdojë të frymëzojë breza.



NUMRI I ARDHSHEM ME 31 JANAR

HEJZA

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000